

**MEDIAT NË SHOQËRITË
SHUMË-GJUHËSORE
Liria dhe përgjegjësia**



Përfaqësuesi i OSBE-së për liri të mediave

**MEDIAT NË SHOQËRITË
SHUMË-GJUHËSORE
Liria dhe përgjegjësia**

Përgatiti
Ana Karlsrajter

Vienë, 2003.

Botuesi është mirënjohës për ndihmën financiare
të Qeverisë së Republikës Federale Gjermane

© 2003

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)

Zyra e Përfaqësuesit për liri të mediave

Kärtner Ring 5—7, Top 14, 2. DG,

A-1010 Vienna

Telefon: +43-1 512 21 450

Telefaks: +43-1 512 21 459

E-mail: pm-fom@osce.org

Raportet pasqyrojnë ekskluzivisht pikëpamjet e vetë autorëve
dhe nuk i përgjigjen patjetër qendrimeve zyrtare të Përfaqësuesit
të OSBE-së për liri të mediave.

Përmbajtja

Frajmut Duve	
Parathënie	7
Milo Dor	
Fjalimi përshëndetës	15
Tanja Popoviç	
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë .	21
Rekomandimet për Ish Republikën	
Jugosllave të Maqedonisë	47
Romen Kon	
Luksemburg	49
Rekomandimet për Luksemburg	69
Natalia Angeli	
Moldavia	71
Rekomandimet për Moldavi	95
Nena Skopljanac	
Serbia (Serbia dhe Mali i Zi)	97
Rekomandimet për Serbi	
(Serbia dhe Mali i Zi)	128
Roxher Blam dhe Andrea Oshner	
Zvicrra	133
Rekomandimet për Zvicërr	164
Programi i konferencës	166
Lista e pjesëmarrësve	168
Autorët	170

Frajmut Duve
Parathënie

Ky publikim është rezultat i projektit të nisur në shtator 2002: *Liria dhe përgjegjësia — Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore. Në përputhshmëri me këtë, viteve të fundit është rritur vetëdija për rëndësinë dhe rolin kyç të mediave brenda demokracive shumë-gjuhësore.* Ky projekt për herë të parë merret me këtë çështje të rëndësishme në mënyrë të ndërlikuar dhe gjithëpërfshirëse. Janë emëruar njerëz profesional të pavarur për të shkruar raporte për vendet shumë-gjuhësore dhe kanë hulumtuar mjedisin e punës të mediave në pesë vende të tilla të cilat edhe sipas të kaluarës dhe sipas tanishmërisë vështirë që mund të janë më të ndryshme: Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Luksemburgu, Moldavia, Serbia dhe Mali i Zi dhe Zvicrra. Të gjitha raportet kanë strukturë të njëjtë: si pikë nismëtare është përshkrimi i kornizës juridike që është i përcjellur me pasqyrim të detajizuar të mjeteve mediale të cilat funksionojnë në gjuhë të ndryshme. Një kapitull i posaçëm i kushtohet veprimeve më të mira që aplikohen në ato vende. Ajo strukturë e ngjashme i mundëson lexuesit të krahasojë situatën në vende të ndryshme.

Projekti mund të shërbejë si shembull jo vetëm nga pikëpamja e shtrirjes unike gjeografike por edhe shkaku i qasjes së tij teorike. Lënda nuk është hulumtuar nga perspektiva e zakonshme shumicë-pakicë e cila vetvetiu automatikisht bën një ndarje dhe diferencim. Projekti jonë përkundrazi ka për qëllim të tregojë që ajo në çka

ne duhet të përqendrohemi nuk është ndasia gjuhësore për ajo çka na bashkon e kjo është që ne jemi banorë të vendit ku jetojmë. Fjalë kyçe këtu është “shtetesia”. Natyrisht, sëcili prej nesh ka një të kaluar të ndryshme por si qytetarë ne kemi përgjegjësitë dhe të drejtat e njëjta.

Zvicrra dhe Luksemburgu paraqesin sukses të pamohuar në tejkalimin e ndryshueshmërisë gjuhësore. Në fillim të shekullit njezet mu për këtë qellim është zhvilluar “miti kombëtar” me pak apo shumë vetëdije në Zvicërr. Në praktikë ka pasur domethënien që katërgjuhësia destabilizuese e atij vendi është kthyer në përparësi dhe më saktësisht është kthyer në një tipar të vlefshëm. Ajo çka vërehet si përçarje fatale u zhvillua në esencë të kombit zvicerian. Në mënyrë të ngjashme në Luksemburg tradita historike dhe nevoja ekonomike kanë rezultuar me situatë të çuditshme të ekzistencës së përbashkët paqedashëse të tri gjuhëve. Në Zvicërr dhe Luksemburg askush nuk sheh rrezikun për siguri apo unitet të vendit nga llojlojshmëria gjuhësore por ato konsiderohen si begatim i kulturës dhe identitetit të tyre. Përvoja unike e Zvicërrës dhe Luksemburgut me llojlojshmëri të shoqërive të tyre ka validitet dhe vlefë që tejkalojnë pamëdyshje kufinj të tyre kombëtarë.

Në realitet asnjë shoqëri nuk është më të vërtetë homogjene duke pasur parasyshë historinë mijëvjeçare të dyndjeve dhe përzjerjes së popujve të ndryshëm. Sipas disa burimeve ekzistojnë përafërsisht 5.000 grupe nacionale që jetojnë në botën bashkëkohore dhe diku rreth 3.000 grupe gjuhësore. Në të vërtetë, të gjitha vendet Evropiane janë shumë-gjuhësore! Pra, na mbetet pyetja pse gjuhë të ndryshme dhe grupe të ndryshme etnike në regjione të caktuara gjeografike akoma konsiderohen si burime të problemeve? Statistikat shumë qartë tregojnë së edhe ne Evropën perendimore një përqindje e njëjtë e

popullatës gjegjesisht 14.7 përqind i takojnë grupëve gjuhësore apo nacionale sikurse në regjionet e Evropës qendrore dhe lindore.¹ Gjatë viteve të tetëdhjeta në Vojvodinë, pjesë e Serbisë së sotme (Serbia dhe Mali i Zi) kanë qenë të pranishme 26 kombe dhe kombësi të cilët jetonin qetë së bashku dhe sipas gazetares së *Magyz Szo*, Marta Paliq madje edhe fjala “pakicë” ka qenë ofenduese në atë kohë. Asnjë shoqëri nuk është me të vërtetë homogjene ndërsa kalimi në demokraci nuk mund të arritet pa pranimin e këtij fakti. Esenca e demokracisë nënkupton kycjen dhe integrimin e plotë e të gjithë popujve në jetë të kombit pa marrë parasyshë gjuhët me të cilat flasin.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Moldavia dhe Serbia dhe Mali i Zi janë vende në fillim të ndërtimit të kombit dhe zhvillimit të shoqërisë civile. Mediat në të gjitha gjuhët që flitën në vend paraqesin mjet të fuqishëm shoqëror që mund — dhe duhet — të mobilizohet për ndihmë të këtij procesi.

Raportet e këtyre pesë vendeve të përpunuara gjatë këtij projekti janë paraqitur në publik për herë të parë në konferencën e organizuar nga Zyra ime në bashkëpunim me Institutin për studime të komunukimit masovik nga Berni, me datën 28 dhe 29 mars 2003 në Zvicërr. Dëshirojmë të falenderojmë Departamentin Federal Zvicerian të punëve të jashtme për mbështetjen bujare financiare të konferencës. Është e rëndësishme që Milo Dor shkrimtar me të kaluar shumë-gjuhësore pranoi ti drejtohet këtij tubimi. Konferenca kishte tubuar në një vend gazetarët, mediat, organizatat jo qeveritare (OJQ) dhe përfaqësuesit e qeverive nga pesë vende jo vetëm të ra-

¹ Snezhana Trifunovska, *Minority Rights in Europe. European Minorities and Languages* (The Hague, 2001).

portojnë për mjedisin e tanishëm të punës së mediave por edhe të shkëmbejnë informatat dhe pikëpamjet me kolegët e tyre nga vendet tjera. Duke ju falenderuar një qasje të gjërë gjeografike u paraqiten edhe raportet për mediat në gjuhën suedeze në Finlandë dhe për mediat në Danimarkë në gjuhën gjermane që konferencën e bëri një forum të përshtatshëm për diskutim. Seanca e dedikuar “raporteve mbi diverzitet” si instrument efikas për promovim të tolerancës dhe mirëkuptimit përmes mediave u shndërrua në pikë kulminante të konferencës. Përfaqësuesit e tri OJQ-ve mediale të njohura paraqiten konceptin e “raportimit mbi diverzitetet” dhe në mënyrë kritike vlerësuan punën e tyre në Evropën jug-lindore. Gjatë seancës së fundit të konferencës u paraqiten disa nga veprimet më të mira ekzistuese në të pesë vendet.

Konferenca identifikoi disa probleme kyçe që pengojnë zhvillimin e mediave në gjuhë të ndryshme, posaçërisht në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Moldavi:

- jo-ekzistimi i vetëqendrueshmerisë së mediave
- menaxhimi i pamjaftueshëm profesional
- niveli i ultë i përgatitjes për raportim mbi diverzitetet
- mungesa e solidaritetit kolegjial mes gazetarëve me origjinë të ndryshme etnike

Në rastin e Zvicrrës dhe Luksemburgut folësit në konferencë pranuan që qeveritë dhe mediat do të duhej të bënin më shumë për t'i integruar migrantet duke krijuar programe të posaçme për prodhime nacionale të transmetuara dhe të shtypura. Përveq kësaj, do të duhej t'ju ofrohen mundësi më të mira për të mësuar gjuhët të cilat flitën në atdheun e tyre.

Rezultatet e projektit kanë treguar që përkundër të gjitha ndryshimeve që e përcaktojnë mjedisin e punës së

mediave në vende të ndryshme, faktorët vijues kanë vlerë univerzale:

1. Mbështetja nga ana e qeverisë çdokund është e rëndësishme parësore për mbijetimin e mediave në gjuhë të ndryshme. Institucionet shtetërore duhet të janë të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre dhe të krijojnë korniza juridike të cilat do të janë të përshtatshme për mediat në gjuhë të ndryshme nëse ato nuk janë krijuar më herët. Duhet hulumtuar mundësitë për definimin e rregulloreve ligjore që do të sjellin diskriminimin pozitiv. Përveq kësaj, duke pasur parasysh faktin që ky lloj i mediave kurrë nuk do të jetë plotësisht i vetëqendrueshëm, qeveritë duhet të vazhdojnë apo të fillojnë të sigurojnë mbështetje afatgjate financiare këtyre mediave. Nga ana tjetër, praktika e financimit direkt shtetëror gjithmonë lenë hapësirë për kontrollë shtetërore mbi mediat dhe ajo duhet anashkaluar. Duke ndjekur shembullin e Zvicrës, Luksemburgut, Finlandës dhe Danimarkës duhet shqyrtuar mekanizmat e mbështetjes indirekte siq janë politika tatimore dhe shpenzimet postare në mënyrë që ti mundësohet veprimi i pavarur mediave. Qeveritë duhet të sigurojnë që qytetarët që janë pjesëtarë të grupëve të ndryshme gjuhësore të kanë të drejtë dhe rast për shprehje të lirë, të ruajnë dhe zhvillojnë gjuhën e tyre përmes mediave. Nëse rasti s'është i tillë dhe lexuesit, dëgjuesit dhe shikuesit kanë pak apo aspak besim në mediat lokale vjen deri të tendenca e drejtimit të vëmendjes ndaj mediave të huaja fqinje që unë i përkruaj si "mediat e vëllaut të madh". Në afat të gjatë, kjo mund të këtë si pasojë destabilizimin e shoqërisë. Secilit vend i nevojiten mediat e veta të pavarura dhe të emancipuara që janë garancë e debatës publike që është domosdoshmëri për zhvillimin e shoqërisë civile.

2. Mediat duhet të janë në gjendje të luajnë rol konstruktiv në luftë kundër diskriminimit, të avancojnë mirëkuptimin dhe të ndërtojnë paqe stabile në shoqëritë shumë-gjuhësore. Raportet tregojnë që “gjuha e urrejtjes” dhe urrejtja ndaj tjerëve janë zhdukur në masë të madhe nga skena mediale por akoma ekziston hendeku në mes publikave të ndryshme. “Fjalimi pozitiv” i njëjës anë për tjetrën ende është i rrallë. Qellimi i mediave duhet të jetë pasqyrimi i shoqërisë multi-etnike dhe shumë-gjuhësore, në vend të fokusimit vetëm në bashkësinë e vet duke harruar nevojat e grupeve tjera. Duhet vendosur dhe aplikuar standarde profesionale dhe parime etike të gazetarisë. Edukimi i gazetarëve ka një rëndësi të madhe. Duhet zhvilluar dhe avancuar të gjitha nivelet e edukimit.

3. Roli i mediave të shërbimit publik akoma është i rëndësishëm. Sektori privat vetëm nuk mund të garantojë *per se* hapësirë plurale mediale. Përpos sasisë së programit të siguruar me ligj në gjuhë të ndryshme, mediat publike duhet ti kushtojnë vëmendje të duhur jetës dhe situatës në të cilën gjëndën grupe të ndryshme etnike që jetojnë në atë vend. Mbulimi i temave që kanë të bëjnë me këto grupe duhet të jetë një nga prioritetet themelore në lajmet kryesore dhe programet e ngjarjeve të tashme.

4. Mediat dy-gjuhësore apo shumë-gjuhësore respektivisht mediat që emetojnë apo publikojnë në gjuhë të ndryshme do të jenë në gjendje të tregojnë rezultate pozitive vetëm nëse shoqëria e pranon shumë-gjuhësinë si pjesë normale të përditshmërisë jetësore. Do të duhej shqyrtuar shfrytëzimi i shembullit të *Radio Kanalit 3* nga Bil/Bine në Zvicërr. Programet atje përgatiten nga

personeli shumë-gjuhësor por emetohen vetëm në një gjuhë. Shembulli finlandez i përdorimit të titrave për shumicën e TV programeve duhet marrë në shqyrtim serioz në vendet tjera shumë-gjuhësore ashtu që ti ikët “ge-toizimit” të shoqërisë përmes mediave për të cilën gjë u raportua në konferencë.

Si rezultat i projektit, në publikimin tonë për secilin vend theksohen rekomandimet të cilat do të përdorëshin si udhërrefyes për zhvillimin e mediave në të ardhmen në vendet e përmendura.

Jam i bindur që ky publikim do të këtë ndikim fryt-dhënës në dy mënyra. Në vendet e shqyrtuara duke përfshirë të gjithë — qeveritë, OJQ-të mediale dhe gazetarët do të mendojnë për mënyrat e reja të konfrontimit me sfidat pozitive të strukturës së tyre shumë-gjuhësore. Mëtutje, jam i sigurtë që projekti është gjithashtu shumë i vlefshëm sepse veprimet më të mira janë të përshkruara nëpër raporte sipas shteteve dhe rekomandimet mund të përdoren për zhvillimin e mëtejshëm të mediave në shoqëritë tjera shumë-gjuhësore.

Do të doja të ndajë me juve diçka lidhur me origjinën e një kënge me të cilën gjë edhe e kam hapur konferencën në Bern. Historiati i kësaj kënge me është bërë i njohur në një dokumentar të jashtëzakonshëm të regjisores së njohur bullgare të filmit — Adela Peeva që në të njejtën kohë është shumë i nderlikuar dhe shumë i thjeshtë. Kënga ekziston në jo më pak se shtatë gjuhë: në turqisht, greqisht, shqip, serbisht, maqedonisht, bullgarisht etj. dhe ka emër të ndryshëm në secilën nga këto gjuhë por është gjithmonë kënga e njejtë dhe kjo është me rëndësi! Këngët dhe gjuhët do të duhej të na bashkonin e jo të na ndajnë!

Zyra ime mirëpret dhe mbështet të gjitha propozimet e projekteve specifike të cilët do të jenë në formë të këtij publikimi!

Vienë, qershor 2003.

Milo Dor
Fjalimi përshëndetës

Paraardhësit e mi kanë qenë serbë të ikur në Austri para 300 vjetëve nga Turqit dhe ishin vendosur në veri të Danubit, kufi i natyrshëm në rrafshin pjellor të mbetur pas detit të zhdukur të Panonisë. Toka u është dhënë me kusht që ata ta mbrojnë këtë pjesë nga Turqit otoman.

Në atë kohë, Beogradi ka qenë pikë e largët e perandorisë Turke të cilën për kohë të shkurtër e patën okupuar Austriakët në fillim të shekullit tetëmbëdhjetë. Pasi Turqët kishin pushtuar përsëri kështjellën, Maria Terezia i banoi viset ku tashmë ishin të vendosur Hungarezët, Rumunët dhe Serbët me njerëz me origjinë shvabe dhe rusine, ku të dytët vinin nga Ukrajina dhe Sllovakia. Tjerët që gjetën strehim ishin Grekët dhe Bullgarët që kishin ikur para përparimit turk sikurse edhe Hebrenjtë në kërkim të atdheut. Ashut që ai “kufi ushtarak” ishte bërë pasqyrë reale e shtetit shumë-nacional.

Deri tek rrënimi përfundimtar i perandorisë së Habzburgut, me fjalë tjera deri me 1918, paraardhësit e mi si zakonisht pranonin një sasi të caktuar të kripës dhe vajit çdo vit sipas marrëveshjes që datonte nga shekulli i tetëmbëdhjetë.

Fëmijërinë e kam kaluar në atë region të njohur si Vojvodina (në gjermanisht *Woiwodschaft*), që deri kah mesi i shekullit të nentëmbëdhjetë kishte fituar një lloj autonomie. Edhe pse monarkia Austro-hungareze nuk ekzistonte më, kishin mbetur shumë gjurmë e mbi të gjitha

përzjerja e larmishme e grupeve etnike që të gjitha ishin bërë vendase. Përpos gjuhës sime amtare, isha i mësuar të dëgjoj gjermanisht, hungarisht dhe rumanisht në përdorim të gjërë. Gjyshja ime nga ana e nënës, Greke e edukuar në Vienë fliste me mua gjermanisht sepse nuk fliste rrjedhshëm serbisht.

Babai im, i lindur me 1895 në një fshat të Banatit, ishte rritur në një rajon të gjërë gjeografik ku shumë grupe etnike kishin jetuar së bashku, dashur apo pa dashur. Mirëpo kjo strukturë shtetërore u shkatërrua pasi që udhëheqësia nuk ishte në gjendje të zgjidhte problemet nacionale dhe poashtu ndërlidhur me këtë as problemet sociale.

Kur filloi Lufta e Parë botërore, babai im sapo kishte përfunduar shkollën dhe donte të studionte mjekësinë. Shkaku i kësaj e morën në shërbim në njësi për sanitet. Edhe pse pas lufte jetoi në shtetin e ri të formuar të Jugosllavisë, vazhdoi studimet në Budapest me fjalë tjera në territorin e ish monarkisë së dyfishtë.

Kur qeveria e re hungareze u bë e përzier në nacionalizëm ekstremist, babai im në vend që të kthehet në Jugosllavi shkoi më larg deri në Poloni ku në Poznanie përfundoi dy semestrat e fundit dhe fitoi diplomën e mjekut.

Kah fundi i vitit 1939, kur Poloninë e kishin shkelur trupat e Hitlerit, pjesë të armatës polake të mundur dhe të çarmatosur kishin ikur në jug dhe kishin ardhur përmes Rumanisë deri në Beograd nga ku Polakët kishin vazhduar bredhjen e tyre. Babai kishte zakon t'ju drejtohej oficerëve polak apo ushtarëve të thjeshtë në rrugë dhe ti ftonte për drekë apo darkë vetëm që të fliste me ta polonisht.

Intervenimi i parë kirurgjik që e kishte bërë babai im kishte ndodhur në një fshat rumun. Pastaj, një kojë

të caktuar ka qenë mjek lokal i mjekësisë së përgjithshme në një fshat në Baçkë, të banuar me Serb dhe Ruten, të cilët atje i quanin Rusin. Më vonë kishte studiuar kirurgjinë plastike me një Hebrej, profesor në Berlin. Në mes të luftës u zhvendos për të jetuar në Vjenë, për të qenë më afër burgut ku unë isha i burgosur. Aty përsëri u bë mjek i përgjithshëm dhe kujdesej për Italianët në punë të detyrueshme, me të cilët kalonte shumë mirë.

Krenohem me babain tim pasi që kishte zotëruar me aq shumë gjuhë me të cilat flitej në ish perandorinë e Habzburgut. Tërësisht ishin gjashtë gjuhë — gjuha e tij amtare, serbo-kroatishtja apo kroato-serbishtja, pastaj gjermanishtja, hungarishtja, polonishtja, rumanishtja dhe gjuha italiane. Atyre mund t'ju shtohen edhe tri gjuhë të vdekura — greqishtja e vjetër dhe latinishtja që i kishte mësuar në shkollë të mesme — dhe hebraishtja që në kohën e lirë kishte mësuar nga Konvikti (libër hebraik), të cilën një mik rabin ia kishte dhënë babait të tij.

Babai im kishte qenë më të vërtetë Evropian qendror apo më mirë të thëm Evropian duke mos e ditur këtë fare, pasi që për të ishte e natyrshme të mësojë gjuhët e pacientëve të vet e jo ti detyrojë ata ti drejtohen në gjuhën e tij. Ishte për të aq e natyrshme sikur ofrimi i ndihmës pacientëve të sëmurë; i pranonte ashtu siq vinin, pa i pyetur për kombësinë, fenë apo ndonjë pikëpamje të posaçme të tyre. Ishte humanist praktik dhe unë krenohem me të sepse unë si shkrimtar disponoj vetëm me fjalë ndikimi i të cilave është i dyshimtë.

Pas humbjes së ideologjisë komuniste — e cila ia mundësoi Bashkimit Sovjetik që në emër të solidaritetit ndërkombëtar të shtypte aq shumë grupe etnike mu sikurse ndonjë fuqi koloniale e shekullit të nentëmbëdhjetë — filloi të dalë përsëri nga gërmadhat e sistemit të rrënuar (madje jo vetëm atje) spektri i vjetër ideologjik,

për të cilin njeriu shpresonte që ishte i dërguar në vend të sigurtë në humnerë të historisë, e ky ishte para së gjithash, spektri nacionalist.

Me këtë natyrisht nuk mendoj për vetëdijen nacionale, e cila del nga tradita e lirë dhe humane e një grupi etnik por në atë formën e nacionalizmit të ideologjisë agresive që sheh armikun në çdo grup të ndryshëm apo dukshëm të ndryshëm.

Nuk ekziston asnjë komb që në ndonjë moment të historisë së vet nuk ka bërë keq. Betejat e fituara apo të humbura, në kërkim të perandorive më të mëdha, luftës për pushtet mes dinastive të ndryshme që shpesh përfundonin me vrasje dhe shtypje të grupeve tjera apo grupeve që mendojnë ndryshe, nuk janë arsye që njeriu posaçërisht të krenohet.

Kultura Evropiane me të cilën kemi drejtë të krenohemi është rezultat i mundimshëm i individëve nga shumë grupe etnike të cilët ia kishin dalur të shtrinin shikimin përtej horizontit të ngushtë të malëve dhe luginave të tyre. Kjo solli renesansën dhe iluminizmin me premtim për krijimin e Evropës në një vend human, bashkësi në të cilën nuk do të jetë e rëndësishme cilit komb i takoni apo cilit Zot i lutëni, ku e vetmja gjë me rëndësi është së si sjellet dikush ndaj tjetrit dhe çka bën ai.

Në krahasim me këtë kulturë të larmishme me të gjitha liritë e saj dhe traditat demokratike, tubimet nacionaliste me flamujt e tyre separatist dhe muzikën e tyre frymore bien poshtë deri në folklor të marrë.

Kurrë nuk ka pasur as sa gjysma e këtyre njerëzve të mbushur me dëshirë të flaktë të idesë së identitetit Evropian sikur sot, por prap nuk ka pasur të ngritura aq shumë perde të vogla të hekurta për të fshehur lidhshmërinë e vërtetë e cila themelohet në këmbimin e lirë të njerëzve, të mirave dhe ideve.

Është e qartë së bashkësia e tillë e të gjitha grupeve etnike Evropiane mbetet shans i vetëm i mbijetimit në këtë botë të bukur të larmishme. Megjithatë, si mund ta ndalim atë rritje të jo tolerancës dhe urrejtjes për vëllëzërit (në sytë e nacionalistëve militantë të gjithë njerëzit e kombëve tjera janë inferior), kur të gjitha qasjet e arsyeshme janë dukshëm të pa suksesshme.

“Çka na mbetet?”, pyetej shkrintari jo konformist i madh kroat, Miroslav Kërlezha, dhe menjëherë përgjigjej: “Një kuti me shkronja plumbi të shtypit, e kjo nuk është shumë, por është e vetmja që njeriu ka zbuluar deri më tani si armë me të cilën do ta mbrojë humanitetin e vet.”

Çfarë zgjidhje tjetër na mbetet nëse nuk duam që duarlidhur të shikojmë së si shpresat për një Evropë të ndritshme e të lirë me barazi për shumë popuj të mos na shprishën në mjegullën e nacionalizmit agresiv dhe dogmatik?

Tanja Popoviq

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Si pjesë e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë kalon nëpër transformim të rëndë social, ekonomik dhe politik. Ky proces afatgjatë dhe i përgjithshëm ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e mediave të shtypit dhe elektronike.

I. Korniza juridike për media

Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë jetojnë grupe të ndryshme etnike: Maqedonët (1,378.700/66.4 përqind), Shqiptarët (479.000/23.1 përqind), Turqët (81.600/3.9 përqind), Romët (47.400/2.3 përqind), Vllahët (44.462/2.2 përqind), Serbët (39.900/1.9 përqind) dhe të tjerë (23.900/23.9 përqind).¹

Në ish Rrepublikën Socialiste Federative të Jugosllavisë të drejtat e minoriteteve kanë qenë relativisht mirë të respektuara, posaçërisht në rajonin e mediave. Me përjashtimin e rolit dominant të partisë socialiste dhe politikës së saj, grupet etnike kanë pasur mundësi ta ruajnë gjuhën dhe avancojnë kulturën e tyre të trashëguar përmes mediave të tyre. Gazetat janë shtypur në

¹ Shifrat mbi popullsinë bazohen në regjistrimin kombëtar nga viti 1994. Regjistrimi i ri është bërë në nëntor 2002. Rezultatet e para ishin publikuar në janar 2003 ndërsa rezultatet përfundimtare nuk do të publikohen para vitit 2004.

shqip, hungarisht, në gjuhën rome dhe italiane, kanë qenë të pranishëm edhe programe të ndryshme të TV-së dhe radio-së.²

Që nga pavarësia e fituar në vitin 1991 disa rregulla e kanë formuar kornizën juridike të përgjithshme në këtë shtet. Kushtetuta e aprovuar në vitin 1991 garanton sipas nenit 16 lirinë e të folurit, si dhe lirinë për të formuar institucionet për informim publik. Më tutje, ajo garanton pranimin e lirë të informacioneve, si dhe lirinë e pranimit dhe dërgimit të informacioneve.

Si shtesë, neni 48 i Kushtetutës u garanton pjesëtarëve të komuniteteve etnike të drejtën që të shprehën lirë, që ta kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale. Kushtetuta garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të komuniteteve etnike.

Amandamenti i Kushtetutës nr. 8, i aprovuar në nëntor të vitit 2001, mëtej definon që pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që të shprehën lirisht, të kujdesen dhe të zhvillojnë identitetin dhe karakteristikat e tyre, dhe që të përdorin simbolet e komuniteteve të tyre. Ky definicion garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor gjuhësor dhe fetar të gjitha komuniteteve etnike. Pjesëtarët e komunitetit kanë të drejtë të formojnë institucione kulturore, artistike dhe edukative si edhe shoqata shkencore dhe të tjera për shprehje, kultivim dhe zhvillim të identitetit të tyre.

Në përputhje me të drejtat e garantuara të komuniteteve etnike, sipas rregullave të Kushtetutës së Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, *Ligji për media publike* ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.

² Dunja Melcic, "Zwischen Pluralismus und Denkdiktatur. Die Medienlandschaft", in id. (ed.), *Der Jugoslawienkrieg. Handbuch zur Vorgeschichte, Verlauf und Konsequenzen* (Opladen, 2000), 317–31.

20/97) saktësisht definojnë mënyrën në të cilën këto të drejta do të aplikohen. Neni 45, paragrafi 2 dhe 3, i obligon ndërmarrjet e transmetuese që të transmetojnë programet e veta në gjuhët e grupeve etnike në regionet ku ato grupe e përbejnë shumicën ose kanë përqindje relevante të popullsisë. Paragrafi 4, neni 45, definojnë të drejtën e kompanive komerciale transmetuese që të transmetojnë në gjuhën e komuniteteve tjera etnike, pranë programëve në gjuhën maqedone. *Ligji për mediat publike* poashtu përmbanë rregullat për përkrahje financiare radio dhe tv produksionëve, edhe në maqedonisht edhe në gjuhët e komuniteteve tjera etnike, nga fondi i parapagimit publik.³

Ligji mbi formimin e ndërmarrjes publike Radio dhe Televizioni i Maqedonisë transformoi *Radio Televizionin e Maqedonisë MRTV (RTVM)* në shërbim publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.6/98 dhe nr.98/2000). Neni 6 qartë rregullon obligimin që MRTV të sigurojë programe në gjuhët e komuniteteve etnike, që do të thotë në gjuhë të pjestarëve të gjitha komuniteteve që jetojnë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.⁴

Gjatë janarit të vitit 2003 Grupi operativ për media i Paktit për stabilitet dhe Këshilli Evropian financuan veprimet, nën mbikqyrjen e *Qendrës për zhvillimin e mediave* (Media Development Centre, MDC), që të riformulohet ligji për mediat. Ligji, i cili pritet të aprovohet në parlament në fund të vitit 2003, duhet që të përmirësojë rregulloret që sipas kushtetutës garantojnë pavaresinë e MRTV-së dhe të hapë rrugën që ai të bëhet shërbim publik medial plotësisht i pavarur.

³ Neni 77, paragrafi 1, rendi 5, dhe neni 78, paragrafi 2.

⁴ Neni 6, paragrafi 1.

Ligji kundër Krimet poashtu i mbronë liritë gjuhësore. Neni 138 i atij ligji artikulon që aktivitetet të cilat thyejnë të drejtën e përdorimit të gjuhës sipas zgjedhjes personale janë kriminale (të përshkruara në pjesën mbi “Veprat kriminale kundër lirive dhe të drejtave të personave dhe qytetarëve”). Sipas Kodeksit gazetar (neni 10), gazetari nuk guxon të krijojë apo përpunojë informatat të cilat rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk guxon të përdorë gjuhë urrejtëse apo të inkurajojë dhunën dhe diskriminimin të çfarëdo lloji (nacional, fetar, racor, gjinor, të klasave shoqërore, gjuhësor, të orientimit seksual, të pëcaktimit politik...). Neni 11 i obligon gazetarët në respektim të standardeve të përgjithshme shoqërore të mirësjelljes si dhe shumë-llojshmërisë etnike, kulturore dhe fetare në vend.

Marrëveshja Bazë e Ohrit e 13 gushtit 2003 fton bashkësinë ndërkombëtare të promovojë mediat në gjuhët e komuniteteve të ndryshme etnike. Neni 6, “Kultura, arsimit dhe përdorimi i gjuhës”, cekë “Palët ftojnë bashkësinë ndërkombëtare duke përfshirë dhe OSBE-n, ta shtojnë ndihmën e tyre ndaj projekteve në sferën e mediave, për forcimin e mëtejshëm të mediave radio, televizive dhe të shtypura duke përfshirë mediat në gjuhën shqipe dhe mediat multi-etnike. Palët gjithashtu ftojnë bashkësinë ndërkombëtare të zgjerojnë programet profesionale të mediave për trajnimin e pjesëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në vend. Palët gjithashtu ftojnë OSBE-n të vazhdojë përpjekjet në projektet e parapara për përmirësimin e marrëdhënies ndër-etnike.”

II. Hapesira mediale

1. Mediat e shtypura. Si rezultat i të gjitha ndryshimeve shoqëro-politike dhe i demokratizimit të informimit,

interesi për themelimin dhe publikimin e mediave publike në vend është në rritje e sipër qysh nga arritja e pavarësisë. Deri me dhjetor 2002, Agjencioni për informim ka regjistruar 926 media të shtypura — gazeta, revista, zhurnale, buletine, sikurse edhe komunikata, almanak dhe lloje tjera të materialit të shtypur.⁵ Shumica e këtyre mediave të regjistruara është në gjuhën maqedone, por ka edhe 73 në shqip, 8 në turqisht, 4 në anglisht, 4 në gjuhën vllahe, 2 në serbisht ndersa 15 shumë-gjuhësor.⁶ Konkurrencë e madhe ekziston mes këtyre publikimeve për një treg mjaft të kufizuar prej dy milionë banorëve me ekonomi të dobësuar. Shumë media luftojnë për të fituar përfitim nga marketingu, mbështetje ndërkombëtare dhe mënyra tjera të mbijetimit. Gazetarët kryesisht fitojnë të ardhura shumë të ulta, që ka ndikim të konsiderueshëm në cilësi. Në vend ekzistojnë vetëm dy shtëpi të mëdha botuese — që është rezultat i kontrollës së mëparshme shtetërore mbi media. Kjo si duket ka ndikuar deri dikund në cilësinë e mediave. Cilësia në të shumtën ndryshon, nga kreu i tregut me gazetat ditore siq është *Dnevnik*, deri të gazeta shtetërore e prodhuar në mënyrë modeste me financim të pamjaftueshëm siq është *Nova* Makedonija.

1.1. Mediat e shtypura në gjuhën maqedone. Gazeta më e popullarizuar dhe relativisht e pavarur ditore *Dnevnik* (tirazhi 60.000) pohon që udhëheq politikën e raportimit inkluziv (përfshirës). Sipas informatave të vet *Dnevnik*-ut në mesin e lexuesve të tyre ka edhe shumë Shqiptarë. Mirëpo, interesimi i publikut shqiptarë për këtë ga-

⁵ Sipas informatës së pranuar nga Agjencioni maqedon për informim.

⁶ Sipas informatës së pranuar nga Agjencioni maqedon për informim.

zetë bazohet në besueshmërinë e tyre ndaj burimeve relativisht kredibile të informimit mbi situatën politike në vend. Lexuesve Shqiptarë ju mungon mbulimi i rregullt dhe i saktë i çështjeve shqiptare përpos atyre që mbulojnë kriminalitetin dhe senzacionet. Në këtë gazetë nuk është i punësuar asnjë gazetar shqiptar (edhe pse kanë disa përkthyes shqiptarë), por si shtojcë shpërndajne gratis revistën mujore *Forumi multi-etnik* në gjuhë maqedone, shqipe dhe angleze. Autorët e *Forumit multi-etnik* vijnë nga grupe të ndryshme etnike dhe gjuhësore ndërsa raportojnë për një temë të përbashkët, si “Maqedonia pas zgjedhjeve”, apo çështje të përgjithësuara siq janë gjinia, varfëria etj.

Gazeta e dytë sipas popullaritetit në gjuhën maqedone *Utrinski Vesnik* (tirazh 33.000), gjithashtu pohon që udhëheq politikën e përfshirjes etnike. Sipas projektit të vënë nga një OJQ ndërkombëtare në vitin 2002, kjo gazetë kishte shkëmbyer artikuj me gazetën udhëheqese shqiptare *Fakti*, e më herët kishin punësuar gazetarë dhe kolumnist shqiptarë. Por menaxhmenti pranon që, “shkaku i kërkesave të lexuesve tonë maqedonas”, prioriteti i kësaj gazete përqendrohet në interesat e popullatës maqedonase.

1.2. Mediat e shtypura në gjuhën shqipe. sipas të dhënave të fundit nga janari 2003, ekzistojnë 15 gazeta javore dhe periodike që shtypen në shqip: *Flaka, Fakti, Lobi, Globi, Xixëllima, Nxënesi, Edukimi Qytetar, Stili, Hana e re, Grafiti, Fatos, Lobi ditor, Jehona* dhe *Brezi*.⁷ Përkundër numrit të madh të publikimeve komuniteti shqiptar nuk është i mbuluar sa duhet për momentin me media të shtypura. Tirazhi i ultë i gazetave në

⁷ Sipas informatës së pranuar nga Agjencioni maqedon për informim.

gjuhën shqipe mund të shpjegohet me faktin që ato shpesh përqendrohen në lajme nga Kosova dhe nga Shqipëria ndërsa në shumë raste nuk i sigurojnë informata relevante komunitetit shqiptar për vendin e tyre.

Flaka, gazeta më e vjetër ditore në gjuhën shqipe u themelua në vitin 1945. Sot gazeta humb në mënyrë konstante lexuesit shkaku i nivelit të ultë të cilësisë gazetare, orientimit politik dhe raportimit të njëanshëm. Gazeta e parë jo shtetërore *Fakti*, e themeluar me ndihmën financiare ndërkombëtare në vitin 1998, ofroi një alternativë të gazetës *Flaka*, të drejtuar nga shteti. Sot pohohet që ajo është gazeta më e lexuar në gjuhën shqipe. Ngjarjet e fundit nga viti 2003, tregojnë njëanshmëri politike të raportimit. Përhapja e tyre është më e madhja nga mediat e shtypura në gjuhën shqipe.

Gazeta e pavarur javore *Lobi*, e themeluar në vitin 2001 nga intelektualët shqiptarë Shkupjanë, konsiderohet relativisht e matur dhe është alternativë ndaj gazetave *Flaka* dhe *Fakti*. Deri më tani kanë arritur t'i rezistojnë presionit të fortë politik të grupëve shqiptare të interesit dhe kanë mbajtur drejtimin e tyre pluralistik. Demonstrojnë standard të lartë gazetar por akoma pritet të luajnë rol të fortë në treg.

1.3. Mediat e shtypura në gjuhën turke. Mediat e shtypura në gjuhën turke jo vetëm që duhet të garojnë me gazetatat dhe revistat në gjuhën shqipe por edhe më prodhimet nga Turqia.

Birlik, që u themelua në vitin 1946, është gazeta më e vjetër në turqisht dhe ka traditë të gjatë të gazetës politike dhe informative. Sot ajo shtypet nga *Nova Makedonija* tri herë në javë dhe është burim kryesor i informatave në gjuhën turke. Mirëpo, sikurse edhe të gjitha publikimet e *Nova Makedonija*-s, vuajnë nga problemet e

njejta me të cilat përballën publikimet tjera simotra. Sipas informatave të fundit zyrtare shtypet në 2.016 ekzemplarë.

Javorja *Zaman* shtypet nga viti 1994 në gjuhën turke dhe maqedone (numri i ekzemplarëve të shtypur është 6.000), por del jo rregullisht, kohë pas kohe.

1.4 Mediat e shtypura në gjuhën rome⁸. Tregu i shtypit në gjuhën rome habitshëm është i pasur dhe aktiv. Përpyekjet e përbashkëta individuale dhe aktivizimi i përgjithshëm i komunitetit romë kanë pasur ndikim të shkelqyeshëm gjatë disa viteve të fundit duke sjellur deri të asortimenti i lartë i prodhimeve të shtypura. Popullatës rome dhe mediave të tyre akoma ju mungon ndikimi i vertetë politik dhe publik por edhe vetë ekzistimi i mediave të tyre motivon dhe inkurajon aktivitetet e ardhshme në rritjen e rolit të tyre në shoqërinë maqedone në përgjithësi. *Roma Times*, e themeluar në vitin 2000 dhe e shtypur nga *Romani Informatikani Agencia* (Agjencia Informative Rome) është gazeta e vetme për komunitetin romë e shtypur me artikuj në gjuhën rome dhe maqedone. Shtypet tri herë në javë dhe në 16 faqet e saj sjell informata për ngjarjet ndërkombëtare dhe ato kombëtare, arsimim, argëtim, marketing, sport etj. Më e rëndësishme është që gazeta fokusohet në tema rome. Qysh nga viti 1997 shpërndahet revista mujore për fëmijë e quajtur *Cirikli* dhe sjell përmbajtje arsimore, informativë dhe argëtuese për fëmijë në gjuhën rome dhe maqedone. Me suksesin e *Cirikli*-t, unioni kombëtar pedagogjik, në vitin 1998, rekomandoi përdorimin e saj në shkolla fillore. *Romana* dhe *Vilo* të themeluara në vitin 2001, në botimet e tyre mujore i drejtohen temave që ju

⁸ Gjuha rome ende nuk ka unifikim dhe standardizim. Në këtë raport termi "gjuha rome" përdorët në domethënie të përgjithshme.

interesojnë grave dhe adoleshenteve rome. Derisa *Vilo* kryesisht i kushton vëmendje temave argëtuese, muzikore, të dashurisë, kompjuterike dhe arsimore, *Romana* sjell këshilla tipike për çështje femërore sikur shëndeti, kozmetika dhe moda apo interviston femrat e famshme. Aspekt interesant i këtyre dy publikimeve është që ato janë tregjuhësore (maqedonisht, rome dhe anglisht). Botesit shtypin arikuj në gjuhën maqedone, rome dhe/apo angleze, sepse pranojnë që shumë Romë nuk flasin rrjedhshëm gjuhën rome dhe ju duhet artikulli i njejtë në gjuhën maqedone për ta kuptuar atë të njejtin në gjuhën rome. Pasi që nuk ekziston gjuha e standardizuar rome këto publikime përpjekën të promovojnë vokabular të unifikuar.

1.5 Mediat e shtypura në gjuhën vllahe. Vllahët (Aromunet, Cincaret) njihen si grup gjuhësor që flet me dialekt të vjetër rumun. Si një nga komunitetet më të vogla, është kryesisht i integruar në popullatën shumicë maqedone, pjesërisht shkaku që i takojnë krishtërizmit të përbashkët ortodoks. Vllahët e integruar mirë përballën me rrezikun e asimilimit të plotë dhe janë të brengosur për rënien e njohurisë së gjuhës vllahe. Viteve të fundit, vllahët ri-zbulojnë traditën e tyre kulturore dhe përpjekën të ruajnë gjuhën e tyre, zakonet dhe arkitekturën. Mujorja *Feniks* botohet nga viti 1995 (numri i ekzemplarëve të shtypur është 1.000). Fokuset në çështjet e përditshme dhe historike të jetës së Vllahëve.

Nga tetori i vitit 2002, “Shoqëria kulturore Vllahe Santa Sypsy” në Shtip, pjesë lindore e vendit, boton gratis gazetën dygjuhësore të quajtur *Bilten Armanamea* e cila merret me çështje të komunitetit vllah në tetë faqe.

1.6 Mediat e shtypura në gjuhën serbe, kroate dhe boshnjake. Nuk ka media periodike të shtypura në gjuhën serbe, kroate apo boshnjake që botohen në këtë vend. Prodhimet e shtypura me çmime të volitshme, importohen nga vendet fqinje dhe janë lehtë të arritshme.

2. Mediat e transmetuara. Pas hyrjes në fuqi të ligjeve liberale licencuese, vendi përjetoi një rritje të lartë të numrit të TV dhe radio stacioneve. Për moment ka përmbi 157 TV dhe radio transmetues në vend — numër i cili nuk është i mundur të mbahet në një treg aq të vogël dhe me të ardhura të kufizuara nga reklamat. Mbi të tjerat, ekzistojnë edhe shumë transmetues jo të ligjshëm — posaçërisht të radios — ekzistimi i të cilëve rrezikon aktivitetet e atyre legale.

Problemi i shumicës së TV stacioneve në këtë treg të vogël qendron në ndërlikimin partiak politik gjatë dhënies së licencave transmetuese dhe mbledhjes së kompenzimit vjetor nga transmetuesit për shfrytëzim të atyre licencave. Duket që posaçërisht në kohën parazgjedhore (psh. Viti 2002) numri i radio dhe TV stacioneve rritet si këpurdhat për tu zhdukur prap pas mbylljes së vend-votimeve.

Rregullat e garimit në treg duhet të diktojnë mbylljen e shumë transmetuesve jo profitabil por në situatën e tanishme ndikojnë donacionet e ndryshme politike dhe ndihma zhvillimore nga organizatat ndërkombëtare. Mediat në gjuhën shqipe, rome, turke dhe gjuhë tjera kanë më shumë probleme për të mbijetuar nga kolegët e tyre në mediat në gjuhën maqedone.⁹ Shumë nga këto media private prandaj mbështeten nga ndihma e subvencioneve

⁹ Claude Nicolet, "Medien in Mazedonien: Zwischen Kriegshetze und Friedensförderung", *Südosteuropa Mitteilungen*, 31/41. Jg. (2001), 282—89.

dhe donacioneve për furnizim me pajisje dhe produksion.

Shkaku i hapësirës gjithnjë të ndryshueshme mediale, shpesh është vështirë që dikush nga jashtë të mbledh informata precize. Të dhënat që merren jo vetëm që ndryshojnë prej burimi në burim tjetër por shpesh janë të vjetruara nga momenti i shpalljes.

2.1. Mediat transmetuese në gjuhën maqedone. Transmetuesi publik MRTV (Radio Televizioni i Maqedonisë), një nga transmetuesit më të fortë në këtë sektor gjendet në udhëkryq — ka tepër shumë të punësuar, i ngarkuar me borxhe të mëdha, përdorë teknologji të vjetruar dhe përballët me rënie të shikueshmerisë. Shumica e Maqedonëve pa marrë parasyshë origjinën etnike, gjithmonë e ka konsideruar vetëm për transmetues “shteteror”. Koncepti i multi-etnicitetit të TVM-së u trashëgua nga era titoiste dhe bazohet në sistem të kuotave të ndara të produksionit për gjuhën shqipe, turke, rome, vllahe dhe serbo-kroate. Derisa *MTV 1* dhe *MTV 2* transmetojnë program në gjuhën maqedone, programet në gjuhët tjera transmetohen në kanalën e tretë, *MTV 3* të krijuar në vitin 2002.

Cilësia e mediave private elektronike në gjuhën maqedone ndryshon në masë të madhe. Ekzistojnë dy kanale kombëtare të dhëna me qira në gjuhën maqedone (*Sitel* dhe *A1*), prej të cilave *A1* është më i popullarizuar, i pavarur dhe i respektuar. *A1* ka publikë të gjërë pa marrë parasyshë përkatësinë e tyre etnike dhe preferencat gjuhësore. Mirëpo, ai në mënyrë të kufizuar mbulon lajmet që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të komuniteteve tjera. *Sitel* është orientuar shumë politikisht ku gjatë vitit 2001—2002 Shqiptarët e konsideronin si armiqesor.

Përpos këtyre përjashtimeve të vogla, standardi i produksionit të lajmeve i mediave private elektronike në gjuhën maqedone është shumë i ultë dhe shpesh i ngjyrosur politikisht. Gjithashtu mungon marketingu, publiku, hulumtimi dhe programimi i qelluar. Pagat janë të ulta ndërsa aftësitë menaxhuese janë minimale. Shumë transmetues lokal shpresojnë për ndryshime të ligjit, të cilat do t'ju mundësonin të bëhen transmetues regional ashtu që të rrisin përparësinë e tyre konkurruese.

Radio tregu është gjithashtu i stërmbushur sikur ai televiziv. Ekzistojnë më shumë se njëqind radio stacione të licencuara dhe të pa licencuara, me 56 stacione në gjuhë maqedone që ofrojnë programe në gjuhë tjera.

2.2. Mediat transmetuese në gjuhën shqipe. Në gusht të vitit 2002, dy ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore, programi në gjuhën shqipe në MTV 3 papritmas u zgjerua nga dy orë e gjysmë në nentë orë për ditë, në bazë të aplikimit të rregullave të Marrëveshjes së Ohrit. Kjo u mirëpritë nga koalicioni qeverisës (VMRO-DMNE, PDSH) si shenjë e qartë që Qeveria mbështet të drejtat gjuhësore shqiptare. Mirëpo, si duket personeli që punonte në deskun e gjuhës shqipe nuk ishte në gjendje të shfrytëzojë më së miri këtë kohë të shtuar për transmetim. Shumica e skemës së re programore përbëhej nga shou programet e recikluara muzikore shqipe dhe nga telenovelat latino-amerikane të titruara shqip. Zgjerimi i programit shqip ishte në dëm të programeve në gjuhët tjera që u zhvendosën në termine jo të popullarizuara kohore. Skema e aprovuar kohë më parë përmbanë dy orë e gjysmë program ditor në gjuhën turke. Programet në gjuhën vllahe, rome, serbe, kroate dhe boshnjake janë të kufizuara në gjysmë ore nga tri herë në javë dhe njëherë në javë jepet programi një orësh në secilën nga këto gjuhë. Kjo skemë e re programore nuk ka promovuar

unitet ndër-etnik mes deskëve në gjuhë të ndryshme pranë *MRTV*-së ndërsa ankësat, që të drejtat e tyre lihën anash, arrijnë pandërprerë nga deskët më të vogla. Përpos kësaj, mungesa e financave për pajisje, personel profesional apo programe të mirëfillta ka domethënie që *MTV 3* siq duket është terheqese për një numër shumë të vogël shikuesish madje edhe në mes të grupeve të veta të parapara. Shumë ekspert për media konsiderojnë që *MTV 3* në formën e tashme, nuk është e konceptuar si duhet dhe që është dështim. Megjithatë, në vitin 2003 janë treguar shenja që drejtoria e re e vendosur reformiste e *MRTV*-së përpjekët të zgjidh disa nga problemet kryesore që e mendojnë këtë organizatë. Drejtori i ri gjeneral, Gordana Stoshiq, tashmë ka paralajmëruar krijimin e ekipeve të përziera redaktuese për programet shumë-gjuhësore.¹⁰

Njëmbëdhjetë TV stacione lokale në pronësi private, kryesisht në pjesët perendimore dhe veriore të vendit transmetojnë program në gjuhën shqipe. Ekzistojnë ndryshime të mëdha në cilësi dhe sasi të programeve të tyre por shumica prej tyre vuan nga problemet e njejta të situatës së rëndë financiare, me personel të motivuar dobët që merr paga të ulta dhe njohuri të paktë profesionale mu sikurse edhe kolegët e tyre nga mediat private në gjuhën maqedone. Derisa shumë nga TV stacionet private që transmetojnë në gjuhën shqipe pohojnë që plotësojnë zbrazësirën informative të krijuar nga puna e dobët e *MTV 3* standardi i programeve të lajmëve në përgjithësi është i ultë. Gjatë konfliktit të vitit 2001 dhe para zgjedhjeve të vitit 2002, stacionet shqiptare shpesh kanë treguar njëanshmëri eklatante dhe reaksionet e tyre pak janë dalluar nga shumica e atyre në gjuhën

¹⁰ Cituar nga intervista me Gordana Stoshiq. *Forum*, nr. 121 (17. 1. 2003), 29.

maqedone. Mirëpo, ka disa përjashtime të dukshme: si për shembull, *TV Era* (Shkup), *TV Art* (Tetovë) dhe *TV Hana* (Kumanovë) si dhe *Radio Vati* (Shkup) që kanë mbajtur politikë të pavarur redaktuese dhe janë disa ndër transmetuesit shqip privat që premtojnë më së shumti.

Nga pesë radio-programe të ndryshme kombëtare që ofron *MRTV*-ja, vetëm *Radio 2* i kushtohet komuniteteve etnike. Për fat të keq, ka një publikë të paktë, jo më shumë se 5 përqind. Njezet e nentë radio-stacione publike lokale transmetojnë programe në gjuhë tjera (varësisht nga përbërja e popullsisë), por sikurse TV stacionet publike lokale as ato gati që nuk kanë ndikim.

Nga ana tjetër, ekzistojnë 17 radio-stacione private lokale që transmetojnë program në gjuhë tjera, duke përfshirë gjuhën shqipe, turke dhe rome. Disa nga to ofrojnë programe në më shumë se një nga këto gjuhë. Sikur në të gjitha mediat në pronësi private, cilësia e programit ndryshon pabesueshëm. Duke ndjekur trendin e përgjithshëm global kah “tabloidizimi” këto media shpesh prodhojnë programe për argëtim dhe nuk bëjnë “vegla” për informim dhe arsimim të shpejtë dhe frytdhënës. Disa nga radio-stacionet lokale nuk janë asgjë më tepër nga një magnetofon dhe mikrofon kurse transmetimin e bëjnë nga ndonjë kasolle.

2.3. Mediat e transmetuara në gjuhën turke. Përzgjedhja e mediave elektronike në gjuhën turke është e kufizuar. *MTV 3* ofron program mjaft të shkurtër në gjuhën turke ndërsa komuniteti percjell programe satelitore nga Turqia. Për ta përmirësuar këtë situatë, disa gazetarë me origjinë turke themeluan në vitin 2001 “Organizatën për zhvillim të mediave në gjuhën turke në Maqedoni” (www.turkishmedia.org.mk). Oranizata për mo-

ment bën përpjekje për përmirësim të nivelit profesional dhe arsimor të gazetarëve të rinj ashtu që komunitetit të tyre ti ofrojnë qasje më të mirë informatave në gjuhën e tyre amtare.

2.4. Mediat e transmetuara në gjuhën rome. Ekzistojnë dy TV stacione që i drejtohen komunitetit romë: *TV BTR Nacional* dhe *TV Satel*. Të dyja gjenden në paralagjen rome të kryeqytetit Shkupit dhe transmetojnë edhe në gjuhën rome dhe (kryesisht) në maqedone. Ato ofrojnë shërbim të rëndësishëm publik, me dhënie të lajmeve, programeve arsimore, gjuhësore dhe kulturore nga kultura në gjuhën rome por tentojnë të fokusohen më tepër në argëtim. Është interesante që këto stacione kanë shikues edhe Romët edhe Maqedonet që përcjellin me endje muzikën tradicionale dhe komeditë lokale që ofrohen.

Situata e radio-stacioneve në gjuhën rome është mjaft jo stabile: derisa *Radio Cerenja* (Shtip) ia del të mbijetojë me ndihmë nga donatorët, stacionet tjera siq është *Radio Ternipe* (Gostivar) luftojnë pa kurrfarë të ardhura, pajisje të dobëta teknike, fuqi të pamjaftueshme punëtoare etj. TV dhe Radio stacionet rome lëngojnë nga mungesa e financave të duhura çka sjell deri të përdorimi i pajisjeve të stër-vjetruara dhe problemet e shpeshta teknike. Mirëpo, TV dhe radio stacionet në gjuhën rome janë në mësin e pak emetuesve shumë-gjuhësor të vertetë që punojnë së bashku dhe i takojnë edhe komunitetit romë edhe maqedon.

2.5. Mediat e transmetuara në gjuhën vllahe. Ekziston shumë pak TV dhe radio program në gjuhën vllahe. *MTV 3* ofron një orë në javë kurse disa radio-stacione janë në përpjekje e sipër për të përfshirë edhe programet në gjuhën vllahe.

2.6. Mediat e transmetuara në gjuhën serbe, kroate dhe boshnjake. Televizioni kroat, serb dhe malazez ndjekën pa problem dhe terhejtin një publikë të konsiderueshme si pasojë e shtrirjes së njohurisë së gjuhëve dhe me ndihmën e titrave. TV kanali i nohur serb *TV Pink* josh publikun në numër të konsideruar me muzikën e vet popullore dhe argëtim. *MTV 3* ofron program një orësh në këto gjuhë.

III. Mediat dhe programet shumë-gjuhësore kundër gjuhës së urrejtjes

Konflikti nga shkurti i vitit 2001 solli “gjuhën e urrejtjes”: shumica e mediave në gjuhën maqedone përdornin shprehjen “terroristet” gjatë përshkrimit të komunitetit etnik shqiptar, përderisa mediat në gjuhën shqipe numronin keqtrajtimit e pretenduara të drejtave të njeriut nga ana e forcave maqedone të sigurisë. Gjatë konfliktit dhe menjëherë pas përfundimit të tij mediat publike dhe private kanë qenë shpesh fajtores për dezinformata nxitëse kurse të pakta kanë qenë tentimet për tu treguar edhe ana tjetër e tregimit. Për shembull, TV stacioni në gjuhën maqedone *Channel 5* ka transmetuar raportin ku shfaqet raportuesi i cili nga një shtëpi gjuan me plumba drejt pozitave shqiptare përderisa TV stacioni lokal në gjuhën shqipe, me emër i pavarur, transmetoi filmin dokumentar njëorësh për Armatën Kombëtare Çlirimtare Shqiptare ku gjatë kësaj nuk kishte hulumtuar asnjë qendrim të kundërtë. Ngjashëm me këto, gazetaret ditore shqipe *Fakti* dhe *Flaka* u bënë haptas politike dhe ishin për luftën shqiptare përderisa deri atëherë relativisht e pavarur, ditorja në gjuhën maqedone *Dnevnik* ishte bërë karakteristike e nacionalizmit maqedon.

MRTV-ja u bë vegël propaganduese e posaçme efikase në duartë e politikanëve nga të dy anët e konfliktit. Ndasia e transmetimit mes programeve të gjuhëve të ndryshme të përshkruara më lartë, e bëri të mundur ndikimin e dyfishtë — derisa elita qeverisëse maqedone u koncentrua në kontrollimin e programit të lajmeve në gjuhën e tyre në *MTV 1*, partive shqiptare qeverisëse (cilado që ishte në koalicion qeveritar në atë kohë) ju lejua të dominojnë programet në gjuhën shqipe. Kjo solli deri te pasoja jo e zakonshme — që gjatë kohës së konfliktit *MRTV*-ja emetonte buletine plotësisht të ndryshme të lajmeve në gjuhën shqipe dhe maqedone. Kjo është vërejtur për herë të parë gjatë Krizës Kosovare në vitin 1999, kur mospajtimi për intervenimin e NATO-s, posaçërisht tek Shqiptarët dhe Maqedonët u bë i dukshëm. Shërbimi në gjuhën shqipe u tubua rreth përkrahjes së kushërinjve të vetë në Kosovë dhe prandaj e përkrahte intervenimin e NATO-s që ishte në kundërshtim direkt me atë çka pohonte qeveria në *MTV 1*. Gjatë kësaj periudhe u lajmëruan shenjat e para të konfliktit të mundshëm, pasi që shumë Maqedonë e shihnin pozitën e shqiptarëve si shenjë të “separatizmit shqiptarë”, derisa popullsia shqiptare ndjehej e përjashtuar dhe e akuzuar nga ana e Maqedonëve.¹¹

Pas Marrëveshjes së Ohrit të 13 gushtit 2001, gjuha e urrejtjes u zhduk nga skena mediale maqedone por politizimi dhe polarizimi kanë mbetur. Një komentues maqedon në vitin 2000 theksoi: “Ne nuk kemi gjuhë të urrejtjes por kemi gjuhë të frikës. Nuk e dijmë çka

¹¹ Dy publikime të reja pasqyrojnë këtë çështje nga pikëpamje të ndryshme. *Shihe* Dona Kolar-Panov, “Troubled Multicultural Broadcasting in Macedonia”, *Journal of Socio-Linguistics* (2002), në botim, dhe Veton Latifi, *The Two Truths and Two 'Publics' in Macedonia*, në botim.

shqiptarët mendojnë sepse nuk e dijmë gjuhën e tyre. Ashtu që ata na frigojnë nëve (...).”¹² Këto fjalë vlejné sot e kësaj dite dhe saktësisht e përshkruajnë situatën në shoqërinë dhe mediat maqedone. Mediat janë të ndara sipas gjuhëve, ashtu që sëcila media informon komunitetin e vet etnik dhe shumë pak ka tentime që të zbulohet çka komuniteti tjetër etnik mendon apo flet në media. Ka shumë pak gazetari inkluzive ose programe dhe gazeta të përziera gjuhësore. Kjo është habitëse duke konsideruar faktin që pjesëtarët e grupeve të ndryshme etnike në vend sipas rregullit flasin disa gjuhë. Shqiptarët zakonisht flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe, maqedone, turke¹³ dhe serbo-kroato-boshnjake.¹⁴ Turqët flasin gjuhën turke, maqedone ndonjëherë edhe shqipe¹⁵, e gjithashtu serbo-kroato-boshnjake. Pjesëtarët e komunitetit romë flasin gjuhën rome dhe maqedone, ndonjëherë shqipe dhe serbo-kroato-boshnjake. Vllahët, grupi më i vogël flasin gjuhën vllahë dhe maqedone, serbo-kroato-boshnjake madje edhe greke. Serbët zakonisht flasin rrjedhshëm gjuhën serbe dhe maqedone. Për dallim nga të tjerët, Maqedonët zakonisht nuk flasin asnjë nga gjuhët

¹² Mark Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo. International Assistance to Media* (Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2000), 6.

¹³ Disa prej tyre flasin turqisht pasi ka pasur migrim të dhunshëm nga qeveria e Mbretërisë Jugosllave mes dy luftërave botërore, të Shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia në Turqi. Mijëra prej tyre ishin të përndjekur. Disa u kthyen pas Luftës së Dytë botërore. Disa kanë mbajtur lidhje me të afërmit e tyre në Turqi dhe dërgojnë fëmijët e tyre për shkollim atje, etj.

¹⁴ Është trashëgimi historike ku gjuha serbo-kroate ka qenë gjuhë e kuptimit. Kjo posaçërisht reflektohet në popullatën e arsimuar mbi 25 vjeçare. Në këtë artikull shprehja “serbo-kroato-boshnjake” është përdorur herë pas here për të zëvendësuar serbo-kroate.

¹⁵ Shqip flasin vetëm ata që jetojnë në rajonet e banuara kryesisht me Shqiptarë.

tjera që flitën në vend. Përrjashtim bën gjuha serbo-kroate, gjuhë e kuptimit në ish Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Me dallueshmërinë e gjuhëve që flasin pjesëtarët e grupeve nacionale, njeriu do të supozonte që ekziston një potencial për bashkëpunim mes mediave të ndryshme si dhe treg i madh për mediat shumë-gjuhësore. Për fat të keq, rasti është i kundërtë posaçërisht në mediat në gjuhën shqipe dhe maqedone. Përkundër të gjithave ka shembuj pozitiv (shih më poshtë). Një pengesë tjetër për zhvillimin e mediave shumë-gjuhësore është mungesa e gazetarëve të arsimuar. Edhe pse ka disa vite që arsimimi i gazetarëve ka qenë prioritet i OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare që punojnë në sferën e zhvillimit medial, aftësia e gazetarëve në këtë vend, pa marrë parasyshë prejardhjen etnike, është nën standardet evropiane. Situatën e bën më të keqe programi i vjetruar arsimor në studime për media në Universitetin Shen Kirili dhe Metodi në Shkup, ku pos tjerash trajnohet një numër shumë i vogël i atyre që nuk kanë prejardhje maqedone. Në vitin 2003, për shembull, ka qenë vetëm një student shqiptar që studionte gazetarinë në universitet. Në Universitetin e Evropës Jug-lindore në Tetovë për momentin nuk ka grup për gazetari.

Bashkësia ndërkombëtare është munduar të promovojë mediat shumë-gjuhësore. OJQ “Kërkimi i terrenit të përbashkët” publikon gratis revistën mujore *Forumi shumë-gjuhësor*, që shtypet në gjuhën maqedone, shqipe dhe angleze dhe shpërndahe si shtojcë e *Dnevnik-ut* si dhe gazetës *Fakti* dhe *Utrinski Vesnik*.

Në shtator 2002 erdhi deri të projekti interesant me gazetën ditore dygjuhësore në pronësi private *Global* (maqedonisht dhe shqip). U publikua në dy botime të veçanta — një botim në gjuhën maqedone dhe një në

shqipe. Ishte një përpjekje ambicioze për sigurim të lajmeve dhe informatave derisa provohej të tejkalohen barrierat gjuhësore mes lexuesve të saj. Për fat të keq, pas fillimit plotë premtive, shpërndarja u ndërpre në dhjetor të vitit 2002 siq duket shkak i problemeve financiare.

Gostivar Voice, edhe një nismë interesante, gazetë dyjavore në gjuhën shqipe, maqedone dhe turke që botohet në regjionin e Gostivarit ndërsa krijohet nga një grup ndër-etnik i gazetarëve të rinj. E financuar nga OSBE Misioni Hulumtues Monitorues në Shkup dhe nga Organizata Internacionale për Migrim (IOM), e implementuar përmes “Projektit ndër-etnik Gostivar” me qëllim që projekti të krijojë një forum politikisht të pavarur ndër-etnik për lajmet lokale komunale ku do të shërbehej regjioni i Gostivarit i cili ka mungesë të mediave të shtypura. Qëllimi i këtij projekti që ngërthen bashkëpunim ndër-etnik dhe ndërtim të besimit është t’ju ofrojë rastin gazetarëve dhe redaktorëve të rinjë dhe pastaj gjithashtu të ndihmojë në promovimin e kuptimit më të mirë mes grupeve etnike. *Gostivar Voice* është apolitik dhe i shmangët çfarëdo komentit politik dhe çështjeve të cilat mund të janë diskutabile në ambientin shumë-etnik. Gazeta prej tetë faqeve shtypet në tri versione të ndara: në gjuhën shqipe (1.500 ekzemplarë), maqedone (1.000 ekzemplarë) dhe turke (500 ekzemplarë). Përmbajtja e tri versioneve është identike.

Projekti më i ri *POINT* është gazeta studentore me tetë faqe nga regjioni i Tetovës që shtypet në gjuhën maqedone dhe shqipe dhe i drejtohet interesimeve të përbashkëta të njerëzve të rinjë. Me ndihmën e OSBE-së dhe Organizatës Internacionale për Migrim (IOM), *POINT* do të botohet çdo dy javë me numër të ekzemplarëve të shtypur prej 10.500 nga të cilat 2.500 do të janë në

gjuhën maqedone ndërsa 8.000 në gjuhën shqipe. Gjithashtu planifikohet edhe botimi në gjuhën turke.

Pesë TV stacione lokale të pavarura private bashkëpunojnë nga vera e vitit 2002. Tri stacione në gjuhën maqedone, *TV Tera* (Manastir), *TV Vis* (Strumica), *TV Zdravkin*, dhe dy stacione në gjuhën shqipe, *TV Art* (Tetovë) dhe *TV Era* (Shkup), punojnë në produksionin e programit mbi ngjarjet e rëndësishme ashtu që t'i prezantojnë publikut informata nga gati të gjitha regionet e vendit. Programi ka titra çka zakonisht ju mungon shumicës së programeve të transmetuara. Nga njëra anë, këto produksione kanë për qëllim të përforcojnë bashkëpunimin profesional dhe shkëmbimin e programeve mes stacioneve të drejtimeve të ndryshme etnike. Nga ana tjetër, strategjia është që të përforcohen këto TV stacione ashtu që më shumë të fokusohen në lajme lokale ashtu që do të mbulojnë temat në mënyrë profesionale dhe me përgjegjësi, që është relevante për të gjithë banorët. Kjo me vete sjell vetë-hulumtimin mbi llojlloshmërinë e shikuesve mes komuniteteve të ndryshme etnike dhe grupeve gjuhësore.

Radio Jeta është radio-stacion i pavarur dygjuhësor që emeton program në gjuhën maqedone dhe shqipe në hapësirën e Shkupit. Fillimisht u themelua me të holla të donatorëve ndërkombëtar në mars të vitit 2001. Programet udhëheqën nga një udhëheqës maqedon dhe nga një udhëheqës shqiptar, të cilët përdorin teknikën e parafrazimit për të prezantuar së bashku programin në dy gjuhë. Teknika bilinguale është hap drejt diverzitetit dhe tolerancës në mediat maqedonase. Radio-stacioni ka ithtarë të flaktë në mesin e të rinjve. *Radio Tetova*, *Radio Semi* (Dibër) dhe *Radio Albana* (Kumanovë) që punojnë sipas menaxhimit vetanak janë dakorduar të ritransmetojnë të gjitha programet.

IV. Veprimet më të mira

Projekte të ndryshme tashmë ekzistuese apo të planifikuara do të paraqiten në këtë kapitull. Të gjitha ato merren me sfidat multi-etnike për të zbuluar zgjidhje të përdorshme dhe joshëse për kërkesa të ndryshme në sferë të mediave të shtypura dhe të transmetuara.

1. TV Tera: “Diferencat na bashkojnë”. Stacioni privat lokal promovon një kombinim shumë specifik të aspekteve ndëretnike dhe dygjuhësore apo shumë-gjuhësore. *TV Tera* ka filluar një projekt regional jashtë kufijve, që është orvatja e parë për të shfaqur pamjen multi-etnike të regjionit jug-perëndimor të vendit, një pjesë të Greqisë dhe pjesës jug-perëndimore të Shqipërisë. Produksioni përmbanë gjashtë emisione që shfaqin grupe të ndryshme etnike (Maqedonët, Grekët, Shqiptarët, Vllahët, Turqët, Romët etj) nga ky regjion. Dokumentarët “Diferencat na bashkojnë” merren me çështje të këtyre grupeve etnike që kanë të bëjnë me çështje ligjore, aktivitete të tyre dhe në përgjithësi mënyrën e tyre të jetesës, çështje të rrefyera dhe tradicionale, zgjidhje për konflikte tradicionale dhe shansat për shoqëri shumë-etnike nga pikëpamja mikro (lokale) dhe makro (tej regjionale — tej kufirit). Qellimi i projektit është të prezantojë përmes rrefimeve jetësore të popullsisë, e cila me shekuj ka jetuar në hapësirë të njejtë, idetë për një shoqëri të hapur dhe të një bashkëpunimi të ardhshëm tej regjional mes komunave dhe bashkësive si një mjet me rëndësi në ndërtimin e besimit, çka ndalon mbizotërimin e paragjyqimeve dhe gjysmë të vërtetave. Fjalët origjinale, të shprehura në gjuhën amtare të folësve, do të jenë të titruara në gjuhën maqedone ndërsa produksioni do ti ofrohet TV stacioneve lokale në Korçë (Shqipëri) dhe Kozan (Greqi) me titra në gjuhën shqipe dhe greke sipas kërkesës.

2. TV M: “Kronikat e liqenjve”. TV M është TV stacioni në gjuhën maqedone që transmetohet në Ohër, Strugë dhe rajonin përreth. Para pak kohesh kanë nisur programin e ri regional të quajtur “Kronikat e liqenjve”. Ky program do të ofrojë lajme të zgjeruara dhe të llojllojshme nga tërë regjioni i Strugës, Ohrit dhe rreth liqenit të Ohrit, të njohur mirë nga fakti që është i banuar me shumë grupe etnike qysh nga kohërat e lashta (Maqedonët, Shqiptarët, Turqët, Vllahët, Egjiptasit, Serbët etj.).

3. Radio Cerenja. Kjo është një media në gjuhën rome me ekipin etnikisht të përzier redaktues (Romët, Turqët dhe Maqedonët). Ata do të inicojnë projektin shumë-gjuhësor që përbëhet nga programet në gjuhën turke dhe vllahe (sëcili nga një orë në javë). Do të sigurojë informata mbi vetëqeverisjen lokale, arsimimin, ngjarjet kulturore, traditat dhe zakonet. Programet duhet të mbulojnë punët rrjedhëse me 60 përqind të kohës ndërsa 40 përqind të kohës do të mbulohen me muzikë. Ky është një eksperiment shumë i rëndësishëm që jep shpresë, pasi që do të thotë që radio-stacioni romë ndoshta do të bëhet platformë për grupet tjera gjuhësore dhe do të ndihmojë në forcimin e tolerancës dhe bashkëpunimit mes komuniteteve etnike.

4. Desku i qytetit, Tetovë. Ky projekt është desk shumë-gjuhësor në Tetovë dhe i dedikohet mbulimit të lajmeve ditore nga rajoni i Tetovës për të gjitha mediat. Projekti u themelua sipas idesë së gazetarëve lokal ndërsa u inicua nga Njësia për zhvillimin e mediave të Misioinit Hulumtues Monitorues të OSBE-së në Shkup në prill të vitit 2002 si masë për ndërtimin shumë-etnik të besimit në ish rajonin e krizës.

Projekti promovon dhe mundëson bashkëpunimin mes gazetarëve që punojnë në gjuhën shqipe dhe maqedone. Qellimi i tij është të përmirësojë qasjen ndaj informatave, zgjerimin e listës së lajmeve që publiku të shërbehët më mirë, të promovojë lajme dhe mirëkuptim multi-etnik sikurse edhe të ngritë standardet e përgjithshme të gazetarisë. Qellimi i tij primar është prodhimi i lajmeve të hulumtuara në tërësi, të barazpeshuara dhe objektive. *Desku i qytetit* prodhon lajmet kryesore ditore që kanë të bëjnë me rajonin, për spektër të gjerë të temave duke përfshirë edhe ekonominë, mbrojtjen e mjedisit dhe kulturën. Tregimi që përbën lajmin hulumtohet, prodhimi bëhet nga ekipet etnikisht të përziera dhe atë pastaj e transmetojnë gratis edhe në gjuhën maqedone edhe shqipe të gjitha TV dhe radio stacionet në regjion. Përpos kësaj, TV stacioni kombëtar A 1 dhe TV kanalet e ndryshme në Shkup gjithashtu i transmetojnë ato lajme.

V. Përfundim

Kushtet e tanishme të punës për media, pa marrë parasyshë gjuhën, janë shumë të vështira. Të gjitha 926 mediat e shtypura të regjistruara dhe 157 TV dhe radio transmetues luftojnë për të mbijetuar. Kjo nuk është detyrë e lehtë duke marrë parasyshë tregun mjaftë të kufizuar dhe ambientin e dobësuar ekonomik. Cilësia e raportimit ndryshon tëpër shumë, ndikimet politike janë të përhapura dhe standardet gazetare duken të paarritshme.

Pas periudhës së qetë nismëtare pas konfliktit, tensionet mes popullatës maqedone dhe shqiptare kulminuan me luftëra në shkurt të vitit 2001. Konflikti ka ndi-

kuar në mënyrë dramatike në mediat e vendit. Gjuha e urrejtjes u bë instrument efikas për promovimin e ekskluzivitetit etnik në duartë e disa forcave politike. Pas lidhjes së Marrëveshjes së Ohrit me 13 gusht 2001, pushkët heshtën, gjuha e urrejtjes u zhduk nga skena mediale dhe tani ekziston numër i madh i mediave që funksionojnë në gjuhë të ndryshme. Mirëpo, ndarjet etnike në media janë akoma prezente. Mediat edhe më tej i drejtohen vetëm një publiku etnik dhe nuk arrijnë të merren edhe me çështje jashtë atij grupi. Ka shumë pak gazetari inkluzive etnike, gazeta shumë-gjuhësore dhe programe shumë-gjuhësore në radio dhe televizion. Për këtë arsye mediat akoma nuk janë në gjendje të promovojnë tolerancën mes grupeve të ndryshme gjuhësore në vend.

Sot ekziston një mori idesh dhe iniciativash se si mediat duhet të promovojnë tolerancën dhe mirëkuptimin. Përvojat kanë inkurajuar qasje të reja, shumë projekte të reja që premtojnë veç kanë filluar dhe shumë tjera janë në vazhdimësi apo presin të aplikohen.

Bibliografia

EastWest Institute, Letër pune për projektin e tryezës së rrumbullaktë mbi bashkëpunimin përtej kufijve. Projekti i institutit EastWest që përmirëson dialogun dhe bashkëpunimin ndëretnik përmes bashkëpunimit në regjionin e liqenit të Prespes/Ohrit — sipas theme-limit të Euroregjioneve. Mbledhja 8—9. nëntor 2002 në Korçë, Shqipëri.

Forum, nr. 121 (17. 1. 2003), 29.

Kolar-Panov, Dona, dhe Van den Haute, Francis, dhe Markovik, Marjan (red.), *MAP 2000 — Projekti i hulumtimit të publikut maqedon të mediave*, Instituti për hulumtime sociologjike, politike dhe juridike (Shkup, 2000).

Kolar-Panov, Dona, "Transmetimi problematik multikulturor në Maqedoni", *Zhurnali për sociolinguistikë* (2002), në shtypje.

- Melciq, Dunja**, "Zwischen Pluralismus und Denkdiktatur: Die Medienlandschaft", in id. (red.), *Der Jugoslawienkrieg. Handbuch zur Vorgeschichte, Verlauf und Konsequenzen* (Opladen, 2002), 317—31.
- Nineski, Blagoja**, *Lokalnite elektronski mediumi vo Makedonija* (Prilep, 1998).
- Nineski, Blagoja**, *Pecatenite i elektronskite mediumi vo Makedonija* (Shkup, 2000).
- Nicolet, Claude**, "Medien in Mazedonien: Zwischen Kriegshetze und Friedensförderung", *Südosteuropa Mitteilungen*, 31/41 Jg. (2001), 282—89.
- Sovet za radiodifuzija na Republika Makedonija**, *Informacija za radio i TV programite na jazicite na nacionalnostite na elektronskite mediumi vo RM* (Skopje, 2002).
- Thompson, Mark**, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia and Kosovo. International Assistance to Media* (Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2000).
- Trpevska, Snezana**, "Das Mediensystem Mazedoniens", in Hans-Bredow-Institut (ed.), *Internationales Handbuch* (Baden-Baden, 2002), 425—35.

Rekomandimet

Për të tejkaluar hendekun mes komuniteteve të ndryshme, parakushtet juridike kanë rëndësi kyçe:

- Disa grupe punuese tani përpunojnë draftin e ligjit për transmetim. Kjo rregullore e ndryshuar, e plotë dhe e fortë do të ketë rëndësi për aplikimin e ligjeve ekzistuese si dhe për luftën me veshtirësitë e njohura, siq është tregu i stërmbushur medial pranë konkurrencës jo të drejtë.
- Ligji i ri kundër piraterisë transmetuese do të përmiresojë produksionin vetanak i cili nga ana tjetër do të pasqyrojë më mirë shoqërinë e begatshme dhe të llojlojshme të vendit.

Për përmiresimin e sferës së përbashkët publike dhe eliminimin e paragjyqimeve dhe mos diturisë:

- Mediat në të gjitha gjuhët që flitën në vend duhet të tentojnë kah mbajtja e strukturës multi-etnike të vendit, në vend që të fokusohen vetëm në komunitetin e tyre. Kjo mund të arrihet me më shumë “gjuhë pozitive” të njerit për tjetrin, duke i kushtuar vëmendje më tepër problemeve të përbashkëta dhe çështjeve të përditshme të cilat ndikojnë në tërë popullsinë, në vend të informimit në bazë të orientimit etnik.
- Veprimet sikur shkëmbimi ndër-etnik i programeve, redaksitë e përbashkëta dhe ekipet e përzi- era redaktuese kanë rëndësi kyçe. Më tutje, një mënyrë shumë e lehtë dhe e thjeshtë e depërtimit të publiku i gjërë është titrimi i programit. Për moment, *MRTV* nuk është në gjendje të ofrojë program shumë kanalesh të zërit, por ndoshta në të ardhmën ky shërbim shumë i dobishëm do të mund të ekzekutohet.
- Do të duhej forcuar prodhimin e lajmeve lokale që të reflektohen nevojat e popullatës lokale dhe të mbulohen çështjet relevante për të gjithë banorët duke përfshirë pikëpamjet e ndryshme të komuniteteve të ndryshme. Procesi i themelimit

të vetëqeverisjes lokale që është në nismë e sipër, ofron mundësi të mëdha posaçërisht mediave të minoriteteve për të luajtur atë rol të rëndësishëm.

Arsimimi dhe hulumtimi kërkojnë vëmendje të posaçme:

- Hulumtimet duhet inkurajuar dhe mbështetur shkaku i ngritjes së diturisë mbi mediat. Hapat e parë, që përbëhen nga shqyrtimi profesional dhe monitoringu medial, tashmë janë ndërmarrë, por është e nevojshme që kjo të bëhet në mënyrë të rregullt dhe të zhvillohet ashtu që të garantojë hulumtim dhe shqyrtim të përhershëm. Ato rezultate duhet shpërndarë nëpër media, komunitet, organizata e tjera, ashtu që të përmirësohet shkëmbimi mes shfrytëzuesve dhe gazetarëve.
- Arsimimi gazetarë është i rëndësishëm kryesorë. Duhet zhvilluar dhe forcuar të gjitha nivelet e arsimimit. Edhe pse OJQ-të mediale përqendrohen në trajnimin e gazetarëve, Dega për gazetari e Universitetit Shen Kirili dhe Metodi në Shkup është në periudhë transformimi. Programet arsimore duhet të modernizohen ndërsa ligjeratat duhet përshtatur që ti përgjigjen kërkesave reale të gazetarisë moderne. Arsimimi dhe trajnimi në raportimin mbi çështjet e diverzitetit duhet përmirësuar dhe forcuar.

Për të forcuar këmbimin dhe interaksionin brenda popullatës në përgjithësi dhe për të inkurajuar komunikimin ndër-kulturor në të gjitha nivelet (nacionale, regjionale, lokale dhe tej kufijve), mediat akoma janë të varura nga mbështetja dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare. Angazhim i mëtejshëm dhe mbështetje substanciale e bashkësisë ndërkombëtare janë të nevojshme në ardhmëri.

Romain Kohn
Luksemburg

Luksemburgu është një shoqëri e posaçme. Ajo është po aq shumë-kulturore sa edhe shumë-gjuhësore. Siq kishte vërejtur sociologu Fernand Fehlen: “Nëse ekziston ndonjë kompetencë specifike gjuhësore e Luksemburgave atëherë ajo është shumë-gjuhësia.”

Në Dukatën e Madhe bashkë-ekzistojnë tri gjuhë: luksemburgase, frenge dhe gjermane. Deri me tani nuk ka pasur kurrfarë hierarkie politike apo kulturore mes tyre. Përdorimi i gjuhëve varët kryesisht nga situata së ku gjendeni. Për shembull përdorimi i gjuhëve në media është i ndërlikuar dhe nuk është lehtë të kuptohet nëse nuk jeni vendas. Prap se prap, nuk ekzistojnë rregulla të përpikta dhe ato që ekzistojnë është gjithnjë e më vështirë të definohen. Deri në kohët e fundit gjuhë e shtypit ka qenë gjermanishtja e pastër (edhe pse ka pasur gjithmonë artikuj në gjuhën frenge, e ndonjëherë në luksemburgase dhe angleze në çdo botim). Kjo është akoma gjuhë dominante e mediave të shtypura në tërësi por kohëve të fundit janë shfaqur disa gazeta njëgjuhësore frenge. Në radio dhe televizion gjatë tërë kohës flitet gjuha luksemburgase. Disa programe lokale transmetohen në gjuhën angleze dhe romane.

Ashtu që, përderisa gjermanishtja mbetet gjuha më prominente e shtypit ndërsa radio dhe televizioni transmetojnë në gjuhën luksemburgase, administrata gati ekskluzivisht përdorë gjuhën frenge. Është e dukshme që gjuha frnge ka përparuar në jetën e përditshme nga

viti 1990 si gjuhë e kuptimit. Këtij trendi i kundërvihet fakti që Qeveria mbështet idenë e integrimit të imigranteve në shoqërinë lokale që duhet bërë përmes pranimit të gjuhës lokale. Në të vertetë, rëndësinë e gjuhës luksemburgase dhe përdorimin e tri gjuhëve të përbashkëta pa paragjykimë, shumica e popullatës e konsideron si pikë qendrore të identitetit të tyre kombëtar.

Kjo nuk është aq e çuditshme nëse merret parasyshë përbërja demografike e vendit (viti i referuar 2001). Nga 440.000 banorë të Dukatës së Madhe vetëm 277.000 ka pasaportën e Luksemburgut. Kjo do të thotë që joshitetasit përbëjnë gati 37 përqind të popullatës, prej së cilës Portugezët përbëjnë komunitetin më të madh të huaj prej 59.000 njerëzve. I shtoni kësaj rreth 89.000 Francezë, Belgë dhe Gjermanë të cilët çdo ditë pune udhëtojnë në Luksemburg nga vendi i tyre amë, pasi që janë të punësuar në Dukatën e Madhe. Nën këto rrethana është gati e pamundur të vërtetohet kush kujt kur i flet në cilën gjuhë. Ekzistojnë shumë variabiletete që ndikojnë në përdorimin e ndonjë gjuhe e jo ndonjë tjetre ashtu që është e pamundur të shkruhet lista e rregullave të sakta.

I. Prapavija historike

Luksemburg (Lucilinburhuc, në gjuhën e vjetër gjermane) u themelua si kështjellë në vitin 963. Ishte pjesë e përandorisë Romake të kombit gjerman dhe gjuha që fli-tej ishte dialekti i lartë gjerman.

Katër shekuj më vonë ai territor u zgjerua në veri dhe perendim dhe u nda në dy pjesë: francez (ku njerëzit flisnin gjuhën valone) dhe pjesën gjermane (ku përdorej dialekti i luksemburgut). Gjuha e shkruar dhe admi-

nistrative ishin të ndara sipas regjioneve, në frenge dhe gjermane, në formën e tyre të vjetër. Qyteti i Luksemburgut bënte përjashtim nga kjo rregullë: edhe pse i përkiste pjesës gjermane, administrata zgjodhi gjuhën frenge si gjuhë pune.

Gjatë okupimit të parë nga mbreti Lui XIV dhe trupat e tij, përdorimi i gjuhës gjermane gati tërësisht u ndalua. Një shekull më vonë, u ngritë rëndësia e gjuhës frenge dhe ajo depërtoi madje edhe në administratën lokale të regjionit gjerman. Por edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Napoleonit të vitit 1804 — Ligjit të parë francez të së drejtës civile, që ishte i domosdoshëm si kornizë shkakut i ekzistimit të shumë drejtave tradicionale të ndara në Francë para vitit 1789 — gjuha luksemburgase mbeti gjuhë të cilën e ndanin të gjithë.

Në vitin 1839, gjatë konferencës së Londres, Luksemburgu fitoi pavaresinë e vetë politike. Çmimi i paguar për këtë ishte ndarja e territorit. Mbreteria Belge fitoi pjesen valone ndërsa pjesa tjetër e territorit u bë ajo që sot quhet Dukata e Madhe e Luksemburgut atëherë e vendosur në regjionin ku flitej gjuha gjermane. Por, gjuha gjermane nuk e rrezikoi gjuhën mbizotëruese frenge pasi që mbreti holandez, Duka i Madh Uiliam II, nuk i mbështeti nëpunësit civil në atë çështje. Përfundimisht, Luksemburgasit e respektuar ia arritën të vendosin gjuhën frenge si gjuhë administrative, të gjykatës dhe politike.

Revolucioni industrial solli ndryshime të rëndësishme socio-demografike kah fundi i shekullit të nentëmbëdhjetë. Luksemburgu, i cili gjithmonë kishte qenë vend i varfër bujqësor, i detyruar që shumë banorë të vet ti dërgojë për të kërkuar jetë më të mirë përtej oqeanit, tani ishte terheqes për imigrantë, së pari nga Gjermania pastaj nga Italia. Pozicionimi gjuhësor u bë çështje politi-

ke. Për të shënuar distancën nga Konfederata Gjermane dhe Luksemburgu të mbrohej nga nacionalistet gjermanë është sjellur ligji me anë të cilit gjuha frenge u vu në pozitë të njejtë si gjuha gjermane, gjuhë të cilën fëmijët duhej ta mësonin në shkollë fillore. Programi final gjuhësor u definua me reformën gjithëpërfshirëse shkollore të vitit 1912.

Rëndësia e gjuhës luksemburgase për identitetin kombëtar të vendit u bë e evidente gjatë Luftës së dytë botërore kur Luksemburgu u okupua nga nacistet. *Gauleiter*-i gjerman (kryetari i qarkut) vendosi të bëjë regjistrimin e banorëve në tetor të vitit 1941 pasi që donte që banorët e Luksemburgut të shprehnin afërsinë e lidhjeve të tyre me kulturën gjermane. Secilit i kishin thënë të zgjedh “gjermane” tri herë, kur ta pyesin për gjuhën, shtetesinë dhe etnicitetin e tyre. Madje as fakti që nacistet i kishin paralajmëruar njerëzit për pasoja po të përgjigjeshin “luksemburgase” nuk i kishte penguar banorët vendas të përgjigjen mu ashtu. Pasi nacistet vërejtën krenarinë e atyre njerëzve për identitetin e tyre (më shumë se 95 përqind prej tyre kishin thënë “luksemburgase” si përgjigje në të tri pyetjet), i ndërprejnë numërimet.

II. Korniza juridike për media

Lirinë e të folurit dhe lirinë e shtypit e garanton neni 24 i Kushtetutës, që daton nga viti 1868: “Liria e të folurit në të gjitha rastet dhe liria e shtypit është e garantuar, i nënshtrohet evitimit të gjitha kundërvajtjeve të bëra gjatë shprehjes së atyre lirive. Nuk guxohet kurrë të përdorët cenzurimi. Depozite garantuese nuk guxohen kërkuar nga shkrimtarët, botuesit dhe shtypesit. [...]”

Përdorimi i gjuhëve u rregullua tek pas Luftës së Dytë botërore, kur pjesë të Kushtetutës u ndrruan në vitin 1948. Neni 29 thjeshtë thekson: “Ligji do të rregullojë përdorimin e gjuhës për qellime administrative dhe gjyqësore.” Neni i përparshëm 29 nga viti 1868 thoshte: “Përdorimi i gjuhës gjermane dhe frenge është opcional. Ai nuk mund të kufizohet.”

Në vitin 1984 është sjellur *Ligji për përdorimin e gjuhës*. Kushtetuta thirrej në këtë ligj që vinte qysh nga viti 1948 por është dashur të paraqitet një artikull në gazetën djathtiste gjermane në vitin 1980 që të fillohej procesi ligjvënës në Dukatën e Madhe. Neonacistet pohanin që Luksemburgasit flasin gjermanisht pasi që gjuha e tyre amtare është vetëm dialekt gjerman. Opinioni dhe politikanët u shqetësuan. Parlamenti aprovoi nismën me të cilën kërkohej nga Qeveria të përgadiste propozim ligjin. Ligji që doli nga debati rregullon përdorimin e gjuhëve në nivel ligjvënës, administrativ dhe gjyqësor. Ai nuk përmend mediat pasi që ato nuk konsiderohen pjesë e sferës publike në të cilën Qeveria do të duhej të përzihej.

Janë tri pika kryesore të këtij ligji, të vetmit që merret me përdorimin e gjuhëve në bazë të gjerë. E para, gjuhës luksemburgase ju dha statusi i gjuhës nacionale (nuancë e rëndësishme në krahasim me gjuhën zyrtare siq u nënkuptua në Bashkimin Evropian për shembull). E dyta, të gjithë dokumentet ligjvënëse duhet të shkruhen në gjuhën frenge. Më në fund, në punët administrative dhe gjyqësore mund të përdoren të tri gjuhët (luksemburgase, frenge dhe gjermane). Kur ti drejtohet administratës, qytetari mund të përdorë cilëndo nga këto tri gjuhë; përgjigja duhet të jetë në gjuhë të njejtë, “aq sa është kjo e mundur”, siq cekët në ligj. Kjo do të thotë që të gjitha kërkesat ndaj administratës kërkojnë

përgjigje në gjuhën frenge pasi që nëpunësit civil nuk janë mësuar në gjuhë tjera apo nuk e njohin sa mjafton vokabularin teknik në gjuhë tjera.

Ligji i shtypur i tashëm daton nga viti 1869. Ka kohë që mendohet që ai duhet reformuar dhe në vitin 2002 ministria shtetërore, si shërbim i qeverisë, parashtroi draftin e ligjit të ri; i cili akoma është duke u diskutuar. Me të merret parasyshë konventa Evropiane për të drejta të njeriut, sikurse edhe jursidiksioni i Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut. François Biltgen, ministër i komunikacionit, në përgjegjësi të të cilit është edhe ky propozim ligj, pret që ky do të jetë ligji më modern për media në Evropë kur të aprovohet qysh besohet nga parlamenti kah fundi i vitit 2003. Ndryshimet kryesisht kanë të bëjnë me statusin e gazetarëve por nuk do të përmbajnë kurrfarë rregullore shtesë në pikëpamje të gjuhës.

Në vitin 1976 është aprovuar një ligj që të bëhet subvencionimi i shtypit me të holla publike. Administrata në vitin 2001 ju ka dhënë drejtpërdrejt gazetave 4.3 milion euro, duke mos llogaritur tërë mbështetjen individuale që mediat e shtypura pranojnë nga Qeveria, pa marrë parasyshë animet e tyre politike. Për të pasur drejtë për subvencionim, gazeta duhet të botohet së paku njëherë në javë, duhet të punësojë së paku pesë gazetarë dhe të këtë rëndësi të posaçme (dmth të merret me lajme kombëtare dhe ndërkombëtare, ekonomi dhe punë dhe kulturë shoqërore). Vetëm gazetat e shkruara nga njëra prej tri gjuhëve (luksemburgase, frenge, gjermane) mund të kualifikohen për fonde publike. Disa gazeta vështirë që do të mbijetonin pa ndihmë shtypit; të tjerat si *Le Jeudi*, me siguri nuk do të ishin formuar pa gjasa që të subvencionohen nga shteti.

III. Mediat dhe përdorimi i gjuhës

Situata në mediat e Luksemburgut, me përdorimin e tyre të gjuhëve të ndryshme, është po aq specifike sikurse edhe e ndërlikuar. Sipas rregullit, mund të thuhet së në shtyp dominon gjuha gjermane (madje edhe disa gazeta në gjuhën frenge kanë dalur në treg viteve të fundit), përderisa në radio dhe televizion gjuhë e kuptimit është ajo luksemburgase (përsëri me disa përjashtime që vlen të vërehen).

1. Mediat e shtypura. Sipas statistikës së UNESCO-s, Luksemburgasit janë lexues të pasionuar të shtypit. Më shumë së një e katërta e amvisërive blen më shumë së një gazetë ditore kombëtare, gati në të gjitha rastet përmes parapagimit. Duke i falenderuar njohurisë së tyre të gjuhëve, Luksemburgasit janë në gjendje të lexojnë gazeta nga vende të ndryshme (kryesisht revista për ata me interesime të posaçme dhe të cilat nuk ekzistojnë në Dukatën e Madhe, me përjashtim të revistave për automjete). Mirëpo, për të lexuar lajmet lokale duhet të mbështeten në shtypin lokal.

Në vitin 1848, nentë vjet pasi Luksemburgu fitoi varësinë, u hartua Kushtetuta e Dukatës së Madhe. Me rregulloret e reja ligjore u zhduk cenzura. Nuk është pritur shumë dhe është shtypur gazeta e parë, *Luxemburger Wort*. Jo vetëm që ajo ditore akoma ekziston, por ajo ka publikun më të gjerë (me 49 perqind) me tirazh (më tepër se 78.000 ekzemplarë të shitur, që paraqet gati dyfishin e tirazhit të të gjitha gazetave tjera ditore së bashku) në Luksemburg. Gazeta është pronë e Arqipe-shkvisë dhe ka ngjyrim të fortë redaktues katolik. Por gjatë vitëve të fundit i ka hapur faqet e veta rrymave tjera ideologjike duke mos i lënë pas dore rrenjë të veta fe-

tare. Ajo është me siguri gazeta me e besueshme në sektorin e raportimit gazetar.

Pandani i saj ideologjik, si kundërpeshë, quhet *Tageblatt* (20 përqind e lexuesve). Ka filluar të del në vitin 1913 dhe drejtpërdrejt i takon sindikatës socialiste OGBL. Gajtë vitit 1930 të dy këto gazeta sulmoheshin ashpër: *Tageblatt* te nacistet shihte armikun politik që duhej eliminuar, derisa, së paku gjatë viteve të para, *Luxemburger Wort* i mbyllte sytë para Gjermanisë së Hitlerit pasi që e djathta politike e konsideronte shpresë të fundit për mbrojtje të Evropës perendimore nga kërcenimi komunist. Kur nacistet okupuan Luksemburgun në vitin 1940, të dy gazetatat u kthyen në rënd.

Në përgjithësi organe politike janë *Zeitung vom Lëtzebuurger Vollek* komunist (i themeluar 1946, sot ka një përqind të lexuesve) dhe *Journal*-i liberal (i themeluar 1948, pesë përqind të lexuesve), pasi që të dyja janë në pronësi të partive të tyre. Nismëtarët e dy gazetave kanë luajtur rol të rëndësishëm në rezistencën ndaj okupatorit nacist.

D'Lëtzebuurger Land (tre përqind të lexuesve) është javorja më e vjetër politike. Filloi të botohet në vitin 1954, me ndihmën e financuesve të afërt me magnatin e çelikut Arbed. Javorja tjetër politike është e afërt me partinë e Gjelbërt dhe ka një përqind të lexuesve. U rimërtua në *Wo*, në vitin 2000, pasi kishte startuar para 12 viteve sikur *Gréngespoun*, krijuesit e të cilës e konsideronin gjithmonë si alternativë ndaj shtypit "borgjez".

Kështu sëcila rrymë politike dhe ekonomike ka gazetata e veta. Por kur është në pyetje niveli i shitjes i nevojitur për punë profitabile, do të duhej të kishte vend në treg vetëm për një nga këto gazeta. Arsyeja pse edhe më tutje ekzistojnë, përkundër tirazheve të ulta dhe të ardhurave jo të konsiderushme, qendron në faktin e vul-

Inetit të përgjithshëm që tregon sëcila parti politike për të mbajtur llojllojshmërinë e mendimeve të garantuar përmes ndihmës shtypit.

Gazetat tjera që marrin ndihmë nga financat publike janë *Revue* (e themeluar 1946, me 25 përqind të lexuesve sot) dhe *Télécran* (e themeluar 1978, me 34 përqind të lexuesve sot), dy javore të ilustruara me theks në program televiziv dhe *Le Jeudi* (e themeluar 1997, me shtatë përqind të lexuesve sot, e vetmja javore në gjuhën frenge. Në fund të vitit 2001, u themeluan edhe dy gazeta ditore: *La Voix du Luxembourg* dhe *Le Quotidien*. Ato kanë nga shtatë përqind të lexuesve, dhe botojnë artikuj vetëm në frengjisht. Përcaktimi i tyre politik është më pak i dukshëm, edhe pse janë pronë e dy grupacionëve kryesore gazetare: Groupe Saint-Paul (*Luxemburger Wort*, *Télécran*, *La Voix du Luxembourg*) dhe Editpress (*Tageblatt*, *Revue*, *Le Jeudi*, *Le Quotidien*).

1.1. Mediat shumë-gjuhësore. Është vështirë të paramendohet botimi i parë i *Luxemburger Wort*-it, i publikuar menjëherë pas hjekjes së cenzurës në vitin 1848, që përmbante vetëm artikuj të shkruar në gjuhën gjermane. Secili që sot dëshiron të lexon një nga gazetat kryesore kombëtare duhet të njeh gjuhën gjermane dhe frenge, së paku. Artikujt në të dy gjuhët janë njëri pranë tjetrit dhe nuk ka përkthim. Aq më tepër, mund të hasni në citim në gjuhën frenge në artikullin në gjermanisht, pa përkthim dhe anasjelltas. Raportet në gjermanisht përfshijnë diku 70 përqind, artikujt në frengjisht rreth 25—30 përqind, kurse mbetja plotësohet me raporte në gjuhën luksemburgase apo çfarëdo gjuhe tjetër. Ky sistem specifik funksionon rrjedhshëm sepse Luksemburgu është një lloj kazani gjuhësor për shkrirje.

Në vitin 1988, linguisti Guy Berg, bëri analizën sasiore të gjuhëve që përdorën në gazetatat shumë-gjuhësore *Luxemburger Wort* dhe *Tageblatt*. Ai i ndau gazetatat në 13 kategori dhe fitoi rezultate të ngjashme për secilën prej tyre. Sporti më së shumti përdorte vetëm një gjuhë: rreth 95 përqind e artikujve ishin të shkruar në gjermanisht. Editorialet në gjermanisht përbënin 91 përqind, lajmet lokale 87 përqind, faqja e parë 84 përqind, lajmet nga bota 80 përqind kurse lajmet e vendit 73 përqind; përqindja e mbetur ishin artikujt në frengjisht, pasi që gjuha luksemburgase nuk luan rol të rëndësishëm në këto kategori (përpos në lajmet lokale me 4.5 përqind). Në atë kohë, faqet mbi artin ishin 56 ndaj 41.5 përqind në dobi të gjermanishtes; sot ndoshta ajo gjendje ka kaluar në të mirë të frengjishtes.

Ofertat për punë ishin kategori ku frengjishtja udhëheqte me 84 përqind; sot do të gjëni një numër të konsiderueshëm të punëve në anglisht. Pesëdhjetë e dy përqind të shpalljeve ishin të publikuara në frengjisht, 38 në gjermanisht dhe 10 përqind në gjuhën luksemburgase. Sot ndoshta ka edhe më pak porosi komerciale në gjermanisht. Sfera nga e cila gjermanishtja gati që është dëbuar janë njoftimet shoqërore. Në atë kohë, më shumë se 80 përqind e njoftimeve për lindje apo martesë ishin të shkruara në gjuhën luksemburgase. Është interesante që njerëzit më para e zgjedhnin frengjishten (45 përqind) kur njoftonin për vdekjen e ndonjë personi.

1.2. Mediat njëgjuhësore. Pasi që numri i të huajve që jetojnë në Luksemburg është në rritje të përhershme qysh nga vitet 1970-ta, e momentalisht ai numër është gati 37 përqind të popullatës, frengjishtja po e merr më shumë rolin e gjuhës e kuptimit në jetën e përditshme (posaçerisht në tregti dhe hotelieri ku përqindje e madhe

e fuqisë punëtore vjen nga komuniteti francez apo belg). Për këtë arsye, botuesit luksemburgas kanë filluar të bëjnë përpjekje për të arritur deri te komuniteti francez në vend. Për moment ekzistojnë tri gazeta njëgjuhësore në gjuhën frenge: dy ditore, *La Voix du Luxembourg* dhe *Le Quotidien*, sikurse edhe javorja *Le Jeudi*.

Arsyeja kryesore për themelimin e këtyre gazetave është komerciale (edhe pse asnjë botues nuk pret që do të përfitojë në të vertetë me atë veprim). Disa botues besojnë që me praninë e më shumë njerëzve që flasin fren-gjisht në Luksemburg duhet të ekzistojnë lexues të rinjë që duhet joshur. Kjo është para së gjithash kur njerëzit që flasin fren-gjisht nuk mund ti lexojnë shumicën e artikujve në gazeta shumë-gjuhësore, prandaj akoma nuk i blejnë gazetat ditore apo javore lokale. Kjo është plotësisht e saktë, por prap së prap, *La Voix du Luxembourg* dhe *Le Quotidien* akoma nuk kanë sukses real. Lexuesit e tyre me tërësisht 14 përqind, janë vetëm tre përqind më shumë lexues nga që kishte botimi luksemburgas i gazetës frenge ditore *Le Républicain lorrain*, e cila kur u shua kah fundi i vitit 2001 dhe kishte 11 përqind. Ky botim kishte filluar në vitet 1960-ta të hershme, por viteve të fundit tirazhi dhe të ardhurat gjithnjë zvogëloheshin. (Duhet vënë re që: *Le Républicain lorrain* është partner i *Le Quotidien*-it).

Duhet marrë parasysh edhe dimenzionin kulturor kur mundohemi të shpjegojmë suksesin relativ në joshjen e publikut të ri të lexuesve. Siq duket nuk ekziston harmoni mes numrit të banorëve të Dukatës së Madhe që flasin rrjedhshëm fren-gjisht dhe atyre në mesin e tyre që janë të interesuar për ngjarjet aktuale të luksemburgut. Lexuesit “e natyrshëm” potencial të shtypit njëgjuhësor në gjuhën frenge (bankierët, eurokratët, imigrantët, udhëtarët e përditshëm) më tepër dëshirojnë të lexojnë

gazetat e shtypura në vendet amë (që është shumë e lehtë pasi të gjitha gazetat më të rëndësishme gjenden në Luksemburg). Sikur kjo të mos ishte realitet, çfarë sqarimi i mundshëm do të ishte për faktin pse *Le Quotidien* nuk ia arriti të përvetësojë lexuesit e *Le Républicain lorrain-it*. *Le Quotidien* është pamohueshëm trashegues i *Le Républicain lorrain-it* (pasi gazeta ndërpreu botimin me daljen e *Le Quotidien-it* i cili mori përsipër parapagesit). Dallimi qendron në politikën e tyre redaktuese: *Le Quotidien* fokusohet më tepër në Luksemburg, e më pak në Francë dhe regionin e Lorenit. Ashtu që, kur *Le Républicain lorrain* pas 40 viteve ndërpreu shtypjen e botimit të vet luksemburgas në fund të vitit 2001, mund të shihnit si lexuesit blenin botimin e *Le Républicain lorrain-it* nga Tionvili, dhe jo *Le Quotidien*, madje as *La Voix du Luxembourg*.

Edhe një rezultat i anketës së kryer nga TNS (Taylor-Nelson Sofres) tregon që lexuesit e *La Voix du Luxembourg* janë baraz të shpërndarë në mesin e Luksemburgasve dhe të huajve (anketa nuk tregon a vlen kjo edhe për *Le Quotidien*, por mund të supozohet që shifrat janë të njejta). Përfundimisht, tërë kjo do të thotë që, nëse vazhdon konkurrenca e ashpër në mes këtyre dy ditoreve frenge njëgjuhësore, kjo nuk do të jetë shkak i kërkesës së madhe të banorëve që flasin frengjisht apo të atyre që udhëtojnë atje në punë çdo ditë. Kjo është kryesisht shkak i politikës grabitëse të çmimeve të dy kompanive më të rëndësishme në Dukatën e Madhe që janë të kundërta ideologjikisht, pasi që të dy palët mendojnë që përfundimisht vetëm një gazetë do të mbijetojë. (Është ironike që në zgjedhjen e lexuesve në mes *La Voix du Luxembourg* dhe *Le Quotidien* nuk ndikojnë qendrimet e tyre politike, që është në kundërshtim me sjelljen e lexuesve në tregun e shtypit shumë-gjuhësor si-

pas hulumtimeve shoqërore të institutit Ilres. Por prap së prap, këto gazeta janë më tepër të përcaktuara politikiisht.) Shtypi në gjuhën angleze, tash për tash, është jashtë duarve të këtyre dy grupeve kryesore mediale. Në vitin 1981, drejtori për punësim erdhi tek ideja për botimin e javorës për ekspertë, *Luxembourg News*. Shtatë vjet me vonë pasoi revista mujore *Business*. Të dyja duhet të mbijetojnë pa ndihmën publike financiare pasi anglishtja nuk është në mesin e tri gjuhëve të cilat i përmend *Liqji mbi përdorimin e gjuhëve* nga viti 1984. Kompania International City Magazines njoftoi me 25 mars 2003 që “ndërpret daljen e të gjitha botimeve të veta”, mes tyre edhe *Luxembourg News* i *Business*. Pol Wirtz momentalisht është duke kërkuar investues të ri dhe është i bindur që gazeta e tij do të startojë së shpejti.

Ekzistojnë edhe gazeta që i drejtohen tregut lokal portugez. E para që u paraqit ishte *Contacto* (nëntë përqind e lexuesve). Kjo javore u themelua në vitin 1970 dhe i takon Groupe Saint-Paul. Konkurenti i saj *Correio* (katër përqind e lexuesve) në pronë të *Editpress-it*, startoi në vitin 1999. Në prill të vitit 2003, u shfaq *Présence hellénique* si mujori i parë në greqisht (dhe frengjisht).

Përpos gazetave dhe revistave angleze, portugeze dhe greke, në Luksemburg nuk shtypet asnjë gazetë tjetër për asnjë grup tjetër gjuhësor. Nëse banorët Italian, Spanjoll, Flaman apo Holandez dëshirojnë të lexojnë gazeta në gjuhën e tyre amtare duhet të shkojnë në kioskun ku do të gjejnë më shumë së një gazetë ditore apo javore të importuara nga vendi i tyre.

Në fund, një shqyrtim apo me realisht supozim: është vështirë të paramendohet që një ditë ndonjë botues do të fillojë një gazetë vetëm në gjuhën gjermane. Kjo është së pari, shkaku i okupimit nacist gjatë Luftës së

dytë botërore, që ka ndikuar të Luksemburgasit të marrin një qendrim kritik ndaj Gjermanisë dhe kulturës së saj (edhapse Luksemburgasit lexojnë më shumë gazeta dhe libra në gjuhën gjermane sesa në atë frengje dhe shikojnë më shumë TV programe nga Gjermania sesa nga Franca). E dyta, sepse askush nuk sheh nevojën për shtypin njëgjuhësor në gjuhën gjermane në kontekst kulturor shumë-gjuhësor.

1.3. Shtypi i huaj. Luksemburgasit me kujdes ndjekin shtypin e huaj. Ajo shprehi nuk ka të bëjë vetëm me shumë-gjuhësinë e tyre por është pasojë e madhësisë së vendit. Në stendat e gazetave nuk do të gjëni fare revistat për ata me interesime të posaçme sikur janë kompjutorët, kuzhinieria dhe sporti. Ndërsa ata Luksemburgas që nuk duan të lexojnë vetëm raportet e agjencioneve të lajmeve për punët ndërkombëtare duhet ti drejtohen ditoreve dhe javoreve të huaja. Shtypi lokal thjeshtë nuk ka mjete financiare për të pasur korrespondentë nëpër metropolet e rëndësishme botërore apo të dërgojë raportues në detyrë të posaçme në ndonjë zonë të krizës.

Në stendat e gazetave të Luksemburgut mund të gjenden të gjitha gazetat më të rëndësishme ndërkombëtare me më shumë së 5.300 tituj. Por të dhënat për shitjen individuale të tyre janë të vogla në krahasim me gazetatat lokale. Përpos një përjashtimi që vlen përmendur, tabloidit gjerman *Bild*. Edhapse ai lenë pas dore realitetin dhe ngjarjet e përditshme të Luksemburgut e lexojnë tetë për qind e popullatës.

2. Mediat e transmetuara. Radio dhe televizioni janë definitivisht sferat ku gjuha luksemburgase është gjuhë e kuptimit por sikur te mediat e shtypura, ekzistojnë përjashtime të vogla shumë-gjuhësore në programe të shum-

ta. TV stacioni i vetëm kombëtar *RTL Télé Lëtzebuerg*, si dhe tri radio-programe kombëtare *RTL Radio Lëtzebuerg*, *Radio 100,7* socio-kulturor dhe *DNR (Den neie Radio)*, transmetojnë në gjuhën luksemburgase. Kjo vlen edhe për dy nga tri radio stacionet regjionale: *Radio Ara* dhe *Eldoradio*. Mirëpo, *Radio Latina*, transmeton program në gjuhët romane, kryesisht portugalisht. Me përjashtim të një stacioni (që transmeton në portugalisht dhe frengjisht), të gjitha 13 radio stacionet transmetojnë gati ekskluzivisht në gjuhën luksemburgase. Tre TV kanale kabllorike gjithashtu transmetojnë në gjuhën luksemburgase.

Edhe pse sot ekziston një numër i madh i radio dhe TV stacioneve për banorët lokal, kjo situatë është mjaft e re, pasi që *RTL* mbante monopolin transmetues gjatë gjatë dekadave ndërsa liberalizimi i frekuencave filloi tek pas vitit 1991 kur u aprovua ligji i ri. Historia e mediave elektronike filloi në vitin 1931, kur u formua *Compagnie luxembourgeoise de radiodiffusion*, *RTL Grupi* i sotëm. Por gjatë tri dekadave të ekzistimit të saj, u transmetuan vetëm programet në gjuhën frenge, gjermane dhe angleze. Ato programe nuk i drejtoheshin posaçërisht popullatës lokale. *Radio Lëtzebuerg* (në gjuhën luksemburgase) filloi me punë tek në vitin 1959. Dhjetë vjet me vonë startoi *Télé Lëtzebuerg* (gjithashtu në gjuhën luksemburgase, por për më shumë së 20 vite ishte vetëm programi dy orësh çdo të diele pasdite; programet e sotme ditore të magazinave dhe lajmeve janë në prodhim nga viti 1991).


Kryesisht programi i magazinave dhe i lajmeve ofrohet në gjuhën luksemburgase. Por nëse mysafiri në radio apo TV program vjen nga Gjermania apo Franca, intervista bëhet në gjuhën e tij amtare ndërsa përkthimi nuk sigurohet. Prap edhe aty ekziston një karakteristikë spe-

cifike. Për t'ju drejtuar komuniteteve të huaja në Dukatën e Madhe, Qeveria siguron fonde për përkthim në gjuhë frenge të TV programit ditor gjysmë orësh të lajmeve. Ai transmetohet simultanisht në stereo kanalin tjetër.


Radio 100,7 socio-kulturore që u paraqit në valë në vitin 1993, është programi i parë dhe i vetëm i financuar nga shpenzimet publike. Pasi që ka dedikim kulturor por edhe politik, çdo mengjes transmeton program të lajmeve në gjatësi prej 15 minutash. Më herët *RTL* kishte radio-programe javore të dedikuara komuniteteve portugeze, italiane dhe spanjolle sikurse edhe për qytetarët e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndërsa në televizion programin në italisht. Gjatë kohës ato u zhdukën. Pasi *RTL* humbi monopolin e vet transmetues, konsideronte që më tutje nuk duhet të merr misionin publik për informimin e komuniteteve të huaja në gjuhën e tyre. *Radio Latina* e mori atë rol dhe i drejtohet veçmas Portugezëve, Italianëve, Spanjollëve dhe Francezëve në Dukatën e Madhe. Ka disa radio-stacione regjionale dhe lokale që transmetojnë kryesisht program në gjuhën angleze, por programet e tyre kryesisht janë muzikore dhe publikut nuk i ofrojnë shumë gazetari.

Edhe një fenomen plotësisht specifik është efekti i përhapjes. Çdokush që dëshiron të shikojë TV programin kryesor publik apo privat nga Evropa apo të dëgjojë radio stacione belge, franceze dhe gjermane në regjion afër kufirit, mund ta bëjë këtë. Kjo vlen sikur për popullatën vendore ashtu edhe për atë të huaj. Por është e qartë që në krahasim me banorët tjerë, Luksemburgasit preferojnë radio dhe TV programet gjermane.


Gjatë ditëve të punës të javës përqindja e Luksemburgasve që shikojnë *RTL Télé Lëtzebuerg* (në gjuhën luk-



semburgase) është 29 përqind; TV kanalet gjermane i shikon 56 përqind e publikut vendor, franceze 12 përqind dhe TV programet tjera në gjuhët tjera 3 përqind (sipas anketës së Ilres-it nga viti 2001).



Kur të merret parasyshë tërë popullata e Dukatës së Madhe, përqindja e *RTL Télé Lëtzebuerg*-ut dhe TV gjermane bjen në 22, respektivisht 45 përqind, përderisa përqindja e TV franceze dhe TV tera ngritet në 24, gjegjesisht 9 përqind.



Portugezet kryesisht shikojnë kanale franceze (46 përqind), pastaj TV portugeze (26 përqind), programe gjermane (17 përqind) dhe TV stacione tjera (11 përqind).

Trendi i njejtë vërehet kur të analizohen shprehjet e dëgjimit të radios. Luksemburgasit më para do të kycin radio programet gjermane sësua franceze. Mirëpo, përqindja e radio-stacioneve franceze po rritet kur shqyrtohet tërë popullata. Por ekziston një dallim i madh nga TV: 85 përqind e publikut të popullatës vendore dëgjon radio-stacionet Luksemburgase. Kjo do të thotë, që për dallim nga televizioni, vetëm 15 përqind e Luksemburgasve kycen në radio programet e huaja. Arsyeja kryesore është që oferta e programeve në *RTL Télé Lëtzebuerg* është e dobët, i cili ka 30 minuta program magazinor dhe 30 minuta lajme lokale në ditë, por nuk ka për shembull filma e as shou programe.

3. Interneti. Nuk ekzistojnë rregulla për zgjedhje të gjuhës në ndonjë faqe të Internetit por dominojnë frenjishtja dhe anglishtja. Administrata gati ekskluzivisht përdorë frengjishten, jo që ti përgjigjet kërkesave të publikut por sepse është në përgjithësi gjuhë administrative. Internet sajtet e gazetave janë kryesisht në gjermanisht, me përjashtim të *Tageblatt*-it, i cili është kryesisht në frengjisht, edhepse botimi i shtypur anon kah gjuha gjermane. Sajti i përbashkët i Internetit i *RTL* radios dhe televizionit është një nga të rrallet në gjuhën luksemburgase dhe njëkohësisht një nga më të vizituarit — nëse jo më i vizituarit — në vend.

IV. Zgjedhja e gjuhës e gazetarëve

Lidhur më mediat e shtypura shumë-gjuhësore, arsyet për zgjedhjen e njëres apo gjuhës tjetër janë të llojllojshme. Ndonjë gazetar ka studiuar ndoshta në vendin ku

flitet gjermanishtja dhe me më dëshirë përdorë gjuhën gjermane. Apo raportuesi i cili zakonisht shkruan artikuj në gjermanisht, kthehet në frengjisht nga mirësjellja, pasi që raporton për konferencën e ndonjë filozofi nga Parizi — me kusht që mendon se talenti i tij për shumë-gjuhë është në nivel të lartë. *Revue* dhe *Télécran* janë revista gati tërësisht në gjermanisht ndërsa në shpallje shfrytëzohen mjaftë fjalë franceze. Këto revista i drejtohen tërë popullatës vendore, nga amvisja deri te drejtori, nga adoleshenti deri te pensionisti, ashtu që ju duhet të përdorin gjermanishten pasi atë gjuhë shumica e Luksemburgasve e lexojnë më së lehti.

V. Përfundim

Luksemburgu është definitivisht vend shumë-gjuhësor por për dallim nga shoqëritë tjera shumë-gjuhësore si kur Zvicra ose Belgjika, nuk ka komunitete (të ndara) gjuhësore. Në Dukatën e Madhe të gjithë flasin mjaft mirë tri gjuhë: luksemburgase, gjermane dhe frenge. Të gjithë ata që kanë kaluar nëpër sistemin shkollor lokal i njohin mirë këto tri gjuhë.

Leximi i librave, dëgjimi i radio-programeve apo shikimi i televizionit pa u brengosur për gjuhën (qoftë fjala për gjuhë luksemburgase, frenge apo gjermane) është pjesë e identitetit kulturor dhe politik të Luksemburgut dhe qytetarëve të tij. Natyrisht që secili ka parapëlqimet e veta gjuhësore por ato nuk kanë arsye të fshehta.

Deri më tani përdorimi i gjuhëve në jetën publike ka ndjekur disa rregulla të zhvilluara gjatë dekadave të evoluimit praktik e jo përmes rrugës së masave juridike. Gjuha e shkruar e administratës është frengjishtja ndërsa gjuha e folur e saj është gjuha luksemburgase. Pro-

gramet radio dhe televizive transmetohen në gjuhën luksemburgase kurse gazetat janë kryesisht të shkruara në gjuhën gjermane. Mirëpo, është gjithnjë e më e vështirë me ju përmbajt këtyre dallimeve strikte ashtu që kalohet më tepër se kurrë në gjendje të pacaktuar.

Tash për tash, Luksemburgu krenohet që gjendet në udhëkryq mes dy kulturave të rëndësishme. Qytetarët e tij jo vetëm që flasin gjuhë të ndryshme por ata kuptojnë edhe dallimet kulturore. Nëse kjo është esenca e identitetit të vendit, atëherë nuk ka arsye që njerëzit të mos i përmbahën edhe më tutje.

Bibliografia

- Berg, Guy**, *Mir wëlle bleiwe, wat mir sin. Soziolinguistische und sprachtypologische Betrachtungen zur luxemburgischen Mehrsprachigkeit* (Tübingen: Max Niemeyer, 1993).
- Kohn, Romain**, "Ein Volk von Zeitungslesern", in Editions Saint-Paul (ed.), *Kaleidoskop* (Luxembourg: Editions Saint-Paul, 2002), 115—24.
- Kohn, Romain**, "Im Zweifel für den Leser. Wie Presse, Radio und TV die Sprachenvielfalt im Land meistern", *Süddeutsche Zeitung*, 19. January 2001.
- Loi du 24 février 1984 sur le régime des langues**, Mémorial A nE 16, 27. February 1984, 196—197 <<http://www.legilux.lu>>
- Majerus, Pierre**, *L'Etat luxembourgeois. Manuel de droit constitutionnel et de droit administratif* (Luxembourg, 1990).
- Newton, Gerlad**, (ed.), *Luxembourg and Lëtzebuergesch. Language and Communication at the Crossroads of Europe* (Oxford: Clarendon Press, 1996).
- Peeters, Roger J.**, "Trilinguisme et triglossie: l'emploi des langues dans la presse quotidienne luxembourgeoise", *Orbis* (Bulletin international de documentation linguistique), Tome XXXIX 1996—1997, 127—57.
- Service Information et Presse** (ed.), *About... languages* (Luxembourg, 1999) <http://www.gouvernement.lu/publications/download/about.pdf>
- Service Information et Presse** (ed.), *About... media and communications* (Luxembourg, 2002) http://www.gouvernement.lu/publications/download/media_ENG.pdf

Rekomandimet

Luksemburgu është shoqëri shumë-gjuhësore, ku gjuha luksemburgase, frenge dhe gjermane përdorën duke respektuar shumë rregulla praktike të shkruara dhe jo të shkruara. Propagimi i mediave njëgjuhësore me siguri do të shpiente deri të segregacioni i shoqërive dhe në fund deri të “ndarja” e shtetesisë. Identiteti kulturor i Luksemburgasve është i lidhur fortë me bashkë-ekzistimin “e të njejtin me të njejtin” — dhe gjuhën e tyre kombëtare si dhe shumë-gjuhësinë e tyre. Ky lloj i shumë-gjuhësisë është specifik për Luksemburgun dhe me siguri nuk mund të krahasohet me asnjë popull tjetër.

Është me rëndësi të vërehet që pjesa më e madhe e shoqërisë luksemburgase flet tri gjuhët zyrtare: gjuhën luksemburgase, gjermane dhe frenge. Gjithashtu, shumica e imigrantëve flet së paku një nga tri gjuhët zyrtare ku gjuha frenge është bërë gjuhë kuptimi apo emërtues i përbashkët. Gjuhën frenge më së shpeshti e flasin punëtorët tej-kufitar nga Franca, Belgjika dhe Gjermania.

Imigrantet, posaçërisht nga vendet a rajonit roman, kanë mediat “e tyre”: dy javore portugeze, radio në gjuhë të ndryshme romane, përkthimin në frengjisht të TV lajmeve (në gjuhën luksemburgase) si dhe programet e lajmeve ditore në radio në frengjisht (radio publike). Dy gazeta tërësisht në frengjisht dhe një javore vetëm në frengjisht ju ofrojnë udhëtarëve të përditshëm dhe imigrantëve nga vendet romane qasje të gjërë në ngajrjet në Luksemburg.

Në shtyp, gjuha luksemburgase nuk është emëruar kurrë si gjuhë komunikimi. Kjo është shkaku që nuk ka kërkesë për leximin e gazetave në gjuhën kombëtare përderisa ajo mbetet e para dhe dominon në gjuhën e folur. Është e vështirë për lexim (dhe shkrim) nëse nuk jeni mësuar dhe ushtruar. Gjendja është plotësisht tjetër në radio dhe televizion ku gjuha luksemburgase është gjuhë kryesore e komunikimit.

Në të ardhmën, Qeveria do të duhej:

- të vazhdojë t'i inkurajojë të huajt/imigrantet për të mësuar gjuhën luksemburgase si gjuhë integrimi;
- të inkurajojë krijimin e emisioneve shumë-gjuhësore apo të favorizojë prodhimin e radio dhe TV emisioneve për publikun shumë-gjuhësor në gjuhë tjera (posaçërisht në radio-stacionin publik);
- të lejojë zgjedhjen e gjuhës atij që flet — gazetarit (jo lexuesve apo publikut të radios dhe televizionit).

Natalia Angheli
Moldavia

E vendosur në kryqezimin mes botës sllave dhe latine, Moldavia është shtëpi e shumë grupeve etnike. Sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të banorëve, 64.5 përqind e popullatës ka origjinë moldave, 13.8 janë Ukrajinas etnik, 13 përqind janë Rusë, 3 përqind janë Gagauzë etnik, 2 përqind Bullgarë, 1.5 përqind Hebrej ndër-sa 2.2 përqind i takojnë grupeve tjera etnike (Bellorusë, Polakë, Gjermanë, Romë, etj.).¹

Pejsazhi kulturor i Moldavisë është kaleidoskop i traditës dhe gjuhës. Disa gjuhë janë të ngjashme me gjuhët e njerëzve tjerë në regjion — Rumune, Ruse, Ukrainase, Bullgare. Tjerat janë specifike në këtë regjion — siq është gjuha gagauze, gjuhë e një grupi të krishterë ortodoks që flet një nga gjuhët turke.

Njëmbëdhjetë vjet pas shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik, vendi akoma kërkon identitetin dhe pozitën e vet në Europë — që e tëra ndikon në menyrën se si grupet e ndryshme etnike e shohin vetën dhe të tjerët. Ruajtja e interesave të këtyre grupeve është sfidë për pushtetin e vendit si dhe për shoqërinë civile posaqerisht në

¹ Cituar sipas “Vendimit të parlamentit të Republikës së Moldavisë nr. 1039-XII nga 26.05.92. për statusin Ligjor të personave që ju takojnë pakicave etnike, lingvistike dhe religjioze në kontekst me konfliktin e armatosur në rajonin Pjesa Lindore e Dnjestrin” (The Decision of the Parliament of the Republic of Moldova No. 1039-XII from 26.05.92 on The Legal Status of Persons Belonging to Ethnic, Linguistic and Religious Minorities in the Context of the Armed Conflict in the District of the Eastern Part of the Dniester).

kushte të krizës së rëndë ekonomike dhe konfliktit të pazgjidhur rreth rajonit të Transdnjestrit.

I. Korniza juridike për media

Në Moldavi afërsia mes kombit titullar dhe grupeve tjera etnike shpesh vështrohet përmes perspektives së përdorimit të gjuhëve. Deri në 1980-at e vona, përkundër llojllojshmerisë së përberjës nacionale, dominonin gjuha ruse dhe moldave. Në vitin 1989 59.4 përqind të arsimuarve kanë mesuar moldavisht ndërsa 40.6 përqind prej tyre në rusisht.² Rusishtja ka qenë gjuhë bazë e komunikimit zyrtar.

Lirimi i Moldavisë nga udhëheqja komuniste solli deri të përtrirja e vetëdijës nacionale të Moldaveve etnik. Si pjesë e asaj levizje, në vitin 1989 u aprovua *Ligji për funksionimin e gjuhëve në territorin e Moldavisë*. Sipas atij ligji, moldavishtja fitoi statusin e gjuhës zyrtare derisa rusishtja u shpall “gjuhë komunikimi mes popujve”.³ Edhe pse u ngrit statusi i moldavishtes, ligji gjithashtu rregullon përdorimin e gjuhës ukrainase, bullgare, hebraike, jidishe, rome etj. Në mënyrë që ti përgjigjet nevojave të grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në Moldavi.⁴

Ligji gjithashtu rregullon përdorimin e alfabetit latin duke eliminuar dallimin e vetëm mes Moldaveve dhe Ru-

² Atanasia Stoianova, “Arsimimi i pakicave etnike në Moldavi”: Korniza juridike dhe praktike” (“National Minorities Education in Moldova: The Legal Framework and Practice”, Raporti i paraqitur në *Kongresin Botëror për politikën e gjuhës, Barcelonë*, 16–20 prill, 2002. www.linguapax.org/congres/taller/taller3/article23_ang.html

³ Neni 3 i *Ligjit për funksionimin e gjuhëve në territorin e Moldavisë*.

⁴ Neni 4 i *Ligjit për funksionimin e gjuhëve në territorin e Moldavisë*.

muneve. Megjithatë, ka gjuhë psh. moldavishtja kundru-all rumunishtes, që akoma janë çështje e debatave të ashpëra. Gjysma e banorëve përdor emrin “rumunë” dhe vetën e quajnë “Rumunë etnik”, derisa tjerët mbahen si folës të moldavishtes. Pasi emërtimi “moldavisht” përdorët në të gjitha aktet juridike, ai termin do të përdorët në këtë raport kur mendohet në gjuhën zyrtare të vendit.

Përdorimi i gjuhës moldave si gjuhë zyrtare të vendit gjithashtu është i rregulluar me nenin 13 të Kushtetutës. Ai nen gjithashtu i jep të drejtë qytetarëve moldav të përdorin gjuhën ruse si dhe gjuhë tjera që fliten në territorin e tyre. Neni 10 i Kushtetutës mbron të drejtën e shtetasve për ruajtje, zhvillim dhe shprehje të identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Në Transdnjester, pjesë në Moldavinë lindore e cila banohet kryesisht nga Rusët dhe Ukrainasit, nuk janë pranuar as ligji mbi gjuhët as Kushtetuta. Këtu banorët kanë protestuar kunder nenit 7 mbi gjuhët, i cili kërkon njohjen e gjuhës moldave për ata në sherbim të administratës shteterore.

Në pjesët tjera të vendit, aplikimi i ligjit mbi gjuhët dhe dispozitave të akteve tjera juridike gjuhësore rrjedh gradualisht ndërsa gjetja e bilancit mes gjuhës moldave dhe ruse, posaçërisht në sferën e afarizmit dhe mediave, edhe më tutje është çështje delikate. Shumica e Moldaveve të arsimuar flasin moldavisht dhe rusisht përderisa për shumë grupe tjera etnike, rusishtja mbetet e para e ndonjëherë e vetmja gjuhë e kuptimit.

Edhe pse ligji nga viti 1989 nuk përmbante rregullore që specifikisht rregullojnë çështjen e mediave, ai vuri themelet për përpunime të mëtejshme në atë fushë.

Rregulloret gjuhësore të ligjit që kanë të bëjnë me transmetuesit në vend janë në përputhje me ligjin mbi gjuhët. Neni 13 i *Ligjit për transmetuesit* nga viti 1995

thotë që minimum 65 përqind e programeve duhet të jetë në gjuhën zyrtare të vendit. Ligji ka vënë kornizën për veprimin e Këshillit për koordinim audiovizel (CCA), i cili pos tjerash, është i nevojshëm për të lehtësuar zhvillimin e transmetimit në gjuhën zyrtare të vendit.⁵

Rregulloret mbi gjuhën nga *Ligji për shpallje* nga viti 1997 janë plotësisht liberale. Pas një amandamenti të miratuar në vitin 2002, shpalljet mund të publikohen në gjuhën zyrtare të vendit apo sipas kërkesës së atij që shpall, në gjuhë tjera.⁶

Qasja e grupeve tjera në media është gjithashtu e siguruar me *Ligjin për të drejtat e personave që ju takojnë pakicave kombëtare* nga viti 2001. Neni 13 i këtij ligji rregullon që përfaqesuesit e minoriteteve etnike dhe organizatave të tyre kanë të drejtë në prodhimin e botimeve në gjuhën amtare të tyre ndërsa nga shërbimet e qeverisë kërkohet të organizojnë emisione në ato gjuhë në radio dhe TV shtetërore. Ngjashëm me këtë, *Ligji për transmetuesin kombëtar publik* nga viti 2002 shpall llojllojshmërinë kulturore dhe pranon të drejtat e grupeve etnike për të pasur programe në gjuhët e tyre.

Për të lehtësuar aplikimin e ligjeve gjuhësore dhe për të promovuar politikën shtetërore në sferën e marrëdhënieve mes kombëve, Qeveria ka formuar Departamentin për marrëdhënie kombëtare dhe funksionimin e gjuhëve (më vonë të quajtur Departamenti për marrëdhënie mes kombëve). Departamenti ka për detyrë të përcjell situatën në aspektin e të drejtave të grupeve etnike dhe të kombit titullar si dhe të mbështet aktivitetet e organizatave jo qeveritare në atë fushë.

⁵ Neni 37 i *Ligjit për transmetim*.

⁶ Neni 8 i *Ligjit për publikim*.

II. Hapesira mediale

Bollëku i mediave të shtypura dhe elektronike u shfaq në Moldavi pas fitimit të pavarësisë në vitin 1991. Pasi shumica prej tyre financohen nga partitë dhe grupet politike ato pasqyrojnë tërë spektrin e qendrimeve politike në vend. Mirëpo, ka më pak dallime në mënyrën si këto publikime pasqyrojnë interesat e grupeve të ndryshme etnike në Moldavi.

Skena mediale në Moldavi është mjaftë e pa qendrueshme. Si pasojë e fuqisë së ultë blerëse dhe intereseve të ndryshëm politik jetëzgjatja e shumë mediave është mjaftë e shkurtër. Sipas të dhënave të mbledhura nga Qendra e pavarur gazetare e Moldavisë, në nëntor 2002 kishte 72 publikime kombëtare të shtypura, 23 media të shtypura lokale, dy TV kombëtare, një radio-kanal kombëtar, 32 TV kanale lokale dhe tetë agjenci të lajmeve. Nga numri i përgjithshëm i 169 mediave, 82 shtypen ose transmetojnë programet e tyre në moldavisht, 33 në moldavisht dhe rusisht, 44 vetëm në rusisht, 6 në rusisht dhe gagauzisht ndërsa 4 në gjuhët tjera (këto informata nuk përfshinë të dhëna për rajonin e shkëputur të Transdnjestrit).⁷

Çmimi i gazetave dhe revistave është tej mase i lartë për shumicën e Moldavëve ashtu që radio dhe kanalet televizive që transmetojnë përmes rrjetit shtetëror janë me siguri burime të informimit dhe argëtimit. Në *Radio Moldova*, *TV Moldova 1* dhe *ORT Moldova* kanë qasje gati sëcila amvisëri. Deri me 10 gusht 2002, *TV Romania 1*, kanali publik i vendit fqinj, gjithashtu transmetohet deri të shumica e shtëpive moldave përmes sistemit

⁷ "Udhërrefyes medial 2001—2002", Qendra e pavarur mediale, Moldavi.

komunikativ shteteror.⁸ Pushteti Moldav e ndërpreu këtë transmetim duke pohuar që kërkonte marrëveshje shtetëse ndër-qeveritare që do të rregulonin metodën e pagesës për përdorim të lidhjeve transmetuese moldave. Pasuan protesta të mëdha publike dhe transmetimi rifilloi përsëri në mars të vitit 2003.

Banorët e Moldavisë veriore dhe Transdnjestrin mund të pranojnë transmetimet në shtëpitë e veta nga Ukrajina fqinje.

Mirëpo, pagat e ulta nuk ju lejojnë shumë Moldavëve blerjen e aparateve moderne radio dhe televizive. Si pasojë e kësaj, nuk kanë qasje në stacionet që transmetojnë përmes valëve ajrore dhe kryesisht janë të varur nga transmetimi i stacioneve lokale përmes radio-kablove të vjetra në pronësi shtetërore.

1. Mediat në Moldavi në gjuhën ruse. Ruishtja është akoma gjuha kryesore e mediave në Moldavi. Në të vërtetë, sipas numrit të tyre, tirazheve të larta dhe depërimit të madh është vështirë të quhen “të minoriteteve”. Sipas një ankete nga viti 2002, tri nga pesë gazetat më të lexuara në Moldavi, publikohen në ruisht dhe dy nga pesë radio-stacionet më të popullarizuara transmetojnë programe në atë gjuhë.⁹ E njëjta anketë tregon që më i popullarizuar është TV kanali *ORT* në gjuhën ruse. Gazeta në vendin më të lartë sipas popullaritetit në Moldavi është *Komsomol'skaya Pravda*, me tirazh prej 50.000 ekzemplarëve pa parapagim, që është më shumë se çdo publikim tjetër në moldavisht.

⁸ Victor Bogaci, “TV transmetuesit dhe stacionet në regjionet e Moldavisë”, *Mas-mediat në Moldavi*, dhjetor 1999, Qendra e pavarur mediale, Moldavi.

⁹ “Mas-mediat në Republikën e Moldavisë: qasja, publiku, orientimet, qendrimet”, *Mas-mediat në Moldavi*, qershor 2002., Qendra e pavarur mediale, Moldavi.

Në të vertetë, shumë nga gazetat më të popullarizuara janë botime në Moldavi të titujve të njohur rusë (*Komsomol' skaya Pravda, Argumenty i Fakty, Trud*). Ngjashëm me këtë, emisionet në gjuhën ruse me shikueshmëri me të madh janë repriza të emisioneve të TV dhe radio kanaleve nga Rusia (*ORT, Russkoe Radio, Radio Hit FM*).

Shikuar në tërësi, pjesëmarrja e reprizave të emisioneve nga Rusia është e konsiderueshme. Sipas regjistrimit të CCA, në verë të vitit 2002, nga 23 radio-stacione të licencuara, 11 ritransmetonin programe të radio-stacioneve ruse. Për krahasim, dy stacione kanë pasur leje të rregullt për ritransmetimin e programeve nga Rumunia, njera nga Turqia dhe një stacion kishte autorizimin për ritransmetimin e *Radio Liberty*.

Numri i transmetuesve i angazhuar në transmetim ilegal është shumë më i madh. Sipas CCA. Transmetimi i pa-autorizuar i emisioneve të huaja është forma më e shpeshtë e thyerjes së rregullave të transmetimit.¹⁰ Sipas vlerësimeve të Shoqatës së mediave elektronike (APEL), mendohet që numri i kundërvajtësve të tillë në mesin e poseduesve të licencës është 90 përqind.¹¹

Përzgjedhja e programit për ritransmetim shpesh bëhet pa diskriminim ndërsa pranuesit e lajmeve në Moldavi shumë herë e dinë kohën e saktë në Moskë, çmimet e patundshmërive në Sankt Petersburg apo parashikimin e motit për Siberi. Si pasojë e mungesës së mjeteve financiare apo të njohurisë teknike dhe profesionale, stacionet lokale i drejtohen shpesh ritransmetimit si mënyrë e mbijetimit.

¹⁰ "Shefi i këshillit transmetues kritikon poseduesit e licencave", *Moldova Media News*, 17. tetor 2002.

¹¹ Intervista me Viktor Osipov, drejtor ekzekutiv i APEL-it, tetor 2002.

Në këtë drejtim është tipik stacioni *Info Radio* — kanal privat i formuar në gusht të vitit 2000, me plan të emisioneve kryesisht nga Moldavia (në moldavisht dhe Ruisht). Kah fundi i vitit 2001, ai ritransmetonte stacionin Moskovas *Ekho Moskvu*.

Sipas rregullave të CCA, kandidatet që sigurojnë raporte “adekuate” për marrëdhëniet mes kombit titullar dhe grupeve tjera etnike që jetojnë në Moldavi dhe promovojnë vlerat e kulturës moldave kombëtare si dhe të bashkësive me të cilat “bashkëjetojnë”, kanë prioritet në procesin e përzgjedhjes. Mirëpo, ato kritere rrallë janë provuar në praktikë, gjë e cila shton pakenaqesinë e kontrolluesve të mediave lokale.¹²

Shoqata e të diplomuarve në Universitetet e huaja (CAIRO) ka inicuar madje proces gjyqësor në vitin 2000 kundër këshillit duke pohuar që ai nuk ka arritur të “mbrojë hapësirën kombëtare kundër ndërhyrjes së huaj”. Gjykata solli aktgjykimin në favor të tyre dhe urdhëroi transmetuesit të respektojnë rregulloret gjuhësore të ligjit për transmetim. Vendimi sjelli pakenaqësi në mesin e popullatës ruse të Moldavisë ndërsa komisar i lartë i OSBE-së për pakica kombëtare, kritikoi kufizimet në bazë të drejtave të njeriut. Pasuan edhe disa presione nga jashtë dhe parlamenti moldav publikoi interpretimin e rregulloreve të ligjit duke rregulluar që 65 përqind e përmbajtjes në prodhim lokal, e jo nga tërë koha që transmetohet, duhet të jetë në gjuhën zyrtare. Për bashkë-njesitë e stacioneve nga Rusia kjo kishte domethënie që ato mbesin në valë pa kurrfarë ndryshimi të përmbajtjes së tyre.

CCA nuk kishte shumë sukses në implementimin e rregulloreve gjuhësore dhe tjera në përputhje me ligjet

¹² “Kriteret për shpërndarje të licencave fituesve në garat për autorizimin e transmetimit” www.cca.md

për transmetim të vendit. Shumica e transmetuesve u kundërvihet sanksioneve dhe mbetet në valë. Ashtu për shembull, *Avto Radio* vazhdoi të transmetojë programin madje edhe pas marrjes së licencës për transmetim dhe asaj teknike.

Para një kohe të shkurtër, Këshilli miratoi qasje më të kujdesshme dhe nuk aplikon kurrfarë sanksione serioze. Nuk është në gjendje të lehtësojë aplikimin e ligjeve relevante ku CCA tani pohon që i shmangët sanksioneve të ashpra nga frika e “shkatërrimit” të hapësirës transmetuese moldave.¹³

2. Mediat në gjuhën ukrainase, bullgare, jidise dhe rome. Ndikimi i mediave në gjuhë tjera, përpos atyre në gjuhën ruse dhe moldave është minimal. Nga nëntori i vitit 2002 në distribucion kombëtar nuk ekzistojnë mediat që nuk janë në gjuhën moldave apo ruse.¹⁴ Dy publikimet e vetme që distribuohen në tërë vendin janë *Istoki* dhe *Nash Golos*. Të dyja kryesisht merren me jetën e komunitetit hebraik në Moladavi kurse materialet e veta i shtypin në gjuhën ruse.

Mediat në gjuhën ukrainase nuk janë të zhvilluara, edhe pse ky është grupi i dytë sipas madhësisë pas Moldavëve. *Ukrainski Golos* nga Kishnjevi në gjuhën ukrainase është i varur nga donacionet private për të mbijetuar por ato nuk mjaftojnë që gazeta me tirazh prej 3.000 ekzemplarëve të botohet rregullisht. *Promini*, gazetë në gjuhën ukrainase, që shtypet në qytetin Balta në veri të vendit gjithashtu nuk botohen rregullisht.¹⁵

¹³ “Shefi i këshillit transmetues kritikon poseduesit e licencave”, *Moldova Media News*, 17. tetor 2002.

¹⁴ “Katalogu i publikimeve periodike në Republikën Moldave dhe CIS”, 2002.

¹⁵ Intervista me Pjoter Grabçukun, kryetar të Shoqatës së Ukrainasve të Moldavisë, nëntor 2002.

Situata është e ngjashme me shtypin në gjuhën bullgare. *Rodno Slovo*, gazetë e Bullgarëve në Moldavi, nuk botohet që tri vite shkaku i mungesës së fondeve. Financimi i pamjaftueshëm gjithashtu vështirëson publikimin e gazetës *Blgarski Glas* në qytetin Taraklia, në jug. Nga themelimi në vitin 1991, u botuan vetëm 50 numra të saj. Nuk ka personel me punësim të përhershëm që punojnë për atë publikim ndërsa numrat e rinj botohen kur të arrijnë donacionet private. Në vitin 2002, përpjekjet e qeverisë lokale për subvencionim të kësaj gazete, kishin efekt të kufizuar — edhe pse u premtua ndihma për 12 numra të ardhshëm, u sigurua vetëm për 3 numra.¹⁶

Disa transmetues privat, kanë programe në bullgarisht. Kështu që TV kanali *STV 41*, i vendosur në Tarakli, transmeton lajmet lokale, shou programet argëtuese dhe afariste në bullgarisht. *TVardita*, kanal në valë të mesme nga qyteti Tvardita nga jugu i Moldavisë, gjithashtu ka disa emisione në bullgarisht.

Mirëpo, pjesëmarrja e programit origjinal në shumicën e kanalëve është shumë e vogël, ndërsa gjuhët e ndryshme përdoren për transmetimin e “përshtetëjeve muzikore”. E njëjta vlen edhe për emisionet në gjuhën ukrainase të stacionit *AVM Studio* nga Edineti, si dhe stacionit *Canal-X* nga Brisenia — të dyja në veri të Moldavisë, si dhe *BAS-TV* nga qyteti Basarabeaska në Moldavinë qendrore. Shtrirja e këtyre kanaleve është nën 50 kilometra.

Ekzistojnë programe në gjashtë gjuhë, përpos asaj moldave, në *TeleRadio Moldova*, transmetuesin kombëtar. Departamenti i “Comunitatea” televizionit publik moldav sjell 8 orë dhe 30 minuta program, përderisa tran-

¹⁶ Intervista me Dimiter Borimeçkovin, kreyredaktor i *Bulgarski Glas*-it, nëntor 2002.

smetimi mujor i departamentit të gjuhëve të radios kombëtare është 7 orë e 45 minuta. TV dhe radio stacionet kyoçin programet në gjuhën bullgare, gagauze, jidishe, rome, ruse dhe ukrainase.

Mirëpo, mungesa e personelit të kualifikuar dhe financimi jo adekuat dukshëm zvogëlojnë cilësinë e tyre. Si pasojë e pagave të ulta, të paktë janë gazetarët e rinjë që i bashkangjitën këtyre departamenteve. Nga nëntori i vitit 2002, TV programi në gjuhën rome nuk transmetohet pasi nuk ka udhëheqës të programit.¹⁷ Gazetarët nuk i përcjellin ngjarjet e rëndësishme pasi që ju mungojnë mjetet materiale të nevojshme për të udhëtuar në terren jashtë kryeqytetit Kishnjev. Nevojat e përditshme të komunikimit janë të mohuara pasi redaksitë nuk janë të pajisura me kompjutorë dhe faks aparate.

Përfaqesuesit e komuniteteve etnike në Moldavi, shprehin pakenaqesinë e tyre me sasinë dhe orarin e programeve në gjuhën e tyre, në transmetuesin kombëtar moldav. Në korrik të vitit 2002, brengosjen e tyre e shprehën në letrën të cilën drejtori i Departamentit për marrëdhënie mes kombëve i dërgoi drejtorit të stacionit TeleRadio. Letra kërkonte shtimin e vëllimit të emisioneve në gjuhë të grupeve të ndryshme etnike, bartjen e tyre në termine me të shikuara dhe përmirësimin e raportimit për grupet më të vogla etnike në Moldavi (Belorusët, Jermetet, Azerbejxhanët, Tatarët, Polakët, Lituanët, etj.). Letra gjithashtu nxiste drejtoritë e transmetuesve të sigurojnë perspektivë ndërkombëtare në programe ashtu që do të merreshin me çështje etnike jashtë vendit.¹⁸

¹⁷ Intervista me Tamara Saapega, shef e Departamentit Comunitatea pranë *TeleRadioMoldova*, nëntor 2002.

¹⁸ Letër e Tatiana Mlecico, drejtor gjeneral e departamentit për marrëdhënie mes kombëve Ion Gonta-s, kryesues të kompanisë shtetërore *TeleRadio Moldova*, 8. korrik 2002.

Përmbajtja dhe orari i transmetimit të programeve në gjuhë të ndryshme në televizionin dhe radion kombëtare mbetën kryesisht të pandryshuar nga nëntori 2002 deri me sot.

Mangësitë në hapësirën e qasjes së minoriteteve në media, i hulumtoi detajisht Këshilli i Evropës (CoE) në janar të vitit 2003. Në kontekstin e mbikqyrjes të *Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*, Komiteti i ministrave ftoi pushtetin moldav të “merr parasyshë interesat e të gjitha pakicave kombëtare të veta, duke përfshirë edhe ato në pozitë jo të favorshme apo me numër të vogël”. Sipas CoE, aplikimi i Konventës “nuk është plotësisht i suksesshëm ndaj Romëve”, dhe duhen perpjekje të mëtejshme t’ju sigurohet “qasje mediave në mesin e tjerëve edhe Ukrajinasve”.¹⁹

3. Mediat në regjionin autonom Gagauz. Ligji për statusin e posaqëm të Gagauz-Jeri nga viti 1994, garanton autonomi për rreth 170.000 Gagauz etnik që jetojnë në jug të Moldavisë, dhe ju jep të drejtë për zgjedhje të pavarur çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin politik, ekonomik dhe kulturor të këtij regjioni.

Sipas këtij ligji, gjuhë zyrtare në Gagauz-Jeria janë gjuha moldave, gagauze dhe ruse. Mirëpo, mjetet mbizotëruese të komunikimit në atë regjion janë gjuha ruse dhe gagauze.

Problemet me të cilat përballën mediat në atë hapësirë janë të ngjashëm me sfidat profesionale dhe ekonomike të gazetarëve në pjesët tjera të Moldavisë. Mungesa e personelit profesional, mungesa e fondeve dhe orvatjet e pushtetit për cenzurim të mediave janë çështje kryesore.

¹⁹ “Mbrojtja e pakicave në Gjermani, Armeni dhe Moldavi”, *Council of Europe News*, 15. janar 2003. www.coe.int

Tirazhi i shumicës së publikimeve periodike nuk kalon shifrën prej disa qindra ekzemplarëve dhe shumë prej tyre krijohen nga ekipe shumë të vogla ndonjëherë dhe nga vet kryeredaktorët.

Parlamenti regional është themelues i *Vesti Gagauzii*, javore me katër faqe dhe tirazh prej 5.000 ekzemplarëve. Tri gazeta dalin në gjuhën ruse, ndërsa një botohet në gagauzisht. Edhe dy botime periodike sponzorohen nga pushteti lokal — *Znamea* nga Kedar-Lunga dhe *Panorama* nga Vulkanestia. Të dy botimet janë javore në gjuhën ruse. *Znamea* ka tirazh të shtypur prej 5.000 kopjeve, derisa *Panorama* është shtojcë me dy faqe me tirazh prej 500 ekzemplarëve.

Si pasojë e financimit joadekuat *Ana Sözü*, *Gagauz Halki*, *Sabaa Yildizi*, *Gagauz Yeri*, *Gagauz Sesi*, dhe *Halk Birliti* gagauzase botohen jo rregullisht, dhe gjithashtu gazeta në gjuhën ruse dhe gagauze *Açık Göz*.²⁰

Mbështetja financiare nga pushteti qendror moldav për mediat gagauze mungon. Nga ana tjetër, disa publikime kanë marrë ndihmë nga Turqia. *Ana Sözü*, dyjavor në katër faqe, dhe revista *Sabaa Yildizi* janë sponzoruar nga Agjencioni Turk për bashkëpunim ndërkombëtar (TIKA), derisa dyjavoja *Gagauz Sesi* pranoi donacione nga persona privat.

TIKA siguroi edhe donacion në teknikë për zhvillimin e transmetimit në atë hapësirë. Financimi mbuloi shpenzimet e pajisjeve releje që të rritet cilësia e radio-transmetimit *Radio Gagauzia*, kanal në pronë shtetërore në qytetet Komrat, Kedar-Lunga dhe Vulkanesti.

Momentalisht ekziston vetëm një radio-kanal privat në atë hapësirë — *Radiostantsia Jug*, i cili ka program

²⁰ Ivan Topal, "Shtypi në Regjionin Autonom Gagauz-Jeri", *Mass-mediat në Moldavi*, qershor 2002.

të përzier të muzikës dhe lajmeve ndërsa programi transmetohet kryesisht në gjuhën ruse. Ekzistojnë pesë TV stacione me licencë në regjion por vetëm katër momentalisht transmetojnë program. Programi original i këtyre kanaleve sillet prej një deri gjashtë orë në javë kurse shumica prej tyre janë në rusisht. Të tjeret ritransmetojnë kanalet ruse. Për shembull, kanali *Ayin Açik* nga Kedar-Lunga përdorë 90 përqind të kohës së vet për transmetim duke ritransmetuar programe të kanaleve ruse *ORT* dhe *RTR*, derisa *Bizim Aydinik* nga Komrati ritransmeton programe të kanalëve Moskovase *MUZ-TV* dhe *Channel 3*. *Shtrirja e këtyre kanaleve është mes 10 dhe 40 kilometra* — ku shtrirje më të vogël ka *TV Sud* nga Vulkanestia ndërsa shtrirje më të madhe ka *Yeni Ay* nga Komrati.

Grupet mediale të regjionit disa herë kanë nxitur pushtetin qendror të lehtësojë zhvillimin e transmetimit lokal në regjion, si dhe t'ju jepin me shumë frekuenca transmetuesve privat lokal. Qendra e pavarur e gazetarisë nga Gagauzia, OJQ lokale mediale, i ka dërguar letër të hapur kryetarit moldav, kryetarit të parlamentit dhe kryeministrit duke kërkuar intervenimin e tyre.²¹

Lajmet lokale shpesh përzihen në veprimtari të mediale, posaqërisht atyre të cilat janë në pronësi shtetërore. Mospajtimet politike shpesh rezultojnë me censurë dhe largim të gazetarëve. Sipas Lidhjes për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Moldavi (LADOM) gjatë fushatës vjeshtore të vitit 2002 për zgjedhje të guvernatorit lokal, pushteti largoi kryeredaktorin e *Znamea* dhe ju kërcënuan anëtarëve tjerë të redaksisë me largim nga puna, du-

²¹ Intervista me Stepan Pironin, drejtor i Qendrës së gazetarisë së pavarur në Gagauzi, nëntor 2002.

ke u munduar të sigurojë raportim parazgjedhor duke favorizuar njërin nga kandidatet.²²

Në nëntor të vitit 2002, pushteti lokal mbylli *Tele-Radio Gagauzia*, në pronësi shtetërore. Kjo ishte e vetmja kompani me mbulim të gjerë dhe emisione origjinale në gjuhën bullgare, gagauze, moldave dhe ruse.²³

4. Mediat në Transdnjestër. Republika e vetëshpallur moldave e Transdnjestrut (Transdnjestrja) ekziston qysh nga viti 1990. Për dallim nga pjesa tjetër e vendit, këtë rajon në Moldavi lindore e banojnë 39.9 përqind Moldavë, 28.3 përqind Ukrainas, 25.5 përqind Rusë dhe 6.4 përqind pjesëtarë të grupeve tjera etnike.²⁴ Aksioni për rimëkëmbjen e kulturës dhe gjuhës moldave në vitet e vona të 1980-ta, posaçërisht pas miratimit të ligjit mbi gjuhën, shumë banorë lokal e shihnin si kërcënim. Frika e tyre më e madhe ishte që Moldavia përfundimisht do të bashkohëj me Rumuninë fqinje. Rrallë kush nga Ukrainasit dhe Rusët në Transdnjestër flasin moldavisht prandaj frikohëshin që një ditë do të zgjohën si të huaj në shtëpinë e tyre. Referendumi nga viti 1991, i organizuar me qëllim të ruajtjes së Bashkimit Sovjetik, të cilin shumica e bojkotuan në Moldavi, ishte i mirëpritur në regjion.

Prej atëherë republika e shkëputur ka krijuar të gjitha parakushtet e një shteti. Parlamenti i republikës së vetë-shpallur në vitin 1992 flaku poshtë ligjin mbi gjuhën nga viti 1989 dhe përsëri ju aprovoi përdorimin e

²² "Aktivistet e të drejtave të njeriut shprehin pakenaqesi shkaku i presionit medial në Gagauzi", *Moldova Nedra News*, 17 tetor 2002.

²³ Intervistë me Stepan Pironin, drejtor i Qendrës së gazetarisë së pavarur në Komrat, nëntor 2002.

²⁴ "Pridnestrovie v Yazykovom Zerkale Mezhetnicheskoy Integratsii", *Moldova Academic Review*, 2002. www.iatp.md/academicreview

çirilicës Moldavëve. Kushtetuta e sajë, proklamoi gjuhën moldave, ruse dhe ukrainase si gjuhë zyrtare të regjionit.²⁵

Liqji për shtypin dhe mediat tjera nga viti 1993 ju garanton qytetarëve të drejtën për qasje informatave në gjuhën e tyre amtare.²⁶ Megjithatë, gati të gjitha mediat në regjion botojnë apo transmetojnë informata në gjuhën ruse. Përpos kësaj, mediat nga Rusia janë të pranishme gjërësisht përmes ritransmetimit si dhe në kiosqet e gazetave.

Në nëntor të vitit 2002 ishin 63 media të regjistruara në regjion. Vetëm dy gazeta shtypeshin në ndonjë gjuhë jo-ruse kurse programet jo-ruse ishin të pranishme vetëm përmes transmetuseit shtetëror të Transdnjestrut.²⁷

Publikimi i vetëm në moldavisht ishte *Adevarul Nistean*. Kjo gazetë, me tirazh të shtypur prej 1.000 ekzemplarëve, sponsorohet nga pushteti regional ndërsa botohet dy herë në javë. Javorja *Gomin*, në gjuhën ukrainase, gjithashtu financohet nga arka shtetërore. Ajo ka tirazh prej rreth 2.300 ekzemplarëve.²⁸

Radioja shtetërore e Transdnjestrut ka vetëm lajme ditore në gjuhën moldave dhe ukrainase me programe analitike dhe magazina tematike gjatë fundjavës. Televizioni shtetëror sjell programe të lajmeve në gjuhën moldave dhe ukrainase tri herë në javë si dhe programe argëtuese për fëmijë në këto gjuhë.

²⁵ Neni 12 i Kushtetutës së Republikës Moldave të Transdnjestrut.

²⁶ Neni 3 i *Liqjit për shtypin dhe mediat tjera*.

²⁷ Intervistë me Andrei Safonovin, kryeredaktor i *Novaya Gazeta*, nëntor 2002.

²⁸ "Udhërrefyes për media, 2001—2002", Qendra e pavarur gazetare, Moldavi.

Mbizotërimi i gjuhës ruse në mediat e këtij regjioni, shpesh sqarohet nga pushteti me “prirje gjuhësore” të banorëve të vet. Sipas një hulumtimi të opinionit publik që citojnë, 20 përqind e Transdnjestrave rregullisht shikon TV programe në moldavisht, 37 përqind në ukrajinisht dhe 95 përqind në rusisht. Ideja e përhapur në mesin e banorëve lokal është që gjuha ruse është më e afërt me trashëgiminë shpirtërore dhe kulturore nga ajo moldave.²⁹

Marrëdhëniet e tensionuara mes pushtetit qendror moldav dhe udhëheqesve transdnjestrës, posaqërisht pas ngacmimeve të armatosura në fund të vitit 1991 dhe filim të vitit 1992, sollën deri te një hendek medial mes regjionit të shkëputur dhe pjesës tjetër të vendit. Në 1990-tat e hershme, të dyja palët rregullisht pengonin transmetimin e njera-tjetrës. Deri me vonë gazetat moldave nuk kanë qenë të pranshme në Transdnjester dhe anasjelltas.

Në maj të vitit 2001, kryetari moldav Vladimir Voronjin dhe udhëheqesi transdnjestrës Igor Smirnov nënshkruan marrëveshjen me të cilën sigurohet qarkullim i lirë i mediave. Sipas asaj marrëveshjeje, banorët kanë mundësi të parapagimit në publikimet periodike nga të dy anët e lumit Dnjestër. Mirëpo, të paktë janë banorët e Transdnjestrisë të cilët kanë mundësi të përcjellin programin e radios dhe televizionit kombëtar moldav pasi ata nuk janë të arritshëm përmes valëve të rregullta.

Krijimi i lidhjeve mes mediave në regjionin e shkëputur dhe pjesës së mbetur të vendit akoma është problematik. Raportimet për ngjarjet në Moldavi, rregullisht cenzerohen nga pushteti i Transdnjestrisë dhe autorët e

²⁹ “Pridnestrovie v Yazykovom Zerkale Mezhetnicheskoy Integratsii”, *Moldova Academic Review*, 2002. www.iatp.md/academicreview

tyre akuzohën që “veprojnë si kolona e pestë e Moldavisë” dhe shpesh kërcenohen me largim nga puna.

Me veprim të ngjashëm në vitin 2001 pushteti moldav mbylli gazetën *Kommersant Moldovy*, sepse botonin raporte të cilët kinse ishin në favor të pushtetit të Transdnjestrisë.

Përkundër marrëveshjes nga viti 2001, qasja në informata në regjion është e kufizuar ndërsa pushteti nga dy brigjet e lumit Dnjestër kohë pas kohe i qasët politikës “masë për masë” kur bëhet fjalë për terheqjen e akreditimit të gazetarëve.

III. “Të tjerët” në media

Situata e rëndë ekonomike, mungesa e gazetarëve të kualifikuar dhe orvatjet e pushtetit për ndërhyrje në veprimtarinë e mediave — janë probleme të cilat e ngadalsojnë zhvillimin e mediave në Moldavi pa marrë parasyshë gjuhën.

Këto probleme zmadhohen me mungesë të solidaritetit profesional mes gazetarëve nga mjediset e ndryshme etnike. Mediat janë me të madhe të ndara sipas vijave etnike ndërsa mbulimi i ngjarjeve kryesore politike, dhe ekonomike në mediat në gjuhën ruse rrënjësisht dallon nga mbulimi në mediat në gjuhën moldave. Aq më tepër, shumë gazetarë me punën e tyre kanë ngritur tensionet mes kombëve dhe kanë kontribuar në krijimin e imazhit të urryerit “të tjetrit”.

Shembulli më bindës ishte raportimi për ngjarjet në Transdnjestër në periudhën e viteve 1991—1992 kur shpërthyen betejat mes forcave të qeverisë dhe kryengritësve transdnjestrës, ku mediat menjëherë adoptuan stilin e raportimit i cili nxiste stereotipe për “armikun” dhe jepte pamje të thjeshtuar “bardhë e zi” të ngjarjeve.

Etiketimi i Transdnjestrisë, pushtetit dhe banorëve të saj ishte i zakonshëm në atë kohë në mediat moldave. Ngjashëm me këtë, mediat në republikën e shkëputur përdornin epitete dhe metafora ofenduese kur përshkruanin qeverinë qendrore moldave dhe banorët e saj duke u thirrur në të drejta më të mëdha gjuhësore dhe kulturore.

Kështu, gazeta ditore zyrtare moldave *Nezavisimaya Moldova* shpesh e quante pushtetin e regjionit “forca konzervative”, “kampion të politikës koloniale”, e ndonjëherë madje edhe “kriminelë” dhe “gangsterë”. Politika e udhëheqesve transdnjestrar në shumë raste përshkruhej si “djallezore”, deri sa banorët e republikës së shkëputur etiketoheshin si “të huaj” dhe “vagabondë”, duke implikuar që popullata jo-moldave nuk i ka rrënjët e vërteta nga atje.³⁰ Nga ana e vetë, *Dnestrovskaya Pravda* shpesh i përmendte Moldavët, duke pohuar që gjuha e tyre dhe të drejtat e tyre kulturore si dhe pushteti në vend ishin “fashist”. I quanin gjithashtu edhe “forca të errëta të Moldavisë” dhe shpesh ishin përules komentet për kinse mungesën e kulturës dhe edukatës.

Raportimi për “të tjerët” tej linjës së frontit parimisht lëngonte nga mangësia e prapavijës historike duke shfaqur qendrimet e vetëm njëjës anë. Duke i marrë të gjitha së bashku, transdnjestrarët kishin mbetur pa fytyrë, masë homogjene dhe armiqësore e Moldavëve dhe anasjelltas.³¹

Nga vitet e hershme të 1990-tave gjuha e mediave është zbutur dukshëm. Mirëpo, probleme të shumta mbe-

³⁰ Natalia Angheli, “Të tjerët pa fytyra: Pamja e Trans-Dnjestrir në mediat moldave”, *Media Online*, 30 mars 2001. www.mediaonline.ba

³¹ “Artikujt”, *Transnistrian Conflict in the News Media* www.iatp.md/transnistria

ten ndërsa raportimi për marrëdhëniet mes grupeve të ndryshme gjuhësore akoma mbeten pa barazpeshë, parimësi dhe thellësi. Diskutimet profesionale për këto çështje formalisht kanë filluar në vitin 1999 atëherë kur Lidhja e gazetarëve moldav miratoi kodeksin e etikës profesionale, i cili pos tjerash i nxiste gazetarët profesional t'i "kundërvihen dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe konfrontimit apo çfarëdo diskriminimi të bazuar në kulturë, gjini apo religjion".³² Pas miratimit të Kodeksit, gazetarët themeluan komisionin kombëtar për etikë. Mirëpo, komisioni nuk arriti të ndikonte në format e punës të profesionalëve në mediat lokale as ti bashkojë gazetarët në gjurmim për raportim të llojllojshëm dhe etik.

Akuzimet e ndërsjellta për mungesë të ndjenjave etnike, posaçërisht në mesin e mediave në gjuhën ruse dhe moldave, vazhduan dhe në vitin 2001 një gazetar nga javorja *Vremya* në rusisht, u gjykua për kinse promovimin e gjuhës së urrejtjes në media. Akuza për krim u ngrit kundër Julija Korolkova, pasi anëtarët e CAIRO-s e akuzuan për fyerje të nderit moldav dhe nxitje të përçarjes mes kombëve. Sipas pohimeve të CAIRO-s, artikulli i saj me titullin "Valixhe. Stacioni hekurudhor. Rusia", ishte fyerje e kombit titullar. Në artikull thuhej që arritshmëria e pozitave në organet shtetërore është e penguar për ata që flasin gjuhën ruse dhe që disa zyrtarë të kombësisë moldave pranojnë ryshfet.

Akuzat kundër Korolkoves më vonë u terhoqen por tensionimi mbeti. Aq më tepër, prijësit e komunitetit rusë, që ishin ngritur në mbrojtje të Korolkoves pohonin që ajo ishte veçuar në mënyrë jo të drejtë për tu akuzuar. Sipas mendimit të tyre, artikujt që nxitnin haptas ur-

³² "Kodeksi etik i gazetarëve në Moldavi", *Mass Media in Moldova*, qershor 1999.

rejtje mes kombëve në shtypin moldav “kishin kaluar të pa vërejtur nga ligji”.³³

Ndasitë etnike u futën edhe në organizatat profesionale të gazetarëve ku disa prej tyre ishin formuar të promovojnë interesat e grupeve etnike. Për shembull, Shoqata e mas-mediave nga Kishnjevi mbledh rreth vetës kryeredaktorët dhe redaktorët përgjegjës nga mediat në gjuhën ruse por ekziston edhe bashkimi i gazetarëve gaux dhe transdnjestras.

Mungesa e solidaritetit mes gazetarëve veshtirëson arritjen e qellimeve profesionale. Në fillim të vitit 2002 greva e të punësuarve në kompaninë shtetërore *TeleRadio Moldova*, me kërkesë për më shumë liri redaktuese nuk arriti të fitojë mbështetje të mjaftueshme pasi që gazetaret e redaksisë ruse e konsideronin si tentim të kolegëve të tyre moldav për të fituar më shumë të drejta për vete.

Megjithatë, gjithnjë e më shumë po kuptohet që janë të nevojshëm mekanizma efikas për të promovuar raportim me përgjegjësi, senzitiv dhe tolerant. Departamenti për marrëdhënie mes kombëve në vitin 2001 themeloi Drejtoratin për percjellje të marrëdhënieve mes kombëve. Drejtorati është i autorizuar të mbikqyrë nevojat shoqërore dhe kulturore të grupeve etnike dhe gjendjen e marrëdhënieve mes tyre. Me anën e shikimit të rregullt dhe analizave të raportimit medial për çështje etnike, nga Drejtorati pritet që ti percjell ndryshimet në vetëdije të njerëzve për çështje etnike të tyre, favorizimin e gjuhëve dhe nivelin e përgjithshëm të tolerancës në shoqërinë moldave. Rezultati i punës së tij do ti tregohet gjithmonë këshillit të departamentit, në të cilin gjenden pjesëtarët e

³³ Mikhail Sidorov, në seminarin për gjuhën e urrejtjes, të organizuar nga komiteti i Helsinkit i të rinjve të Moldavisë në Kishnjevi, prill 2001.

komuniteteve etnike dhe përfaqesuesit e organeve të qeverisë që merren me aspekte të ndryshme të marrëdhënieve mes kombëve.

Korniza juridike e vendit gjithashtu po ndryshohet. Në nëntor të vitit 2002, kryetari Vladimir Voronjin i paraqiti parlamentit projektligjin për luftër kundër ekstremizmit. Projektligji definon “materialin ekstremist” si nxitje të veprimeve të lidhura me krime lufte apo eliminim të grupeve etnike, fetare, kombëtare dhe tjera. Organizatat dhe individët të cilët janë të angazhuar në aktivitete të tilla konfrontohen me ndalesë të publikimit të tyre për pesë vjet.³⁴ Ligji u miratua gjatë diskutimit të parë dhe u dërgua për diskutim publik.

Përprojekjet për të mbledhur së bashku gazetarët me origjinë të ndryshme etnike, që të promovojnë diverzitetin dhe multi-kulturën, u ndërmorrën në nivel të gjërë. Katër ekipe të përziera të gazetarëve nga Transdnjestri dhe rajonet tjera, gjatë vitit 2002 paraqitën projekte të prodhimit të përbashkët afatgjatë nën mbështetje të Qendrës kombëtare të gazetarisë të moldavisë. Gjatë muajit korrik, personeli i javores *Timpul* nga Kishnjevi filloi me mbajtje të mbledhjeve jo formale me kolegët nga *Adevarul Nistrean-i* nga Tiraspoli. Detyra e vënë si prioritet e planit të veprimit për përmirësimin e qarkullimit të informatave mes Transdnjestrin dhe pjesës së mbetur të Moldavisë është miratuar nga grupi kombëtar moldav i njesisë operative të Paktit të stabilitetit në shtator të vitit 2002.³⁵ Grupi bashkon gazetarët kryesorë nga të gjitha llojet e mediave krahas përfaqesuesve të Qeverisë dhe organeve rregullative të mediave.

³⁴ “Kryetari i dergoi parlamentit projektligjin për luftë kundër ekstremizmit”, *RFE/RL Newslin*e, 18 nëntor 2002.

³⁵ “Grupi punose vënë prioritetet për zhvillimin e mediave Moldavi”, *IJNet*, 9 tetor 2002. www.ijnet.org

Pjesëmarrësit në këto projekte cekën nevojën për përcjellje të rregullt të mediave që të sigurohet respektimi i të drejtave të gjithë qytetarëve nga të gjitha mjediset etnike. Propozuan shtypjen e doracakëve të ndryshëm për çështjet e diverzitetit dhe multi-kulturës si dhe që organizatat mediale të përpunojnë “kodeksin e veprimeve më të mira”. Gjithashtu theksuan vlerën e projekteve të përbashkëta të gazetarëve nga mjediset e ndryshme etnike për promovimin e raportimit të bilancuar dhe të thellë për çështje të diverzitetit.

Sipas mendimit të tyre, puna e përbashkët në këto projekte do të mbulojë hendekun informativ që ekziston mes tyre, do të rritë nivelin e tolerancës në Moldavi dhe në afat të gjatë do ti kontribuon paqes dhe stabilitetit në vend. Gjithnjë më i përhapur është mendimi që mediat mund të bëhen vegël e rendësishme në zgjedhjen e mosmarrëveshjes në Transdnjestër.

IV. Në vend të përfundimit

Çlirimi i Moldavisë nga pushteti sovjetik solli deri të zhvillimi i mediave të ndryshme politike. U paraqitën botime të shumta dhe media transmetuese gjatë njëmbëdhjetë vjeteve të fundit duke reflektuar spektër të gjërë të mendimeve për tendencat kryesore politike dhe ekonomike në vend. Mirëpo, sigurimi i llojllojshmërisë gjuhësore dhe kulturore akoma është sfidë për mediat moldave.

Korniza juridike në vend siguron të drejtat e komuniteteve etnike që të kanë qasje në media në gjuhën e tyre amtare dhe posaqërisht departamenti i qeverisë është i autorizuar të përcjell respektimin e të drejtave të pakicave. Përkundër kësaj, aplikimi i rregulloreve të shum-

ta juridike në këtë sferë është vështirësuar me vështirësi financiare, konflikte të interesave politike dhe standard të ultë profesional.

Në Moldavi jetojnë pjesëtarët e më shumë së dhjetë grupeve etnike por moldavishtja dhe rusishtja janë edhe më tutje gjuhë mbizotëruese në media në vend. Botimet në shumicën e gjuhëve tjera varën nga donacionet private dhe paraqitën jo rregullisht.

Përkundër urdhërësive të *Ligjit për transmetim* që 65 përqind e programit të jetë në gjuhën zyrtare, në hapësirën transmetuese moldave dominon ritransmetimi nga Rusia. Aktiviteti i Këshillit transmetues është edhe më tutje jo efikas sa i përkët kësaj.

Konflikti i pazgjedhur me Transdnjestrin solli deri të ndërprerja e përhershme informative mes këtyre dy regjioneve. Dyshimet e dyanshme pengojnë krijimin e afërsisë mes mediave nga rajoni i shkëputur dhe mbetja e vendit.

Krijimi i mediave vërtetë të llojlojshme në Moldavi gjithashtu pengohet me mungesë të solidaritetit profesional mes gazetarëve që ju takojnë etniciteteve të ndryshme.

Megjithatë, iniciativat e kohëve të fundit kanë ndikuar nga baza në ngritje të vetëdijes për këto probleme në mesin profesionalëve të mediave. Gazetarët janë gjithnjë më të zëshëm duke kërkuar vepra për ngritjen e standardeve profesionale, përmirësim të mekanizmave vetë-rregullativ dhe aplikimin e ligjeve relevante. E tërë kjo do të duhej të sigurojë diverzitet kulturor dhe gjuhësor në mediat moldave. Më e rëndësishmja është që ato ti japin rol më të madh mediave si mjet për zgjidhje të konfliktit dhe ndërtimit të besimit.

Rekomandimet

Mediat luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e interesave të grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në Moldavi. Mirëpo, rezultate gjithëpërfshirëse dhe afatgjata mund të arrihen me anën e veprimeve të harmonizuara të akterëve të ndryshëm: Qeverisë, shoqatave etnike dhe grupeve të interesit, institucionëve për trajnim dhe mediave gazetare (atyre të përgjithësuara dhe të specializuara).

Prandaj, rekomandohet që:

Qeveria

- të përpunojë programin gjithëpërfshirës për zhvillimin e mediave në gjuhët e grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në Moldavi si dhe të harmonizojë kornizën juridike me rregulloret;
- ti kushtojë vëmendje kërkesave të përfaqesuve të grupeve etnike dhe të rritë sasinë e transmetimit në gjuhë tjera, përpos asaj moldave dhe ruse, në transmetuesin kombëtar publik (*TeleRadio Moldova*), si dhe të jepë numër me të madh të frekuencave TV dhe radio stacioneve jo moldave/ruse;
- Të sigurojë ndihmë financiare në formë të subvencioneve apo të lehtësimeve tatimore për mediat e shtypura dhe të transmetuara që transmetojnë programe për jetën e përbashkët të grupeve etnike. Ashtu do të sigurohej minimumi i kushteve për ekzistimin e tyre;
- të inkurajojë zyrtarët e Departamentit për marrëdhënie mes kombëve për të konceptuar aktivitetet e tyre të përbashkëta me akterë tjerë (shoqata etnike, grupe profesionale të gazetarëve, mediat).

Shoqatat etnike dhe grupet e interesit

- të janë të angazhuara në aksione të përbashkëta me akterë tjerë në sigurimin e qasjes adekuate në

- media të të gjitha grupeve kulturore/gjuhësore/etnike;
- të njoftojnë të gjitha organizatat relevante (kombëtare dhe ndërkombëtare) për përparim/probleme në qasje në media apo në çfarëdo rasti të mos tolerimit të tyre në media.

Organizatrat profesionale gazetare

- të inkurajojnë nismat që do të përmirësonin mekanizmat vetë-rregullativ të mediave moldave si dhe të promovojnë raportim etnik të llojllojshëm dhe tolerues;
- të lehtësojnë debatin publik me qëllim të formimit të Këshillit për shtyp/Zyra e ombudspersonit në Moldavi, që do të siguronin shqyrtimin e ankesave ndaj mediave.

Institucionet për trajnim (akademike dhe të arsimit të mesëm)

- të ofrojnë kurse për raportim të diverziteteve dhe multi kulturës si plan i rregullt arsimor;
- të ofrojnë shansin gazetarëve që ju takojnë grupeve të ndryshme etnike/kulturore/gjuhësore të angazhohen në projekte të ndërtimit të besimit (dmth. Produksionit të materialit të përbashkët, kampimeve trajnuese për raporte të llojllojshme etj.).

Mediat

- të bëjnë mbikqyrje të përhershme të artikujve/ programeve për të siguruar që organizatat e tyre respektojnë parimet e diverzitetit dhe tolerancës;
- të inkurajojnë multi-kulturën dhe diverzitetin në redaksi (përmes praktikës së mundësisë së njejtë të punësimit).

Nena Skopljanac

Serbia (Serbia dhe Mali i Zi)

Serbia (Serbia dhe Mali i Zi) shtrihet në një hapësirë e cila sipas përbërjes etnike, kulturore dhe linguistike është më e larmishmja në Evropë. Këtu jetojnë me shekuj diku rreth 30 grupe të ndryshme nacionale/etnike dhe gati secila flet gjuhën e vet. Pa marrë parasyshë zhvillimet e 15 viteve të fundit, ky vend ka traditë të gjatë dhe të begatshme të bashkë-ekzistencës së qetë multi-etnike dhe multi-kulturore, duke përfshirë mediat në gjuhë të ndryshme dhe qasjen e tyre për të gjithë qytetarët. Edhe pse luftërat nga vitet e nentëdhjeta nuk e kapluan këtë territor, prapë së prap ato në shumë mënyra të ndryshme ndikuan negativisht në praktikën e periudhës së kaluar multi-etnike dhe multi-kulturore. E tëra kjo solli deri te shumë konflikte latente dhe të dukshme të bazuara në etnicitet, të cilat kërcenojnë që të rriten nëse nuk ju qasemi në mënyrë adekuate. Hapi i parë për vendet që duan të zgjedhin konfliktet etnike në mënyrë paqesore është që të sjellin ligje për të drejtat individuale dhe kolektive për të gjithë. Hapi i dytë është aplikimi i atyre drejtave dhe menaxhimi me sektorin publik sipas parimeve të aprovuara. Në numrin e madh të çështjeve për të cilat duhet gjetur zgjidhje, hyjnë edhe e drejta për përdorimin e gjuhës, liria e të shprehurit dhe qasja ndaj informatave në gjuhën amtare.

Qasja në media në gjuhën e tyre amtare ju jep grupeve të ndryshme etnike kanale për komunikim profesional përmes të cilëve mund të merren edhe me çështje

politike dhe shoqërore. Kjo është pjesë e qasjes gjithëpërfshirëse për ndërtimin e komunitetit, zhvillimin e institucioneve demokratike dhe parandalimit afatgjatë të konfliktit. Për të mundur pjesëmarrjen dhe integrimin, duhet ndërtuar mirëkuptimi i ndërsjellë në kuptimin e identitetit, kulturës dhe sfidave që kanë të bëjnë me komunitetet tjera dhe kombin titullar.

Ky raport ka të bëjë vetëm me Serbinë e jo me Serbinë dhe Malin e Zi si tërësi. Rregulloret relevante të kushtetutës dhe ligjit Federativ që rregullojnë çështjet që janë objekt i kësaj analize në Serbi dhe Mal të Zi, konkretizohen në mënyra të ndryshme. Nga qershori i vitit 1999, pushteti ndërkombëtar ka sjellur dhe ka filluar implementimin e rregulloreve juridike në Kosovë të cilat në masë të caktuar dallohen nga rregulloret në Serbi dhe Mal të Zi. Kjo llojllojshmëri e kornizave juridike pamundëson krijimin e raportit që do të ishte me diapazon të kufizuar por që do të përfshinte edhe Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën. Për këtë arsye ky raport është i përqendruar vetëm në Serbi dhe vendimi për këtë ilustron edhe me faktin që niveli i diverzitetit etnik dhe gjuhësor është më i madh në Serbi sesa që është rasti me Malin e Zi dhe Kosovën (në Serbi ekzistojnë mbi 25 komunitete etnike ndërsa në media janë të përfaqesuara dhjetë gjuhë).

Të dhënat e vetme të besueshme mbi strukturën etnike/nacionale të shoqërisë serbe me të cilat disponojmë për momentin, janë rezultatet e regjistrimit nga viti 1991.¹ Nga mbi 25 grupe të ndryshme etnike, në tekstin e mëtejshëm i theksojmë vetëm ato që sipas numrit përfaqesojnë komunitetet më të mëdha dhe gjuha e të cilave

¹ Të dhënat në lidhje me regjistrimin e kryer në vitin 2002 ende nuk janë përpunuar në tërësi dhe nuk janë publikuar.

është e përfaqësuar në komunikimin publik apo në disa raste edhe në media:

Romët. Ekziston bindje e gjërë që Romët kanë numër më të madh nga ai i paraqitur në regjistrimin e vitit 1991 sipas të cilit janë 143.000. Vlerësohet që ka diku rreth 600.000 dhe 800.000 Romë. Pjesa më e madhe e Romëve — sipas vlerësimeve 300.000 deri 400.000 apo 50 përqind — janë të përqendruar në regjionin e Moravës Jugor dhe Nishit, ku Romët përbëjnë një të tretën e banorëve në disa komuna (Surdulicë, Bujanovc, Bojnik, Vladiqin Han).

Hungarezët. Numri i përfaqësuesve të këtij grupi etnik më të madh në Vojvodinë është 339.491 apo 16,9 përqind e banorëve të Vojvodinës (në tërë Serbinë janë 344.147). Ata janë kryesisht të përqendruar në Vojvodinë ku përbëjnë shumicën absolute në shtatë komuna. Nga numri i përgjithshëm i Hungarezëve vojvodinas, 58,2 përqind jetojnë në këto komuna.

Boshnjakët. Sipas regjistrimit të vitit 1991 janë regjistruar 246.411 Muslimanë (Boshnjakë). Ata janë të përqendruar në rajonin e njohur si Sanxhak, ku takohen kufijt e Bosnës dhe Hercegovinës nga njera anë dhe Serbisë dhe Malit të Zi nga na tjetër. Boshnjakët kanë shumicë absolute në komunat Novi Pazar (75,4 përqind), Sjenicë (76,1 përqind) dhe Tutin (94,3 përqind). Përqendrim i madh i boshnjakëve është edhe në komunat e Prijepolit (30,4 përqind) dhe Prijepoljes (43,4 përqind).

Shqiptarët. Vlerësohet që janë rreth 100.000 Shqiptarë. Ata janë të përqendruar në tri komuna në jug të Serbisë, në luginën e Preshevës e cila kufizohet me Kosovën dhe përfaqësojnë shumicë etnike në dy komuna: Bujanovc (60,1 përqind) dhe Preshevë (89,9 përqind).

Kroatët. Sipas regjistrimit nga viti 1991 janë 111.650 Kroatë të regjistruar apo 74.808 (67 përqind) vetëm në Vojvodinë, që përbën 3,7 përqind të banorëve në këtë krahinë. Situata politike dhe sociale në të cilën u krye regjistrimi i vitit 1991 paraqet një nga arsyet kyçe për rënie të madhe të numrit të Kroatëve. Edhe pse është e njohur që në periudhën pas vitit 1991 shumë Kroatë shkuan nga Vojvodina, posaqërisht nga Sremi, nuk dihet numri i saktë i tyre.

Slovakët. Regjistrimi i vitit 1991 tregoi së në Serbi ka 66.863 Sllovakë. Sllovakët janë grup kryesisht stabil i banorëve. Janë të përqendruar në Vojvodinë (95 përqind) dhe në vitin 1991 përbënin 3,2 përqind nga banorët e Vojvodinës. Për Sllovakët është karakteristike që janë të shpërndarë dhe të përzier me komunitete tjera, posaqërisht me Serbë.

Rumunët. Rumunë ishin 42.364, ndërsa shumica jetonte në Vojvodinë (38.809 apo 1,9 përqind të banorëve në krahinë). Numri i pjesëtarëve të këtij grupi u zvogëlua konsiderueshëm (për 34,5 përqind) nga regjistrimi i parë pas Luftës së dytë botërore. Rumunët kryesisht janë të përqendruar në Banatin jug-lindor, në komunat Vrsnac (13,8 përqind) dhe Alibunar (31,7 përqind), në kufi me Rumaninë.

Bullgarët. Me regjistrim është vertetur që ka 26.922 Bullgarë dhe që me shumicë janë të përqendruar në komunat Dimitrovgrad dhe Bosilegrad, në afërsi të kufirit me Bullgarinë.

Vllahët. Regjistrimi tregoi që janë 17.810 Vllahë, të cilët janë të përqendruar në Homolj dhe krajinën e Timokut në jug të Serbisë.

Grupet tjera etnike më të vogla. Ekzistojnë rreth dhjetë grupe tjera etnike të vogla të cilat me lokalitet gjenden në krahinën e Vojvodinës dhe secili prej tyre përbën më pak se dy përqind të banorëve të Vojvodinës. Sipas numrit janë më të rëndësishmit Rusinët, Ukrajinasi, Bunjevasit, Shokasit, Çekët dhe Gjermanët. Në territorinë e Serbisë jetojnë edhe disa grupe tjera të vogla etnike, siq janë Malazetët, Maqedonët, Sllovenët dhe Hebrenjtë.

Një nga aspektet e rëndësishme të regjistrimit të vitit 1991, është numri i njerëzve të deklaruar si Jugosllav me rritje të konsiderueshme. Numri i **Jugosllavëve** ishte 323.625, apo 3,3 përqind të qytetarëve të Serbisë. Përqindja e Jugosllavëve është tradicionalisht më e madhe në Vojvodinë. Në vitin 1991 ishin 174.225 Jugosllavë apo 8,7 përqind e banorëve në krahinë.²

Është me rëndësi të theksohet që dallimet nacionale/etnike që janë të pranishme në Serbi nuk kanë domethënie e dallimeve themelore në gjuhë. Gjuhët të cilat përfaqesojnë dialekte të ndryshme të serbo-kroatishtes në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) tani në shetet e porsa formuara janë ndarë zyrtarisht si serbisht, kroatisht dhe boshnjakisht. Mirëpo, edhe pse këto janë tri gjuhë të ndryshme zyrtare, njerëzit që lexojnë apo shkruajnë në njerën nga këto gjuhë nuk kanë vështirësi për të kuptuar dy gjuhët tjera dhe të lexojnë ato.

² Mirëpo, duhet patur parasysh që në kohen e regjistrimit në vitin 1991, tendencat nacionaliste ishin në kulminacion dhe lufta ishte në prag, ashtu që disa pjesëtarë të pakicave kombëtare ishin deklaruar si Jugosllavë për të fshehur përkatësinë e tyre etnike dhe në atë mënyrë të mbroheshin. Në relacion me regjistrimin e vitit 1981, regjistrimi i vitit 1991 regjistroi rritje të dyfishtë apo të trefishtë të Jugosllavëve në disa vendbanime.

Shkaku i asaj që është cekur më lartë, në këtë raport mediat në gjuhën boshnjake apo kroate nuk do të konsiderohen si media të një komuniteti etnik por as si media shumë-gjuhësore. Kjo nuk do të thotë që ato media nuk kanë publikë të posaqme (Kroatët dhe Boshnjakët në Serbi). Për këtë arsye merren me tema dhe çështje për të cilat ai publik është posaqerisht i interesuar.

I. Korniza juridike për media

Kushtetuta e Republikës së Serbisë nga viti 1990 garanton shprehjen e lirë të identitetit nacional, kulturës, religjionit dhe lirinë e përdorimit të gjuhës. Mundësia e pranimin të informatave në gjuhën amtare është një nga të drejtat eksplicite të cekura (Neni 8 dhe 49). E drejta për krijimin e mediave në gjuhë të komuniteteve nacionale dhe etnike nuk është veçanërisht e rregulluar me Kushtetutë. Rregullorja e parë që është në pajtim të plotë me standarde evropiane është sjellur me *Ligjin federativ për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe Ligjin për radiodifuzion të Republikës së Serbisë* të dyja ligjet e aprovuara në vitin 2002.

Parlamenti i republikës federative ratifikoi aktet kyçe ndërkombëtare që rregullojnë të drejtat e grupeve etnike për liri të shprehurit dhe informimit, *Kornizën e konventës për mbrojtje të pakicave kombëtare* (viti 1998), dhe *Kartën për gjuhë regjionale dhe të pakicave* (viti 1998).

Në shkurt të vitit 2002, parlamenti federativ miratoi *Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare*. Kjo është arritur me ndihmën e ekspertëve të siguruar nga Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja.

Në nenin 17 ligji garanton informimin përmes mediave në gjuhët e pakicave kombëtare:

“Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë në informim të plotë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre duke përfshirë edhe të drejtën për shprehjen, pranimin dhe shkëmbimin e informatave dhe ideve përmes shtypit dhe mjeteve tjera të informimit publik.

Shteti do t’ju sigurojë programeve të shërbimit publik të radios dhe televizionit, përmbajtje informative, kulturore dhe arsimore në gjuhë të pakicës kombëtare dhe mund të krijojë edhe stacione të veçanta të radios dhe televizionit të cilat do të transmetonin programe në gjuhë të pakicave kombëtare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të krijojnë dhe mbajnë mediat në gjuhën e tyre.”

Ligji mundëson krijimin e fondit federativ për pakica kombëtare (Neni 20). Programet në gjuhë të komuniteteve etnike si dhe projektet e mediave të tyre, tashmë kishin fituar mbështetje në bazë të kësaj rregullore ligjore.

Parlamenti serb në korrik të vitit 2002 miratoi Ligjin për radiodifuzion cili pos tjerash rregullonte çështjen e mediave elektronike në gjuhë të pakicave kombëtare (Neni 72), derisa Neni 78 obligonte mediat elektronike shtetërore që:

“të prodhojnë dhe transmetojnë programe të destinuara për të gjitha segmentet e shoqërisë, pa diskriminim, duke pasur parasyshë gjatë kësaj posaçërisht grupet specifike shoqërore sikur janë fëmijët dhe rinia, grupët e pakicave dhe ato etnike, të hendikepuarit, të rrezikuarit socialë dhe shëndetsorë, shurdhmemecet (me obligim të transmetimit të njëkohësishëm të tekstit të përshkrimit të segmentit tingullor të veprimit dhe dialogut) etj.;

të konsiderojnë standardet gjuhësore dhe të folurit, si të banorëve shumice, ashtu sipas proporcionit edhe të pakicave kombëtare, respektivisht grupeve etnike, në hapësirën ku programi transmetohet;

të sigurojë përmbushjen e nevojave të qytetarëve me përmbajtje programore që shprehin identitetin kulturor si të popullit ashtu edhe të pakicave kombëtare, respektivisht grupeve etni-

ke, përmes mundësisë që disa programe të caktuara, apo tërësi të programeve në rajonet ku jetojnë dhe punojnë të përcjellen edhe në gjuhën dhe shkrimin e tyre amtar.”

Është rregulluar edhe pengimi i gjuhës së urrejtjes (Neni 21):

“Agjencioni do të kujdeset që programet e transmetuesve mos të përmbajnë informata me të cilat nxitet diskriminimi, urrejtja apo dhuna kundër personave apo grupeve të personave shkakut i përcaktimit të tyre të ndryshëm politik apo shkakut i përkatësisë apo jo përkatësisë së tyre ndonjë race, religjioni, kombi, grupi etnik, gjinisë apo orientimit seksual.

Veprimet e transmetuesve në kundërshtim me ndalesën nga paragrafi 1 i këtij neni, janë bazë për shqiptimin e masave të parapara nga Agjencioni, pavarësisht nga të drejtat ligjore që i ka në disponim i dëmtuari.”

Ligji i mundëson sektorit publik të formojë media elektronike (Neni 95) që nuk janë të obliguara të paguajnë kompenzim për transmetim të programit. Duke pasur parasyshë që themeluesit e shumicës së mediave të sotme në gjuhë të grupeve të ndryshme etnike janë organizata joqeveritare apo shoqata të qytetarëve të pakicave kombëtare, kjo rregullore do të stimulojë punën e tyre të mëtejshme. Mirëpo, sipas të njëjtit nen, ato stacione mund të transmetojnë program vetëm lokalisht, që nuk është e favorshme për grupe të mëdha etnike të cilat janë të shkapërderdhura në hapësirë të gjerë, siq është rasti me banorët romë dhe hungarezë.

II. Pasqyrë e mediave

1. Situata në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe në kohën e pushtetit të Millosheviqit. E drejta e grupeve kombëtare/etnike për informim në gjuhën e tyre përmes mediave ishte pjesë e praktikës së

zakonshme në RSFJ, sikur kur janë në pyetje mediat e shtypura ashtu kur janë në pyetje ato elektronike. Mirëpo, duke pasur parasyshë faktin që ishin të lejuara vetëm mediat shtetërore dhe mediat e formuara nga organizatat parashtetërore, liria e mediave ishte mjaft e kufizuar. Pa marrë në konsiderim këto, ekzistonte një numër i shtëpive mediale dhe veprimtari e zhvilluar në gjuhë tjera.

Mediat më të zhvilluara në gjuhë tjera (jo në serbisht) ishin në Vojvodinë. Sëcili nga komunitetet më të mëdha kombëtare dhe etnike kishte shtëpinë e vet botuese që finançohej nga buxheti shtetëror: *Forum* (hungarezët, i themeluar në vitin 1953), *Kultura* (sllovakët), *Libertatea* dhe *Tibiskus* (rumunët), *Ruske slovo* (rusinët). Sëcila nga këto shtëpi botonte së paku një javore politike (në gjuhën hungareze dilte edhe gazeta ditore *Magyar So*) dhe disa revista të specializuara (të shumtën për fëmijë, rini dhe kulturë). *Radio-televizioni Novi Sad (RTV NS)* transmetonte program në disa gjuhë: Hungarisht, sllovakisht, rusinisht, rumunisht dhe rome. *Radio Novi Sad* transmetonte program tërë ditë në gjuhën hungareze, programe katërorëshe në gjuhët tjera dhe çdo ditë nga disa orë program televiziv.

Në jug të Serbisë nuk kishte media në gjuhën shqipe. Komuniteti shqiptarë në luginën e Preshevës ishte i lidhur strukturalisht me Kosovën në më shumë mënyra³, ashtuqë mediat në Kosovë shërbenin si burim primar i informimit. *Radio dhe TV Prishtina* kishte pro-

³ Numri më i madh kreu shkollën e mesme në Kosovë. Pasiqë në RSFJ Universiteti i Prishtinës ishte i vetmi institucion i lartë shkolle në gjuhën shqipe, aty shkonin jo vetëm Shqiptarët e Kosovës por edhe Shqiptarët nga jugu i Serbisë dhe nga Maqedonia. Duke i konsideruar të gjitha, Kosova, posaqeisht Prishtina paraqiste qendër kulturore, shkollore dhe intelektuale për Shqiptarët nga ish RSFJ.

gram tërëditor në gjuhën shqipe, derisa shtëpia botuese *Rilindija* botonte gazetën ditore me po të njejtin emër si dhe revistën rinore *Zëri* dhe disa revista të specializuara.

Sa i përket pjesëve tjera të Serbisë, komuniteti bullgar kishte gazetën me emrin *Bratstvo*, derisa komuniteti vllah nuk kishte media në gjuhën amtare.

Është me rëndësi të posaçme të përmendet që Serbia (Serbia dhe Mali i Zi⁴) ishte një nga vendet e rralla të asaj kohe që ofronte informata në gjuhën rome përmes mediave shtetërore. Edhe *RTV Novi Sad* dhe *RTV Prishtina*, si dhe disa stacione komunale, kishin programe në gjuhën rome. Edhe pse një nga gazetatat e para në gjuhën rome në Ballkan — *Romano Lil* — ishte themeluar në Beograd në vitin 1935, nga mesi i viteve të pesëdhjeta deri në fund të viteve të tetëdhjeta kishte relativisht pak publikime në gjuhën rome. Arsyeja kryesore qëndronte në faktin që Romët nuk ishin njohur si pakicë kombëtare prandaj shteti nuk kishte obligim ligjor ti kushtojë vëmendje sigurimit të informimit të Romëve në gjuhën e tyre amtare sipas kushteve që vlenin për të tjerët, në tekstin e mësipërm të quajtur grupe etnike.

Sipas Kushtetutës, Kroatët, Muslimanët (Boshnjakët) dhe Malazezët nuk konsideroheshin pakica. Këto ishin tri nga krejt gjashtë kombe që formonin ish shtetin federativ dhe shkaku i kësaj, nuk kishin media në gjuhën e tyre. Duke pasur parasyshë që deri në vitin 1991, Kroatët, Muslimanët (Boshnjakët) dhe Serbët flitnin një gjuhë të njejtë — serbokroatishten — të gjitha mediat krye-

⁴ Kjo nuk ishte situatë vetëm në Serbi por edhe në pjesët tjera të ish RSFJ në të cilat banorët romë ishin të konsiderueshëm në numër. Radio programi i parë në gjuhën rome filloi në stacionin *Radio Tetova* (Ish Republika Jugoslave e Maqedonisë) në vitin 1963.

sore ishin në të vertetë në gjuhë të këtyre kombëve të cilat sot janë komunitete etnike në Serbi. E njehta vlente edhe për Sllovenët dhe Maqedonët.

Edhe pse Kushtetuta e miratuar në vitin 1990 dhe disa ligje të veçanta parashihnin të gjitha të drejtat themelore të pakicave — duke përfshirë përdorimin zyrtar të gjuhës në publik, në afarizëm me institucione shtetërore, në shkolla dhe në media — në kohën e pushtetit të Millosheviqit (1990—2000)⁵ pushteti kishte uzurpuar të drejtën në vlerësim të lirë nëse rregulloret relevante aplikohen apo jo (edhe nëse aplikohen, si dhe deri në çfarë mase). Në një varg të çështjeve të ndryshme pushteti madje haptas thyente Kushtetutën edhe ligjet.

Gjysh nga viti 1990, Shqiptarët që punonin në shtëpinë mediale *Radio dhe TV Prishtina* ishin të detyruar ta leshojnë. Pasoj mbyllja e shtëpisë botuese *Rilindja*. Edhe Shqiptarët në jug të Serbisë së bashku me Shqiptarët Kosovarë mbetën në terr të plotë medial. Burimi i tyre primar i informatave ishte programi satelitor i *Radio TV Shqipërisë*. Duke ju falenderuar bindjes së regjimit që nga mediat e shtypura nuk i kanoset rrezik i madh, një grup i intelektualëve në Bujanovc ia arriti që në vitin 1994 të formojë revistën lokale në gjuhën shqipe, *Jehona*. Shpërndarja e kësaj reviste u ndalua disa herë ndërsa ndërmerreshin edhe veprime gjyqësore kundër kryeredaktorit të saj. Përkundër kësaj, *Jehona* vaz-

⁵ Përdorim vitin 1990 e jo 1987 pasi që në atë vit në parlament u miratua Kushtetuta e re e Serbisë ndërsa Millosheviqi u zgjodh kryetar në zgjedhjet e para shumëpartiake presidenciale. Periudha nga viti 1987, kur Millosheviqi fitoi kontrollin e plotë mbi Lidhjen Komuniste të Serbisë deri në mars të vitit 1990 kur u miratua Kushtetuta e re, praqiste një proces gjithpërfshirës për themelimin e një ideologjie të re shtetërore dhe kontrollin e tij të pakufizuar mbi institucionet shtetërore në Serbi dhe mbi të gjitha shtresat e shoqërisë në Serbi.

hdoi të paraqitet, por në verë të vitit 2002 është dashur të ndërprejë punën shkaku i arsyeve financiare.⁶

Në Vojvodinë udhëheqej një politikë plotësisht tjetër. Programet e RTV NS dhe stacioneve lokale komunale në gjuhë të grupeve të ndryshme etnike nuk u ndaluan dhe as nuk u mbyllën shtëpitë botuese. Mirëpo, shteti ndante më pak mjete sësa që duheshin për të mbajtur produksion të pasur medial çfarë kishte qenë më herët. Përpos që shtrydhëshin ekonomikisht, të gjithë profesionistët medial, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike, ata edhe i largonin nga puna poqëse refuzonin të raportin në frymën propagandistike dhe luftë-nxitëse. Kjo si pasojë kishte që personeli i mbetur nuk ishte në gjendje të plotësojë kërkesat themelore në pikëpamje të mbulimit të hapësirës mediale në mënyrë adekuate, e të mos flasim për plotësimin e kriterëve të larta për sigurimin e programit cilësor. Përkundrazi, me përhapje të jo tolerancës ndaj “tjerëve”, ksenofobisë dhe gjuhës së urrejtjes, këto media i kontribonin përhapjes së urrejtjes dhe dhunës etnike. Duke bërë këtë, rrezikuan parimet themelore të traditës së mirë të bashkëjetësës së komunitetit shumë-etnik. Gazetarët e dëbuar nga mediat shtetërore dhe komunale krijonin iniciativa për themelimin e mediave private të pavarura dhe përbënin personelin kryesor në këto media. U themelua një numër i mediave që funksiononin në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë mediat e shtypura dhe elektronike lokale. Mirëpo, shka-

⁶ Gjatë vitit 2000 dhe 2001 *Jehona* merrte ndihmë të konsiderueshme nga (IREX, USAID, OSI, Press Now dhe Medienhilfe). Ndihma u zvogëluua shkaku i faktit që politika redaktuese e kësaj gazete nuk konsiderohej më politikisht korrekte dhe e barabartë. Redaktori kryesor ishte bartës kryesor i listës së kandidatëve të pavarur për zgjedhje lokale që u mbajtën në korrik të vitit 2002 dhe u zgjodh për deputet lokal në asamble.

ku i presionëve të ndryshme mbi ta që i kryente regjimi, të arriturat e tyre ishin të kufizuara. Sa i përket mediave të shtypura, javorja hungareze *Csaladi Kor* ishte përjashtim. Kjo gazetë dilte në tirazh prej 23.000 ekzemplarëve derisa gazetat tjera në gjuhën hungareze nuk kalonin tirazhin prej 2.000 ekzemplarëve. Mediat lokale elektronike punonin pa leje dhe mbulonin hapësirë të vogël. Ekzistonte rreziku që do të mbylleshin në çdo moment. Kjo situatë zgjati deri të rënia e Millosheviqit.

Mirëpo, nuk ishte vetëm regjimi që kontrollonte rreptësisht përmbajtjen mediale që ofrohej në gjuhë të tyre për të forcuar pushtetin duke manipuluar dhe kontrolluar çështjet ndër-etnike. Politikë të njejtë udhëheqnin edhe partitë politike që përfaqesonin ndonjë nga komunitetet, posaçërisht ato që ndanin pushtetin apo kishin pushtetin lokal. Kjo posaçërisht ka të bëjë me partitë e grupit hungarez që kontrollonin gati të gjitha mediat lokale elektronike në komunat e Vojvodinës veriore ku Hungarezët përbënin shumicën absolute të banorëve.

Media e parë e shtypur rome u themelua nga *Rominterpress*. Shtëpia e njejtë mediale filloi bashkëpunimin me stacionin *Radio B92*, e cila dy herë në javë transmeton radio emisione në gjuhën rome (të cilat ritransmetohen nga stacionet e *ANEM-it*). Përfundimisht, para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2000 filloi me transmetim media e parë elektronike rome në Serbi, *Nišava* në Nish.⁷

Duke konsideruar që Sanxhaku ishte vend ku ekziston rreziku i madh për shpërthimin e konfliktit, regjimi rreptësisht kontrollonte informimin përmes mediave elek-

⁷ Shtëpitë kryesore mediale në gjuhë të pakicave apo mediat dygjuhësore dhe shumë-gjuhësore të themeluara në Serbi në kohë të pushtetit të Millosheviqit akoma funksionojnë dhe do të përmenden në tekstin e mëposhtëm.

tronike të atjeshme. Të gjitha mediat elektronike që ekzistonin atëkohë ishin të karakterit komercial dhe argëtues. Vetë nuk prodhonin program informativ. Disa prej tyre ritransmetonin programin informativ nga RTS-i. Ekzistonte vetëm një gazetë e pavarur — *Has* — por edhe ajo shkaku i vështirësive financiare u detyrua të pushojë me punë në vitin 2000.

2. Situata pas rënies së Millosheviqit. Përderisa situata sa i përket mediave të shkruara ka mbetur e pandryshuar, mediat elektronike kanë kaluar nëpër një proces zhvillimor intenziv dhe kaotik në periudhën pas rënies së Millosheviqit. Si pasojë e fakteve që në rregullore ligjore që rregullonin mediat elektronike tashmë dy vjet ekziston vakuum⁸, dhe përkundër sjelljes së moratoriumit për frekuenca⁹, mediat private lokale elektronike, si radiot ashtu edhe TV stacionet, mbinin si këpurdhat.

Në mesin e mediave elektronike të cilat janë themeluar në gjuhë tjera (jo në serbisht) nga fundi i vitit 2000 në mënyrë ilegale, më të shumtat janë radio stacionet lokale rrome, me përafërsisht 25 stacione. Ngjashëm me këtë, në Vojvodinë dhjetra radio dhe TV stacione private

⁸ Në përpjekje për të fituar dhe mbajtur sa më gjatë që është e mundur kontrollin politik mbi media, pushteti i ri tregoi jo gadishmëri mahnitëse për të sjellur ligje për media që do të ishin sipas standardeve evropiane. Projektligji i përpunuar i nëntë i *Ligjit për radiodifuzionin*, të cilin e kanë përgatitur profesionistët e mediave dhe ekspertët lokal në bashkëpunim me këshilltarët e Këshillit të Evropës dhe OSBE-së, përfundimisht u miratua me 18 korrik të vitit 2002.

⁹ Moratoriumi hyri në fuqi në nëntor të vitit 2000 dhe parashihej të zgjatë gjashtë muaj derisa në ndërkohë të miratohej ligji i ri për radiodifuzion dhe të formohej organi rregullativ i cili do të lëshonte licenca. Në vend që të zgjas gjysmë viti, moratoriumi është akoma në fuqi dhe paraqet pengesë për zhvillimin e mediave private elektronike, posaqerisht atyre që nuk ishin të përgatitur të anojnë në dobi të pushtetit të ri.

transmetojnë program në gjuhën hungareze, dhe janë themeluar edhe disa në gjuhën sllovaqe dhe rumune. Rritja më e madhe në numrin e mediave elektronike ndodhi në Sanxhak, ku për moment transmetojnë program¹⁰ informativ dhe komercial dy TV stacione private dhe shtatë radio-stacione private lokale. TV stacioni i parë i themeluar, që çdo ditë transmeton disa orë program në gjuhën bullgare quhet *TV Caribrod*.¹¹ Ngjashëm me këtë, radio emisionet e disa stacioneve lokale komunale së bashku transmetojnë rreth gjashtë orë program në ditë në gjuhën bullgare. Në Bujanovc, në jug të Serbisë, filluan të punojnë disa media elektronike private lokale: *Radio Toni* (në gjuhën shqipe) dhe *Radio Ema* (në gjuhën serbe, me përpjekje për formimin e redaksisë së lajmeve në gjuhë shqipe), dhe disa stacione rome.

Kur është fjala për mediat në Sanxhak, niveli profesional është mjaftë i ultë, derisa sasia e informatave që ofrohen është shumë e kufizuar. Vetëm disa shtëpi mediale ofrojnë përmbajtje qellimi i të cilave është promovimi i tolerancës dhe ato janë agjencia e lajmeve *Sana-press* dhe *TV Jedinstvo* të cilat kanë me siguri rol udhëheqës. Është indikative që të dy agjencitë bashkë-punojnë ngushtë me mediat në mbetje të Serbisë dhe që pjesa më e madhe e përmbajtjes është me qëllim të promovimit të mirëkuptimit dhe tolerancës ndër-etnike si rezultat i këtij bashkëpunimi. Për shembull, *TV Jedinstvo*, pasi që është brenda ANEM-it, më së shpeshti transmeton përmbajtje të prodhuar nga *TV B92* apo nga stacionet tjera nën ombrellën e ANEM-it. Edhepse ka ngecje

¹⁰ Duke mos i përfshirë disa stacione që funksionojnë me parime thjeshtë komerciale.

¹¹ TV programi i parë në gjuhën bullgare u emitua nga TV Pirov (anëtar i ANEM-it) në vitin 2000 por në kohë mjaft të kufizuar (një orë në ditë).

që dy vjet shkak i moratoriumit për licenca, projekti i agjencisë së lajmeve *BETA*, caku i së cilës është themelimi i radio-stacioneve private të pavarura, me siguri do të sjell përmirësim të dukshëm në këtë plan.

Numri i madh i mediave elektronike nuk do të thotë cilësi të lartë dhe llojllojshmëri të programit. Vetëm disa nga stacionët e sapo formuara kanë programe që përmbushin standardet profesionale. Sasia e përmbajtjes informative është minimale (zakonisht në kohëzgjatje prej disa minutave në çdo orë gjatë ditës); emisionet për çështje aktuale janë të rralla dhe më së shpeshti nënkuptojnë intervista në studio; emisione me përmbajtje të llojllojshme gati që nuk ka, ndërsa vetëm disa stacione të sapo formuara transmetojnë program arsimor dhe kulturor. Si pasojë e tërë kësaj, është në pyetje nëse këto stacione janë në gjendje të plotësojnë kushtet e nevojshme për t'u marrë me çështje esenciale shoqerore, ekonomike dhe politike të publikut cilit i drejtohen dhe a do të mund të funksionojnë si mekanizëm për ruajtje dhe përparim të kulturës dhe traditës. Përpos kësaj, duke pasur parasyshë stërngarkimin e tregut të mediave elektronike, si dhe potencialin mesatar të kufizuar të këtyre mediave në krahasim me mediat që për grup kanë banorët shumicë të vendit kur është fjala për reklama — mund të pritët që shumica e këtyre mediave nuk do të mbijetojnë pa aplikimin e *Ligjit për radiodifuzion*¹². Nuk duhet lënë anash faktin që shumicës nga këto shtëpi mediale nuk do ti jipën fare frekuenca dhe li-

¹² Sipas Ligjit për radiodifuzion, duhej formuar Këshilli radiodifuziv brenda afatit gjashtë mujor nga hyrja në fuqi e ligjit, dmth, më së voni deri në fund të janarit të vitit 2003. Mirëpo, ligji ishte thyer pasi deri në mars të vitit 2003, parlamenti serb nuk zgjodhi përfaqesuesit e vet në këtë Këshill. Si rrjedhim i kësaj, Këshilli ende duhet formuar dhe duhet të fillojë me përgatitjet për konkurs publik.

cenca pasi nuk do të plotësojnë kushtet që i parashikon ligji.¹³

Pa konsideruar faktin që gazetaria mbizotëruese është me cilësi problematike, ekzistojnë gazeta, radio dhe TV stacione të cilat merren me veprimtari gazetare në pajtim me standardet profesionale. Disa stacione të cilat në këtë moment kanë mbulim me cilësi të ultë janë të përcaktuara të bëhen shtëpi të mira mediale lokale. Këto dy grupe të mediave tani kanë rol të rëndësishëm në komunitetet e tyre dhe do ta kanë edhe në të ardhmën.

Sot, në përgjithësi çështjet etnike janë më të mbuluar në media kryesore sesa që ishte rasti në kohën e pushtetit të Millosheviqit. Mirëpo, mënyra e raportimit dallon konsiderueshëm. Mediat shtetërore, sikurse edhe mediat private, që si shtylla mbajtëse të pushtetit të Millosheviqit përhapnin ideologji nacionaliste dhe urrejtje ndaj tjerëve, tani për çështje etnike informojnë gati ekskluzivisht përmes raporteve për manifestime dhe masa që i ndërmerr pushteti. Hapesirë analitike gati që nuk ka ndërsa rrefime për jetën dhe çështjet e grupeve të ndryshme etnike shfaqen vetëm në raste të posaçme (për shembull, me rastin e sjelljeve raciste apo sulmeve në qytetarë që ju takojnë grupeve etnike). Nga ana tjetër, mediat e pavarura, të cilat kishin rol udhëheqës në luftë kundër regjimit të vjetër, tani vëjnë standarde të raportimit të përgjegjshëm profesional dhe shoqëror për çështje etnike. Ata sjellin në dritë problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet etnike, ju ofrojnë qytetarëve që ju ta-

¹³ Sëcili stacion duhet të përmbushë kushtet në aspekte të mundësive teknike dhe programore. Mirëpo, prioritet ju dha kushteve të programit. Stacionet që nuk përmbushin këto kushte nuk do të fitojnë frekuenca, derisa stacionet që plotësojnë kushtet teknike e jo ato të programit do të fitojnë licenca të përkohshme dhe do të ju caktohet afati prej dy viteve për harmonizimin e tyre me standarde teknike.

kojnë grupeve etnike dhe grupeve të shoqërisë qytetare në komunitete të ndryshme etnike mundësinë t'i drejtohen publikut të gjërë, duke ftuar në përgjegjësi organet e pushtetit të nivelit lokal dhe shtetëror kur është fjala për implementimin e politikës së duhur në lidhje me çështjet etnike, kryejnë fushata të shumta me qëllim të ngritjes së vetëdijës publike për çështje etnike dhe fushata për promovimin e tolerancës.

Sasia e gjuhës së urrejtjes në media është zvogëluar konsiderueshëm në krahasim me kohën e Millosheviqit. Gazetarët rrallë përdorin retorikë e cila mund të nxitë në urrejtje ndonjë nga grupet etnike. Mirëpo, një numër i mediave transmeton deklaratat e politikanëve dhe djathtistëve të cilat kanë ton shovinist dhe ksenofobik. Dhe këtu është fjala për mediat që shërbenin si zëdhënës të regjimit Millosheviqian. Mediat e pavarura, të cilat luftuan kundër regjimit dhe politikës së tij luftë-nxitëse dhe nacionaliste, ndaj atyre deklaratave mbajnë një dozë të merituar kritike.

Në mediat kryesore që mbulojnë tërë territorin e vendit dhe paraqesin shembujt më të mirë të raportimit me angazhim dhe të llojllojshëm për çështjet etnike si dhe kundërshtimet ndaj gjuhës së urrejtjes hyjnë ditorja *Danas*, javorja *Vreme*, dyjavorja *Republika*, dhe agjencia e lajmeve *BETA*. Përpos kësaj, të gjitha mediat lokale elektronike që janë anëtare të ANEM-it, si dhe mediat lokale të shtypura të mbledhura në Shoqatën e shtypit lokal, kanë rregulla të sjelljes që konkretisht kanë të bëjnë me raportimin për llojllojshmërinë dhe kundërshtimin e gjuhës së urrejtjes. Në mediat më të dedikuara hyjnë *Radio 021*, *Radio Boom 93*, *OK Radio*, dhe javorët *Nezavisna svetlost* dhe *Vranjske novine*.

3. Tipologjia. Shtëpitë mediale nuk dallojnë vetëm nga gjuhët në të cilat transmetohet programi por edhe sipas mënyrës si përdorën ato gjuhë. Shtyp, radio dhe TV programe ka në nentë gjuhë të ndryshme: në hungareze, sllovaqe, rome, shqipe, bullgare, vllahe, gjermane, ruse, rumune dhe ukrainase. Duke përfshirë gjuhën kroate dhe boshnjake dhe gjuhën serbe të shumicës në media në Serbi janë të përfaqesuara dymbëdhjetë gjuhë. Dallon edhe mënyra në të cilën këto gjuhë përdorën posaçërisht kur është fjala për mediat e shtypura. Në tekstin e mëtejshëm janë të paraqitura opcionet dhe kombinimet e ndryshme ndërsa ndarja është bërë në media të shtypura dhe elektronike.

3.1. Mediat e shtypura. Nuk ka të dhëna të tërësishme për numrin e plotë të shtëpive mediale në të gjitha gjuhët. Mirëpo, të dhënat që kanë të bëjnë me Vojvodinën, ku publikohen shumica e mediave të shtypura, tregojnë që gati 150 shtëpi të regjistruara funksionojnë në gjuhë që nuk është serbe. Klasifikimi i këtyre gazetave mund të tregohet në mënyrë skematike si vijon:¹⁴

¹⁴ Këtu nuk janë përfshirë revistat për fëmijë, rini, femra, ekspert dhe shkencëtarë, bujqesi etj. Ato gati të gjitha dalin në një gjuhë. Ky klasifikim është në lidhje me mediat që me përmbajtje të tyre i drejtohen publikut të komuniteteve etnike si të tillë.

Lloji i gazetës	Mbulimi	Lloji i shtypit sipas mënyrës së përdorimit të gjuhës
I. ditore II. javore III. dyjavore IV. mujore	1. kombëtare 2. regjionale 3. lokale	A. vetëm në një gjuhë B. dygjuhësor (gjuhë serbe dhe një tjetër) a. secili artikull në dy gjuhë b. vetëm artikujt kryesorë në dy gjuhë, artikujt tjerë dallojnë në gjuhë c. vetëm një artikull në njerën nga dy gjuhët
<p>Vërejtje: Mbulimi definohet sipas kriterëve vijuese: (a) territori për të cilin bëhet fjalë; (b) territori i distribuimit dhe shitjes së gazetës; dhe (c) pozita gjeografike e publikut që i dedikohet. Gazetat klasifikohen si: 1. kombëtare: në tërë territorin e Serbisë; 2. regjionale: në tërë territorin e Vojvodinës/Sanxhakut/Serbisë jugore/Serbisë lindore/Serbisë qendrore; 3. lokale: territori i një komune (duke përfshirë edhe komunat fqinje).</p>		

Sa i përket llojit të gazetës, mediat e shtypura në gjuhë të ndryshme përfshijnë të gjitha gazetat e treguara në tabelë. Mirëpo, të gjitha gazetat që dalin më shpesh botohen në Vojvodinë dhe atë në gjuhë të grupeve më të mëdha. Kjo me siguri lidhët me faktin që ato gjuhë nga viti 1990 kanë qenë zyrtare në Vojvodinë¹⁵ dhe që shteti kishte subvencionuar shtëpitë botuese dhe shtypin. Ekziston vetëm një gazetë ditore — *Magyar Szo* (hungarisht). Grupi hungarez ka edhe dy javore — *Csaladi Kor* dhe *7 Nap*. Sllovakët, Rusinët dhe Rumunët kanë nga një javore: *Hlas L'udy*, *Ruske slovo* dhe *Libertatea*. Përpos *Csaladi Kor*-it, gazetat tjera edhe sot mbështeten

¹⁵ Me Kushtetutën e Serbisë të miratuar në vitin 1990, Vojvodinës në mënyrë drastike ju zvogëluar autonomia që përmbante disa përgjegjësi formale. Pos tjerash, gjuha serbe u proklamua si gjuhë e vetme zyrtare në tërë territorin e Vojvodinës (gjuhët tjera u pranuan pjesërisht si zyrtare por vetëm në komunat ku grupet etnike përbënin shumicën e banorëve).

nga buxheti shteteror. Të gjitha gazetat tjera, si në Vojvodinë ashtu edhe në mbetjen e Serbisë dalin nga dy herë në javë apo një herë në muaj. Shkaku i mjeteve të kufizuara financiare shumë prej tyre botohen jo rregullisht.

Asnjë nga gazetat që nuk janë në gjuhën serbe nuk ka mbulim kombëtar. Arsyeja qendron kryesisht në faktin që nuk ka arsye të vertetë për një gjë të tillë pasi që të gjitha grupet etnike, me përjashtim të asaj rome, për-qendrohen në hapesira të posaçme.

Gati të gjitha shtëpitë botuese botojnë gazeta vetëm në një gjuhë — gjuhën e grupit të vetë. Mirëpo, ka edhe disa përjashtime që paraqesin shembuj interesant dhe ia vlen të përmenden.

Përjashtim të parë bëjnë gazetat në gjuhën rome — psh. *Romano Lil* dhe publikimet tjera të botuara nga *Romiterpress* — që janë dygjuhësore, ku secili artikull është edhe në gjuhën rome edhe serbe. Arsyeja kryesore për këtë është që gjuha rome akoma nuk është standardizuar dhe që Romët flasin me dialekte të ndryshme; disa nuk mund të lexojnë në gjuhën Rome por mund të kuptojnë serbisht ndërsa qellimi i botuesve është të ter-hjekin jo vetëm publikun lexues romë por edhe tjerët që janë të interesuar për çështje të lidhura për Romët.

Disa gazeta të vogla lokale në Vojvodinë përfaqesojnë përjashtimin e dytë. Për shembull, dyjavorët *Kikind-ske novine* dhe *Novi Becejac*, që botohen edhe në gjuhën hungareze edhe atë serbe.

3.2. Mediat elektronike. Ngjashëm me mediat e shtypura, numri i mediave elektronike që transmetojnë program në gjuhë të ndryshme është mjaft i madh — përmbi 150. Numri më i madh (90 përqind) janë radio-programe apo radio-stacione. Klasifikimi i këtyre mediave, sipas kriterit të mediave të shtypura, në mënyrë skematike duket si vijon:

Lloji i mediave elektronike	Mbulimi	Lloji i programit sipas mënyrës së përdorimit të gjuhës
I. shtetëror ¹⁶ II. private III. sektori qytetar ¹⁷	1. kombëtare 2. regjionalne 3. lokale	A. programet javore a. në një gjuhë b. në shumë gjuhë B. programet ditore a. në një gjuhë b. në shumë gjuhë C. tërë programi është në gjuhë të një grupi etnik D. tërë programi është në dy gjuhë (në serbisht dhe gjuhë të një grupi etnik) a. Me programe kohore të ndara në secilën nga gjuhët b. gjuhët e përziera brenda programit të njejtë E. tërë programi është në shumë gjuhë a. Me programe kohore të ndara në secilën nga gjuhët b. gjuhët e përziera brenda programit të njejtë
Vërejtje: Mbulimi kombëtar nënkupton së paku 2/3 e territorit të Serbisë; mbulimi regjional nënkupton territorin e Vojvodinës/Sanxhakut/Serbisë jugore/Serbisë lindore/Serbisë qendrore; ndërsa lokal nënkupton territorin e një komune (duke përfshirë edhe komunat fqinje).		

¹⁶ Edhe pse Ligji i ri për radiodifuzion parasheh transformimin e mediave elektronike ekzistuese shtetërore (RTS dhe RTV Novi Sad) në media private elektronike, ky proces nuk ka filluar ende e jo që është përfunduar. Për këtë arsye në këtë raport të dy shtëpitë mediale përmenden si shtetërore.

¹⁷ Numër i konsiderueshëm i mediave elektronike në gjuhë të pakicave janë formuar nga organizatat joqeveritare, posaqërisht kur bëhet fjalë për mediat në gjuhën rome. Duke patur parasysh që Ligji i ri për radiodifuzion parasheh diskriminim pozitiv të këtyre shtëpive mediale, mund të pritët që më shumë shtëpi mediale do të zgjedhin këtë opcion për parashtrimin e kërkesave për frekuanca dhe licencë.

Programet në gjuhë të komuniteteve të ndryshme etnike janë të përfaqesuara tek të gjitha llojet e mediave elektronike. Mirëpo, media shtetërore që mbulon tërë territorin e vendit — *RTS* — në gjuhën rome transmeton vetëm gjysmë ore program ditor në radio. Ky program përbëhet nga dy pjesë: lajme për ngjarjet më të rëndësishme në vend dhe botë dhe pjesën që merret më ngjarjet kryesore brenda komunitetit romë. *RTS* nuk transmeton fare TV program që nuk është në gjuhën serbe.

Situata ndryshon vetëm pak në media elektronike regionale. Stacioni shtetëror *RTV Novi Sad*, përpos emisioneve në gjuhën serbe, çdo ditë transmeton TV emisione në gjuhë hungareze, rumune, rusine dhe sllovaqe si dhe një herë në javë në gjuhën rome, kroate dhe ukrainase. Radio çdo ditë transmeton program në gjuhë të grupeve të njejta etnike si dhe TV. Programi prodhohet dhe redaktohet nga redaksitë e ndara gazetare dhe përpos emisioneve të lajmeve, merren me tema që konkretisht kanë të bëjnë me grupin e caktuar etnik, me bashkëpunim të rrallë me grupe tjera.

Ekzistojnë rreth 150 radio dhe TV stacione lokale që transmetojnë program në gjuhë tjera (jo në serbisht). Përafërsisht e katërta e këtyre stacioneve janë stacione komunale, ndërsa tjerat janë media private dhe në masë të vogël media të themeluara nga sektori jo qeveritar (me shumicë stacionet rome por edhe stacionet e grupeve të vogla në Vojvodinë siq janë Sllovakët dhe Rusinët). Gjysma e këtyre stacioneve është në Vojvodinë.

Gjuha më e përfaqësuar tek mediat Vojvodinase në gjuhë jo-serbe është hungarishtja (rreth 50), pasojnë romja (rreth 10), derisa gjuhët tjera paraqiten në programet e më së shumti pesë stacioneve. Programi kryesor tek më shumë së gjysma e këtyre stacioneve është në gjuhën serbe (shumica prej tyre janë stacione komuna-

le), derisa grupve tjera etnike ju dedikohen disa orë në ditë apo javë në gjuhën e tyre amtare. Nga ana tjetër, stacionet private që transmetojnë program në gjuhë të grupeve të caktuara etnike përdorin gati vetëm gjuhën e atyre grupeve. Vetëm dy stacione — *Radio 021/Multiradio* dhe *Radio Kovačica* — kanë program shumëgjuhësor, e para në pesë gjuhë (hungareze, sllovae, rumune, rusine dhe rome) sikurse edhe serbe ndersa e dyta në tri gjuhë (hungareze, sllovae dhe rumune). *Radio Kovačica* aplikon mënyrën e njejtë të gjuhëve sikur *RTV NS*, derisa *Multiradio* është stacioni i vetëm në Serbi që ka radio-emisione në të cilat përzihen të gjitha gjuhët. Përpos kësaj, në emisionet njëgjuhësore ky stacion shpesh transmeton informata në lidhje jo vetëm me një grup etnik por edhe për një apo më shumë grupe gjuhësore. Informatat për ngjarje relevante në cilëndo nga komunitetet transmetohen në emisione që ju drejtohen popullatës serbe. Kjo qasje mjaft specifike mirëpritet nga publiku dhe renomeja e këtij stacioni gjithnjë rritet.

Sa i përket stacioneve lokale në pjesën tjetër të Serbisë, pas gjuhës serbe më e përfaqesuara është gjuha rome. Ekzistojnë rreth 15 stacione në të cilat programi kryesor është në gjuhën serbe dhe rreth 20 stacione rome. Dy stacione transmetojnë program në gjuhën bullgare — *TV Pirot* dhe *TV Caribrod* (*TV Caribrod* nga disa orë çdo ditë). Vetëm stacionet rome kanë program të vërtetë dygjuhësor, sipas nevojës përdorin njejtë gjuhën serbe dhe rome. Të gjitha emisionet ku mysafiri flet vetëm serbisht transmetohen gjithmonë në gjuhën serbe.

Në prill të vitit 2001, misioni i OSBE-së lansoi pilot-projektin në jug të Serbisë. Koncepti themelor parasheh transformimin e mediave komunale në qytetet Bujanovc, Preshevë dhe Medvegjë. *Radio Bujanovci* fiton një pjesë të mjeteve financiare për të pranuar personel

shqiptarë me qellim të themelimit, krahas radaksisë ekzistuese në gjuhë serbe, edhe redaksinë e lajmeve në gjuhën shqipe. Në shtator të vitit 2002 filloi transmetimi i përditshëm i lajmeve pesëminutëshe dhe pritet që në vitin 2003 të organizohet program gjithpërfshirës informativ në shqip. Ka filluar të transmetohet edhe programi një orësh javor në gjuhën rome. Nga *Radio Presheva* dhe *Radio Medvegja* pritet të bëjnë lajme edhe në gjuhë të grupit tjetër etnik (në shqip në Medvegjë dhe në serbisht në Preshevë), që nënkupton kycjen e gazetarëve nga “komunitete tjera”. Qellimi i këtyre projekteve është të sigurohet program për secilin nga komunitetet të cilin do ta bëjnë gazetarët e atij komuniteti në gjuhën e tyre.

Konkludimet në lidhje me media elektronike që nuk janë në serbisht janë si vijon:

1. Me përjashtim të stacioneve rome, që kryesisht transmetojnë program dygjuhësor (në gjuhën rome dhe serbe), të gjitha mediat tjera kanë program vetëm në gjuhën e grupit të tyre etnik.
2. Është i kufizuar numri i programeve në një apo më shumë gjuhë në media që gjuhë kryesore kanë serbishten. Programi përgatitet nga një apo më shumë redaksi të ndara të lajmeve ndërsa përmbajtja e këtyre redaksive nuk është e ndërlidhur mes veti.
3. Vetëm disa media transmetojnë program në më shumë se dy gjuhë dhe në mesin e tyre vetëm *Multiradio* ka qasje më të vertetë shumëgjuhësore në transmetimin e programit.
4. Edhe pse numër i madh i mediave elektronike transmeton program në një apo më shumë gjuhë të ndryshme duhet patur parasyshë që shumica e madhe e mediave kryesisht transmeton program komercial, muzikor dhe argetues kurse rrallë edhe informativ (në

rastin më të mirë vetëm lajme të shkurtëra në çdo orë të plotë).

5. Mund të pritet që numri i këtyre stacioneve do të zvogëlohet në periudhën që vjen sepse shumë prej tyre nuk do të plotësojnë kushtet në pikëpamje të programeve të nevojshme për të fituar licencën.

3.3. Projektet tjera mediale. Edhe pse mediat e shtypura dhe elektronike në të shumtën mbizotërojnë, është me rëndësi të vërehet përfaqësimi i gjuhëve të ndryshme në disa sfera tjera të rëndësishme mediale, sikur që janë shërbimet e agjencioneve të lajmeve, TV produksionet e pavarura dhe Interneti.

Agjencioni i parë i pavarur i lajmeve i formuar ndonjëherë në Serbi, *BETA*, tashmë dy vjet ofron shërbime në gjuhën hungareze dhe kohëve të fundit ka filluar edhe shërbimin në gjuhën rome. Të dyja janë shërbime ditore dhe ekzistojnë plane për zhvillimin e shërbimit në gjuhën hungareze në kuadër të projektit regjional që do të përfshinte Hungarinë dhe shtetet e regjionit që kanë të pranishme komunitete hungareze (Rumunia, Kroacia dhe Sllovenia).

Vetëm një TV produksion i pavarur prodhon program në gjuhë që nuk është serbe: *UrbaNS* në Novi Sad (Vojvodinë). Emisioni i tyre me titullin *Multigrad* merret me çështje kulture, transmetohet me titra dygjuhësor (në serbisht dhe hungarisht), dhe të gjithë pjesëmarrësit e emisionit, duke përfshirë edhe pjesëtarët e grupeve tjera etnike, flasin në gjuhë të tyre amtare. Programi transmetohet në dhjetra TV stacione lokale në Vojvodinë. Duke konsideruar që ka vetëm disa TV stacione që transmetojnë program në gjuhë të ndryshme, ky projekt i jep kontribut të rëndësishëm begatimit të TV programeve me qasje ndër-etnike dhe multi-kulturore.

Informatat në gjuhë të ndryshme në internet nuk janë sa duhet të përfaqesuara. Vetëm *Csaladi Kor*, *Rominterpress* dhe *RTV Nišava* kanë sajtet e veta. Mirëpo këto sajte nuk vizitohen shumë. Sidoqoftë, sajti i një prej mediave kryesore terheq vëmendje të posaçme. Sajti i *RTV B92*, media e njohur Beogradase në tërë botën, ofron lajme ditore jo vetëm në gjuhën serbe por edhe në hungareze dhe shqipe. Përpos kësaj, karakteristikë e këtij sajti është forumi i madh që ishte organizuar në disa dhjetra tema të ndryshme dhe në të cilin vizitorët nga mjedise të ndryshme etnike marrin pjesë aktive në komunikim virtual. Ky sajt vizitohet mesatarisht nga 90.000 njerëz në ditë.

3.4. Rast special — mediat në gjuhën rome dhe programi në gjuhën rome. Romët janë grupi më i madh i pakicave në Serbi (Serbia dhe Mali i Zi) dhe përbejnë rreth 10 përqind nga numri i përgjithshëm i banorëve. Mu për këtë është e rëndësishme ti kushtohet vëmendje e posaçme mediave që ofrojnë informata në gjuhën rome. Në këtë gjuhë dalin vetëm katër gazeta (një për fëmijë, një profesionale dhe dy që merren me çështje Rome). Të gjitha këto gazeta dalin jo rregullisht (kur sigurohen mjete nga donatorët) dhe me tirazh të kufizuar. As me TV programe situata nuk është shumë më e mirë — për moment ekziston vetëm një stacion romë ndërsa programi në gjuhën rome transmetohet nga dy stacione. Sipas kësaj, mund të konkludohet që radio paraqet burim primar të informatave për komunitetin romë. Ekzistojnë dhjetra radio-stacione rome. Nuk ka rezultate të anketave që do të merreshin me hulumtimin e publikut romë. Mirëpo, në bazë të shëmbullit të radios *Zëri i Romëve* dhe *RTV Nišava*, mund të konkludohet që Romët që kanë qasje në stacione rome dhe jo-rome që transmetojnë program në gjuhën rome më me dëshirë

zgjedhin të parat. Kjo me siguri ka të bëjë me marginalizimin intenziv dhe diskriminimin afatgjatë të Romëve që kanë sjellur deri të nevoja për vetë-emancipim. Romët i konsiderojnë stacionet rome si media “të tyre” dhe mund të identifikohen me to. Fakti që kanë media “të veta” i bën krenar dhe ju jep vetëbesim. Edhe një përparësi është që mund të dëgjojnë programe që merren me tema që i interesojnë dhe atë në çfarëdo kohë të ditës.

Duke marrë të gjitha parasyshë, mediat jo-rome kanë kapacitete të kufizuara për plotësimin e nevojave për informim në gjuhë amtare të popullatës rome, ku nuk ka plane që këto kapacitete të përmirësohen për një kohë të shpejtë. Nga ana tjetër, vetëm disa media elektronike rome ofrojnë program të pranueshëm kur është fjala të përmbajtja. Duke konsideruar faktin që i ka formuar sektori qytetar mund të transmetojnë program vetëm në nivel lokal. Si një nga mënyrat për rritjen e përhapjes së programeve në gjuhën rome, stacionet rome që nuk prodhojnë program në shtëpi të vet, si dhe stacionet lokale komunale dhe stacionet private mund të ritransmetojnë emisionet më të rëndësishme nga prodhimi i medieve elektronike rome sikur që janë *RTV Nišava* dhe *Zëri i Romëve*, si dhe programin e *Multiradios* në gjuhën rome. Disa stacione tashmë e bëjnë këtë dhe rezultatet janë pozitive.¹⁸

III. Përfundim

Serbia (Serbia dhe Mali i Zi) kanë traditë të gjatë të shumëgjuhësisë e cila manifestohet në praktikën media-

¹⁸ Disa radio-stacione rome në jug të Serbisë ritransmetohen nga *Radio Nišava*. Përpos kësaj, disa stacione të *ANEM*-it ritransmetojnë emisionet e radios *Zëri i Romëve*.

le sikurse edhe në sfera tjera. Mirëpo, duhet patur parasyshë disa gjëra të rëndësishme.

E vetmja shoqeri e vërtetë multi-etnike dhe multi-kulturore me traditë të shumë-gjuhësisë tolerante ekziston në Vojvodinë. Në rajonet tjera multi-etnike në Serbi, qytetarët origjina e të cilëve është tjetër nga origjina e kombit titullar hasin në vështirësi kur është fjala për përdorimin e gjuhës së tyre në publik dhe në media. Infrastruktura mediale për përmbajtje në gjuhë të ndryshme është shumë e zhvilluar në Vojvodinë ndërsa në pjesën tjetër të Serbisë është shumë e dobët (psh. për bullgarisht) apo është në krijim (psh. për gjuhën rome, shqipe dhe vllahë).

Edhe pse me numër të konsiderueshëm — me më tepër se 150 media lokale elektronike dhe numër të njejtë të mediave të shtypura vetëm në Vojvodinë — mediat në gjuhë të ndryshme janë mesatarisht shumë të pazhvilluara, të pajisura dobët, nuk kanë numër të mjaftueshëm të punësuarve kurse standardi i mbulimit është shumë i vogël. Për të luajtur rolin të cilin do të mund ta luanin ju duhet të bëjnë një punë të madhe. Posaçerisht mediat rome nuk janë mjaftë të forta për të plotësuar nevojat e mëdha që qytetarët romë kanë për programe informative dhe arsimore në gjuhën e tyre amtare.

Marrëdhëniet multi-etnike u zhvilluan në drejtim shumë negativ gjatë të nentëdhjetave. Mosbesim i madh, frigë dhe madje urrejtje, që prodhoheshin në fund të tetëdhjetave dhe fillim të nentëdhjetave, tani në media paraqiten vetëm në raste të rralla. Mirëpo, nuk duhet ushqyer iluzionet që këto probleme janë tejkaluar plotësisht. Disa politikanë dhe grupe të djathta radikale janë shumë prezentë në publik me deklarata diskriminuese, shoviniste dhe ksenofobike të cilat disa media i transmetojnë pa marrë qendrim kritik. Në këtë plan ka mbetur

shumë punë për t'u kryer ku mediat duhet të luajnë rol të rëndësishëm përmes raportimit profesional dhe të angazhuar shoqëror. Megjithatë, disa nga shtëpitë kryesore mediale paraqesin shembull të jashtëzakonshëm për raportim të llojllojshëm dhe promovim të tolerancës, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe respektimit të drejtave të njeriut. Rol udhëheqës në këtë kanë *RTV B92*, gazeta ditor *Danas*, javorja *Vreme* dhe agjencioni i lajmeve *BETA*.

Numri më i madh i mediave në gjuhët tjera janë njëgjuhësore ose dygjuhësore. Numri i mediave shumëgjuhësore është shumë i vogël ndërsa shumica prej tyre janë media elektronike. Mirëpo, këto media në të shumtën e rasteve kanë borde të ndara redaktuese dhe kohë të ndarë për emisione në secilën gjuhë. Kjo mund të sjell deri të realiteti paralel medial në baza gjuhësore, dhe krahas kësaj, në baza të ndryshimit etnik. Në këtë aspekt, *Multiradio*, radio stacioni romë dhe produksioni *UrbaNS* paraqesin praktikën më të mirë. Nga projektet e shumta në gjuhë të komuniteteve etnike që prodhojnë mediat kryesore, më të suksesshmet janë agjencioni i lajmeve *BETA* dhe Internet lajmet *B92*.

Ligjet e reja në sferën e mediave dhe Ligji federativ për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, tradita e mediave në gjuhë të komuniteteve etnike dhe një nga sektorët më të zhvilluara të pavarura mediale në Evropën jug-lindore paraqesin bazë mjaft solide për ndërtim të mëtejshëm. Por prap, pushteti, mediat dhe sektori joqeveritar duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të realizuar sektorin pluralist dhe të pavarur medial i cili do të ofrontë një varg të tërë të mediave të ndryshme në gjuhë të komuniteteve etnike dhe do të plotësonte kërkesat e shoqërisë multi-etnike të Serbisë.

Bibliografia

- Bashiq, Goran**, *Zaštita prava nacionalnih manjina u SR Jugoslaviji prema standardima Okvirne konvencije za zaštitu nacionalnih manjina Saveta Evrope* (Mbrojtja e të drejtave të pakicave në RF të Jugosllavisë sipas standardeve të Konventës për mbrojtje të pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës), Beograd: Qendra për Veprim Kundër Luftës, 2002.
- Breznik, Dushan**, *Stanovništvo Jugoslavije*, (Pupullsia e Jugosllavisë), Beograd: Chronos, 1991.
- Ligji për radiodifuzion**, i miratuar nga Parlamenti Serb, me 18 korrik 2002.
- Brunner, Roland**, dhe **Skopljanac, Nena**, Dokumenti strategjik për përkrahje të EU-s mediave të në periudhën 2001—2005 (Strategy Paper for EU Support to Minority Media for the Period 2001—2005) (Medienhilfe, 2001, dokument intern).
- Qendra për Veprim Kundër luftës**, *Struktura kombëtaree banorëve në Vojvodinë* <www.caa.org.yu>
- Darbishire, Helen**, (Darbishajr, Helen), "Minorities and Media Freedom under International Law" ("Pakicat dhe liria e mediave sipas ligjit ndërkombëtar"), Të drejtat e Romëve, 4 (1999) <http://errc.org/rr_nr4_1999/advo1.shtml>
- Galjus, Orhan**, "Stateless: Roma and the Media Today" ("Pa shtet: Romët dhe mediat sot"), Roma Rights, 4 (1999) <http://errc.org/rr_nr4_1999/advo2.shtml>
- Qendra për të drejtë humanitare**, *Shqiptarët në Serbi — Presheva, Bujanovci dhe Medvegja*, 2002. <<http://www.hlc.org.yu>>
- Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare**, Gazeta zyrtare SRJ, nr. 11, 27. shkurt 2002.
- Lenkova, Mariana**, *Zi dhe bardhë ndaj diverzitetit (Imazhi për Romët në mediat ballkanase)* <www.greekhelsinki.gr/english/articles/montpellier-marianna.html>
- Projekti për marrëdhënie etnike**, *Mediat dhe Romët në Evropën bashkëkohore: faktet dhe trillimet* (Prag, 1996)
- Regjistrimi i popullsisë, amvisërive, banesave dhe pronave bujqësore në 1991*, vëllimi 3 (Beograd: Enti federativ për statistikë, 1993).
- Regjistrimi i refugjatëve dhe personave tjerë të rrezikuar nga lufta në Republikën Federative të Jugosllavisë; Komisariati i Lartë për Refugjatë të Kombëve të Bashkuara, Komisariati për refugjatë të Republikës së Serbisë, Komisariati për personat e zhvendosur i Republikës së Malit të Zi*, Beograd, 1996.
- Valij-Nedeljkoviç, Dubravka**, *Mediat në krahinën multi-kulturore dhe shumë-gjuhësore të Vojvodinës*, 1999.

Rekomandimet

I. Çështjet strukturale dhe detyrat e organeve shtetërore

E përgjithshme:

1. Financimi direkt nga buxheti shtetëror — qoftë në nivel vendi, krahine (Vojvodina) apo komune — lënë mundësinë që shteti të kontrollojë mediat dhe për këtë arsye do të duhej ndërprerë. Duhet formuar fonde publike, për shembull fondacione të cilat do të kyçnin komunitetet etnike dhe mediat, shoqatat gazetare, organizatat jo qeveritare mediale dhe të ngjashme. Institucionet shtetërore do të mund të kishin përfaqesues në organet që aplikojnë fonde publike por nuk do të duhej të përfaqesoheshin me shumicë.
2. Organet shtetërore në të gjitha nivelet duhet të ndërprejnë praktikën e ndarjes së mjeteve për mediat në gjuhë të komuniteteve etnike që janë në pronësi shtetërore. Deri sa të formohet mekanizmi i financimit publik, ndihmë financiare duhet dhënë në bazë të kriterëve objektive dhe transparente si dhe pa diskriminim të mediave private.
3. Organet shtetërore nuk do të duhej të themelojnë media të reja në gjuhë të komuniteteve etnike. Roli i shtetit nuk është të themelojë media por të krijojë kornizën juridike dhe mekanizmat e financimit publik për nxitje të themelimit të mediave që do të funksionojnë pavarësisht nga strukturat shtetërore.

Mediat e shtypura:

4. Shoqëritë demokratike nuk e njohin shtypin në pronë shtetërore. Si rrjedhim i kësaj, shtëpitë botuese apo mediat e veçanta të shtypura në gjuhë të komuniteteve etnike duhet të transformohen dhe të funksionojnë pavarësisht nga të gjitha strukturat shtetërore dhe politike.

5. Tatimet në fuqi dhe shpenzimet postare paraqesin ngarkesë të madhe për mediat e shtypura, posaçërisht kur është fjala për mediat e vogla në gjuhë të komuniteteve etnike. Qeveria dhe parlamenti duhet të miratojnë propozimin e paraqitur kohë më parë nga Ministria e financave dhe ekonomisë dhe të hëkin tatimin mbi shtyp. Gjithashtu, duhet miratuar edhe masa adekuate në lidhje me shërbime postare, të cilat gjithashtu paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm për ndihmë indirekte shtypit të pavarur në shumë demokraci evropiane.

Mediat elektronike:

6. Mediat elektronike shtetërore — *Radio-Televizija Srbije (RTS)*, *Radio-Televizija Novi Sad (RTV NS)*, si dhe një numër i mediave lokale komunale — nuk duhet të kanë monopol apo pozitë të privilegjuar kur është çështja e transmetimit të programeve në gjuhë të komuniteteve etnike. Do të duhej siguruar kushtet për një sistem medial plural në pikëpamje të programit në gjuhë të komuniteteve etnike. Të gjitha mediat e sektorit publik, privat dhe qytetarë duhet të kanë mundësi dhe kushte të njejta për punë të qendrueshme.
7. Duhet hulumtuar mundësitë për miratimin e rregullorëve juridike të cilat do të sjellin diskriminim pozitiv të dhënia e licencave për media të sektorit qytetarë. Kjo është posqerisht e rëndësishme për mediat në gjuhë të komuniteteve etnike të cilat janë të shkapërderdhura nëpër tërë vendin. Konsiderim të veçantë për këtë meriton komuniteti romë.
8. Pa marrë parasyshë faktin që janë të kufizuara sikur në përfshirje ashtu edhe në çështje me të cilat merren, programet në gjuhë të komuniteteve etnike në *RTS*-u dhe *RTV NS* janë mjaft të shtrenjta. Në ato shkojnë mjete të konsiderueshme të cilat mund të ju jepën projekteve private apo projekteve të komuniteteve. Duhet hulumtuar mundësitë e blerjes së

programeve të prodhuara nga TV produksionet e pavarura.

II. Mediat në gjuhë të komuniteteve etnike

9. Edhe pse në numër të madh, mediat në gjuhë të komuniteteve etnike janë të pazhvilluara kur bëhet fjalë për infrastrukturën. Personeli shpesh mëzi plotëson standardet profesionale, produksioni i programit është me sasi të kufizuar dhe kryesisht i cilësisë jo të pranueshme. Në çdo mënyrë duhet ndihmuar shtëpitë mediale që vetë prodhojnë program informativ, duke përfshirë infrastrukturën, trajnimin e personelit dhe mjete për zhvillim të programit.
10. Kujdes i veçantë duhet kushtuar Romëve, që përfaqesojnë grupin më të madh të pakicave në Serbi. Është me rëndësi të veçantë të ndihmohet zhvillimi i mediave elektronike të komuniteteve në rajonet me përqendrim më të madh të popullatës rome, si dhe projekte për shkëmbimin e programeve dhe ndërlidhje mes këtyre mediave, si në vend ashtu edhe diku tjetër.
11. Shkëmbimi i programeve, koproduksioni dhe vënia në rrjet e mediave në gjuhë të komuniteteve etnike mund të përmirësojnë cilësinë. Duhet nxitur edhe bashkëpunimin përtej kufijve. Në këtë mënyrë, mediat mund të përmirësojnë mirëkuptimin e ndërsjelltë dhe tolerancën mes kombëve titullare dhe njerëzve në regjion.
12. Shumica e mediave në gjuhë të komuniteteve etnike funksionon në nivelin lokal. Mirëpo, vetëm disa prej tyre janë media të komunitetit. Rekomandohet bashkëpunim më intenziv mes mediave të tilla nga njëra anë dhe shoqërisë lokale/regjionale qytetare nga ana tjetër. Organizatat joqeveritare mund të luajnë rol posaqërisht të rëndësishëm — ato të cilat janë formuar nga përfaqesuesit e komuniteteve etnike por edhe tjerat — përmes projekteve të partneritetit dhe pjesëmarrjes aktive në prodhimin e programit.

13. Numri më i madh i mediave në gjuhë të komuniteteve etnike është njëgjuhësor. Disa janë dygjuhësorë (kryesisht mediat rome). Ka shumë pak media shumë-gjuhësore, madje edhe në Vojvodinë, ku jetojnë përmbi 25 grupe etnike dhe ku flitën dhjetra gjuhë. Nëse kësaj i shtohet praktika mbizotëruese që programet përgaditën ndarazi në secilën prej gjuhëve, rreziku vjen nga paraqitja e realiteteve paralele mediale në bazë të ndryshimeve etnike. Në prodhimin e programeve në gjuhë të ndryshme janë të nevojshëm borde redaktuese të përziera etnike apo bashkëpunim mes bordeve. Sipas kësaj, praktikë më e mirë për zhvillim në të ardhmën kanë *Multiradio*, radio-stacionet rome, produksionet e *UrbaNS*-it, si dhe shërbimet e agjencisë së lajmeve *BETA* dhe Internet lajmet e *B92* në gjuhë që nuk janë serbe.
14. Mediat dygjuhësore dhe shumë-gjuhësore do të mund të sjellin rezultate pozitive vetëm nëse shoqëria e pranon shumëgjuhësinë si pjesë normale të jetës së përditshme. Në rajonet ku komunitetet etnike përbëjnë shumicën apo pjesë të konsiderueshme të banorëve, duhet ofruar kurse opcionale dhe pa pagesë të gjuhëve të komuniteteve etnike.

I. Hyrje

Shoqëritë multi kulturore zhvillohen kur popuj me origjinë të ndryshme etnike, gjuhësore dhe religjioze jetojnë së bashku në territorin e njejtë. Zvicrra në këtë pikëpamje konfrontohet me dy lloje të përvojave të ndryshme: të vjetër dhe të re. Përvoja e vjetër rrjedh nga fakti që Zvicrra me më shumë së pesë shekuj ka qenë shtet multikulturor dhe në të njejtën kohë dallohej me disa gjuhë dhe kultura. Përvoja e re është rezultat i imigracionit të njerezve nga Evropa perendimore, jugore dhe lindore si dhe nga Azia, Afrika dhe Amerika Latine. Ky proces filloi në shekullin e shtatëmbëdhjetë, vazhdoi gjatë të shekullit tetëmbëdhjetë dhe nentëmbëdhjetë dhe u bë më evident në shekullin e njetzet. Përvoja më e vjetër multi-kulturore solli deri të mbrojtja e fortë e grupeve etnike, që nënkupton edhe dhënien e mediave. Përvoja më e re multi-kulturore, pasi që rrjedhi nga imigrimi i punëtorëve të huaj dhe refugjatëve pasqyrohet me integrim nga njëra anë dhe me segregacion nga ana tjetër. Për këtë arsye nuk është lehtë të sigurohen media për imigrantet.

II. Histori e shkurtër e multi-kulturalitetit Zvicërran

Në territorin e Zvicrrës moderne gjithmonë përdorëshin më shumë gjuhë.¹ Këtë Zvicrra ia kishte borxh pozitës së sajë gjeografike. Kurora malore e Alpeve shtrihet përgjatë tërë Zvicrrës dhe ndan Evropën në jug dhe veri ndërsa lumenjtë sikur Ara, Rajna dhe Rona në të kaluarën shpesh kufizonin zonat e ndikimit. Gjuhë origjinale në Zvicërr ishin gjuhët e Keltëve (në veri dhe perendim), Retoromanëve (në lindje) dhe Lepontinasve (në jug). Në periudhën prej vitit 121 deri 15 të erës së vjetër ky territor hyri në përbërje të perandorisë Romake. Më shumë se 400 vjet kanë dominuar gjuha dhe kultura latine. Në atë proces, pjesët perendimore të Zvicrrës ishin romanizuar me herët dhe në mënyrë më radikale sësa pjesa tjetër e vendit.²

Fiset Gjermane gjithnjë e më shumë depërtonin në territorin e Zvicrrës. Më të parët erdhen Burgundët, rreth vitit 450 të erës së re dhe atë në rajonin e Gjenevës. Edhe pse politikisht ishin dominant, Burgundët shumë shpejtë ndrruan gjuhën e tyre më atë Romake. Pas vitit 500 të erës së re, në Zvicërr depërtuan Alemanët. Këtu u zhvillua proces i kundërt. Gjuha gjermane e Alemanëve mbeti dominante dhe Keltet e romanizuar hjekën dorë nga gjuha e tyre. Në fillim kufiri gjuhësor shtrihej mes pjesëve alemane dhe burgunde të Zvicrrës, përgjatë lumit Ara por më vonë u lëviz më shumë kah

¹ Valter Has, "Sprachgeschilchliche Grundlagen", në librin *Die vierspachige Schweiz*, redaktor Robert Shlepfër, (Cyrih: Ex Libris, 1984), 21—70.

² Andres Furger, "Der unterschiedliche Romanisierungsgrad zwischen Ost und West in roemischer Zeit", *Forum Helveticum, Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhone — liens et ruptures* (Lencburg, 2002), 34—40.

perendimi. Pjesa jugore e Zvicrrës (Italia veriore) së pari banohej nga fisi gjerman Langobarda, që pas një kohe humbi gjuhën e vet dhe pranoi gjuhën më të re latine (italiane). Në Reti u ruajt gjuha retoromane që i takon gjuhëve latine. Ashtu ndodhi që katër gjuhë në Zvicërr të ndahen me kufij para më shumë së 1.500 vjet; gjuha alemane në veri dhe lindje dhe burgundo-romane në perendim, retoromane në juglindje dhe italiane në jug.

Konfederata e vjetër zvicërrane, e cila filloi të themelohej në shekullin e trembëdhjetë, përfaqesonte aleancën e parë në të cilën flitej vetëm gjermanishtja. Në të gjitha qytetet dhe vendet lideret politik flisnin vetëm gjermanisht (Friburgu pjesërisht ishte përjashtim). Mirëpo, kantonët e bashkangjitura dhe territoret vazale shumë shpejtë i shtuan gjuhë tjera konfederatës së kantonëve në qeveri. Në vitin 1388, pjesa e parë frengjisht folëse ju bashkangjiti kësaj konfederate (në Jurë). Pastaj vijoi bashkangjitja e pjesës italisht folëse në vitin 1439 (në Ticino). Në vitin 1496 konfederatës ju bashkangjit edhe populli i parë që fliste gjuhën retoromane (në kuadër të Tri marrëveshjeve të Retisë). Pra, konfederata zvicërrane 500 vjet kishte katër gjuhë. Por megjithatë, deri në vitin 1798 asnjë nga pjesët jo gjermano-folëse nuk fituan statusin e kantonit qeverisës. Ata edhe më tutje mbetën subjekte apo kantone të bashkangjitura (me të drejta më të vogla), mu sikur shumë pjesë gjermano-folëse. Tek në Republikën Helvetike (1798—1803), konfederatët e pjesëve frrengo, italiano dhe retoromano folëse fituan të drejtat e njejta. Mirëpo, tek në shekullin e nentëmbëdhjetë, modeli konfederativ i të drejtave gjuhësore të pakicave u pranua dhe është vënë në letër.

Duke konsideruar çka është cekur më lartë, në Zvicrrën moderne ekzistojnë katër grupe gjuhësore me tetë lloje të gjuhëve të shkruara.³

- 64 përqind e popullatës në Zvicrrën qendrore dhe në pjesët veriore dhe lindore që kufizohen me Gjermani dhe Austri flasin gjermanisht. Në pjesën gjermano-folëse të Zvicrrës në jetën e përditshme, në radio por edhe në televizion flitën rreth 25 dialekte të ndryshme. Mirëpo, shumë rrallë edhe shkruhet në ato dialekte. Institucionet shtetërore, shtypi si dhe establishmenti letrar përdorin gjuhën e shkruar letrare gjermane.
- 19 përqind e popullatës në pjesën perendimore të vendit, e cila kufizohet me Francën dhe quhen “Suisse Romande”, flasin frengjisht. Këtu dialektet janë plotësisht të marginalizuara, ato nuk përdorën as në shkrim as në të folur në radio dhe televizion. Gjuha e mediave është frengjishtja.
- 8 përqind e popullatës në pjesën jugore të vendit që kufizohet me Italinë, kryesisht në Ticino (kantoni Tesin), por edhe në një pjesë të luginës Grison (kantoni Graubinden), flasin italisht. Këtu ekzistojnë edhe disa dialekte të folura të cilat ndonjëherë përdorën edhe në media.
- 0,6 përqind e popullatës në pjesën malore të Grisonit në juglindje të Zvicrrës flasin gjuhën retoromane. Ekzistojnë pesë dialekte të ndryshme (puter, valader, sursilvan, sutsilvan dhe surmiran) që përdorën edhe në formë të shkruar ku edhe librat janë të shkruara në to.⁴

³ Roxher Blam, “Sprachenvielfalt und Foederalismus”, *Zoom Kommunikation & Medien*, nr. 12/13 “Der Fernsehboom” (maj 1999), 50—55.

⁴ Martin Arnold, “Rumantschs vulains restar! Die romanische Kultur”, *Basler Magayin*, 40 (5 tetor 2002), 3—5.

III. Korniza juridike për media

1. Vendosja e shumëllojshmërisë gjuhësore me Kushtetutën e Re. Në rregullat e ligjit të ri kushtetues që kanë të bëjnë me shumëllojshmërinë gjuhësore, janë me rëndësi katër nene të Kushtetutës së Re Federative.:

Neni 4 — Gjuhët vendore (“Landessprachen”)

Gjuhët vendore janë gjermanishtja, frengjishtja, italianishtja dhe retoromanishtja.

Neni 18 — Liria gjuhësore

Garantohet liria gjuhësore.

Neni 70 — Gjuhët

1. Gjuhë zyrtare e Qeverisë Federative janë gjuha gjermane, frenge dhe italiane. Në komunikim me qytetarët që flasin retoromanisht edhe gjuha retoromane është zyrtare në shtetin federativ.
2. Kantonët vetë vendosin cilat gjuhë zyrtare do të përdorin. Me qëllim të harmonizimit të komuniteteve të ndryshme gjuhësore, kantonët respektojnë strukturën origjinale të rajonit, si dhe gjuhët amtare të pakicave.
3. Shteti federativ dhe kantonet përparojnë komunikimin dhe shkëmbimin mes komuniteteve gjuhësore.
4. Shteti federativ ndihmon kantonët shumë-gjuhësore në kryerjen e detyrave të tyre specifike.
5. Shteti federativ mbështet Grisonin dhe Ticinon në kujdesin dhe promovimin e gjuhëve retoromane dhe italiane.

Në vitin 1999 populli dhe kantonët pranuan versionin e ripunuar të Kushtetutës Federative të Zvicrrës. Çështje qendrore ishte ajo e përcaktimit të shumëllojshmërisë gjuhësore dhe në krahasim me Kushtetutën e vjetër versioni i ri përmban rregulla me të zgjeruara dhe më të

dallueshme të ligjit zvicërran për gjuhë. Barazia e të gjitha gjuhëve vendore (“Landessprachen”) (Neni 4) përmendet në kapitullin “rregullat e përgjithshme” si risi; në kushtetutën e vjetër kjo barazi përmendej në kapitullin “rregullat e posaçme” (Neni 116). Edhe vetë termi “Landessprache” si i tillë paraqet risi. Më herët flitej për “Nationalsprachen”.⁵

Mirëpo, mbëtet e paqartë së a rrjedhin kompetencat e shtetit federativ nga ky nen i ri.⁶ Liria gjuhësore si e drejtë themelore është edhe një risi tjetër. Gjykata federative, si ligj të pashkruar kushtetues nga viti 1965⁷, tashmë kishte pranuar këtë të drejtë themelore sipas së cilës të gjithë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën që vetë e zgjedhin. Mirëpo, në kushtetutën e re federative janë edhe dy nene që janë në lidhje me të drejta gjuhësore. Sipas Nenit 8 (barazia juridike), askush nuk guxon të jetë objekt diskriminimi “në bazë të origjinës, racës, gjinisë, moshës, gjuhës, statusit shoqëror, mënyrës së jetës, bindjes ideologjike apo politike, ose në bazë të paaftësisë fizike, mentale apo psikike”. Sipas Nenit 31, alinea 2 (burgosja), secili që burgoset ka të drejtë “të informohet menjëherë në gjuhën të cilën e kupton, për shkaqet e burgosjes, si dhe për të drejtat e tij”.

2. Ligjet për gjuhë. Me qëllim të aplikimit të dispozitave të Kushtetutës së re Federative lidhur me shumëllojshmërinë gjuhësore të vendit, u formua grupi punues

⁵ Në gjuhën angleze nuk mund të bëhet dallimi mes “Landessprache” dhe “Nationalsprache”; dy terminët duhet të përkthehen si “gjuhë kombëtare”. Në terminologjinë e lingistikës shqipe ekziston edhe termi *gjuhë vendore* — vër. përkth.

⁶ Lucius Mader, “Der verfassungsrechtliche Rahmen des Sprachrechts des Bundes”, *Babylonia*, 4 (2001), 15—22.

⁷ Lucius Mader, “Der verfassungsrechtliche Rahmen des Sprachrechts des Bundes”, *Babylonia*, 4 (2001), 16.

që punoi në përgatitjen e ligjit të ri për gjuhë. Në verë të vitit 2001, projektligji ju dorëzua kantonëve, palëve dhe grupacionëve të interesuara, për të mundur të ofrojnë komente. Ky proces akoma nuk ka përfunduar.

Ligji përmban masa për përparim të aftësive gjuhësore në gjuhë vendore dhe bashkëpunim të botuesve dhe studentëve në të gjitha nivelet e shkollimit me qëllim të krijimit të qendrës së kompetencave (“Kompetenzzentrum”) në sferë të shumëllojshmërisë gjuhësore si dhe zhvillimin e mjeteve të komunikimit për palët e treta. Me ligjin e ri për gjuhë parashihet ndihmë e cila tashmë është caktuar për gjuhën retoromane dhe italiane në Grison dhe Ticino, si dhe ndihma që shteti federativ ju ofron kantoneve shumëgjuhësore. Është planifikuar edhe mbështetje në sektorin botues në rajonet e Zvicrrës ku flitet gjuha retoromane dhe italiane si dhe shtypi retian përmes agjencisë retiane të lajmeve.⁸

Mirëpo, është me rëndësi të përmendët që shumica e neneve të ligjit të planifikuar për gjuhë ose në mënyrë eksplicite përmendin katër gjuhë vendore (“Landessprachen”), ose janë të formuluar aq në përgjithësi sa që nuk është e qartë a është parasyshtë shumëllojshmëria multi-kulturore gjuhësore që i kalon kufijt e katër gjuhëve vendore. Përjashtim bën Neni 17, pikat b dhe c të ligjit për gjuhë ku në mënyrë eksplicite përmenden njerëzit që nuk dijnë asnjë nga gjuhët vendore:

Neni 17 — Gjuhët vendore (“Landessprachen”) dhe mobiliteti

- Shteti federativ mund të jep ndihmë finaciare për:
- a. përparim të njohurisë së gjuhëve amtare vendore të njerëzve që jetojnë jashtë rajonit gjuhësor;

⁸ <www.kultur-schweiz-admin.ch/kultges/h_sprapoli.htm>

- b. përparim të njohurisë së gjuhës vendore të personat që nuk flasin asnjë gjuhë vendore (“Landessprachen”);
- c. kurse të gjuhës dhe kulturës amtare për personat gjuha amtare e të cilëve nuk është ndonjëra nga gjuhët vendore (“Landessprachen”).

Si aplikim i mundshëm i këtyre dispozitave përmendet vetëm ndihma financiare e shtetit federativ për kantone, posaqerisht në lidhje me sektorin edukativ. Në nenet tjera nuk cekët qartë, nëse është konsideruar edhe ndonjë nga gjuhët që nuk hyjnë në gjuhë vendore. Neni 21 mund të shërbej si shembull:

Neni 21 — *Institucionet që promovojnë shumë-gjuhësinë*

1. Shteti federativ dhe kantonet bashkarisht udhëheqin institucionin shkencor për të promovuar shumë-gjuhësinë.
2. Detyrat e këtij institucioni janë si vijon:
 - a. të promovojë hulumtimin e aplikuar në sferën e shumë-gjuhësisë;
 - b. të zhvillojë forma të reja të edukimit shumëgjuhësor dhe evaluimin e këtij edukimi;
 - c. të drejtojë qendrën për informim dhe dokumentim;
 - d. të ndihmojë në koordinimin e hulumtimit të shumë-gjuhësisë në Zvicërr.
3. Shteti federativ do të themelojë organin këshillues i cili do ti ofrojë shërbime këshilluese këtij institucioni.

Ligji federativ për subvencionim dhe përparim të gjuhës retoromane dhe italiane ekziston qysh nga viti 1983.⁹

⁹ 24 qershor 1983 AS 1983 1444, ndryshuar në vitin 1991 AS 1991 2108.

Gjatë vitit 1996 është miratuar verzioni i ri i këtij ligji.¹⁰ Sipas këtij ligji, shteti federativ lejon subvencione për Grison dhe Ticino të kushtëzuar nga kontributi i tyre. Shteti federativ merr përsipër më tepër së 75 përqind në shpenzimet e përgjithshme ndërsa kantonet duhet të marrin pjesë me më së paku 25 përqind. Neni 2, alinea 2, thotë: “Shteti federativ mund të merr pjesë në financim të mirëmbajtjes dhe promovimit të gjuhës retoromane dhe shtypit të Retisë.” Kjo u formulua edhe më qartë në “rregulloren për subvencionime për mirëmbajtje dhe promovim të gjuhës dhe kulturës retoromane dhe italiane”¹¹. Përpos kësaj, shteti federativ financiarisht ndihmon gazetat dhe revistat që rregullisht botohen në gjuhën retoromane si dhe agjencin e lajmeve e Retisë (Neni 4). Grisoni në bazë vjetore financiarisht ndihmohet nga “Ligia Romontscha/Lia Rumantscha”, si dhe “Vereinigung (association) Pro Grigioni Italiano”, dmth. Organizata që mbështetin gjuhën dhe kulturën retoromane në kantone. Në vitin 1983 për herë të fundit u rrit shuma, për Retianët në 400.000 Franka zvicerane, ndërsa për Zvicërranët që flasin në gjuhën italiane në 350.000 Franka zvicerane.¹² Për agjencinë Retiase të lajmeve (*Agentura da Novitads Rumantscha ANR*) në vitin 1996, u shtua shuma vjetore në maksimum prej 350.000 Franka zvicerane.¹³ Për vitin 2003, Grisoni (kantoni Graubinden) garantoj shumë më prej 2,6 milion Franka zvicerane; shteti federativ duhet të aprovojë 4,75 milion Franka zvicerane. Për këtë arsye pritet që grupi i gjuhës retoromane dhe italiane do të marrin gjithsejt si ndihmë 7,4 milion

¹⁰ 6 tetor 1995, SR 441.1, AS 1996 2280.

¹¹ 26 shtator 1996, SR 441.31, AS 1996 2283.

¹² Vendimi i parlamentit kantonal nga 27 shtatori i vitit 1983, *Buendner Rechtsbuch* (libri statutor i Grisonit) nr. 494.600.

¹³ Vendimi nga 23 maji 1996, *Buendner Rechtsbuch* no. 494.600.

Franka zvicërrane. Nga viti 1981, në Ticino është në fuqi “Regolamento aull’aiuto finanziario federale per la difesa della cultura e della lingua” i shpallur nga Këshilli shtetëror.¹⁴

3. Të drejtat e të huajve. Kushtet juridike për të huajt që jetojnë në Zvicërr janë të rregulluara me Kushtetutë Federative, Neni 121 (“Dispozitat juridike në lidhje me hyrje në vend dhe dalje nga vendi, qendrim dhe banim të huajve, si dhe lejim të azilit politik, janë çështje e shtetit federativ”)¹⁵ dhe të “dispozitave federale që rregullojnë qendrimin dhe banimin e të huajve”.¹⁶ Në nenin 25a thuhet që shteti federativ garanton mbështetje financiare për integrim shoqëror të huajve, me kusht që kantonet, pushteti lokal dhe palët e treta edhe vetë të marrin pjesë në financim. Në bazë të këtij neni, Këshilli federativ solli rregullorën për integrimin e të huajve, sipas të cilës ndihma financiare mund të lejohet:

- a. që të huajt të mbajnë lidhje me gjuhën dhe kulturën e tyre;
- b. për të vazhduar me politikën e mirëfilltë të informimit për dhe rreth popullatës së huaj në Zvicërr;
- c. për të promovuar dialogun ndër-kulturor dhe pjesëmarrjen aktive të popullatës, (...);
- d. për të trajnuar dhe siguruar shkollim të mëtejshëm për njerëzit që punojnë në sferën e shkëmbimit ndër-kulturor.”

Për aprovimin e ndihmës financiare është përgjegjës komisioni federativ për të huaj.

¹⁴ 10 nëntor 1981, Raccolta leggi Ticino 5.5.1.1(165 c).

¹⁵ 18 prill 1999, SR 101, AS 1999 2556.

¹⁶ 26 mars 1931, SR 142.20, BS 1 121.

4. Liria e mediave. Fakti që Kushtetuta federative garanton lirinë e mediave është pjesë e dispozitave juridike. Neni 17 thotë: “Garantohet liria e shtypit, radios dhe televizionit, si dhe formave tjera të shërbimeve publike të telekomunikacionit. Ndalohet censurimi. Shtypit i garantohet fshehtësia e informatave.”¹⁷

IV. Rajonët gjuhësore dhe prania e mediave

1. Tregjet e vogla me numër të madh të mediave. Në Zvicërr secili rajon gjuhësor ka në disponim mediat vetanake. Korporata Zvicërrane për Radio dhe Televizion (*Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG*) menaxhon me dy kanale televizive dhe prej tri deri pesë radio-stacione në secilin rajon gjuhësor të Zvicërrës — rajonin gjerman, francez dhe italian. Për Zvicërrën Retoromane është siguruar program i plotë i radios dhe një pjesë e programit televiziv. Është me rëndësi të përmendët që në rajonin e Zvicërrës ku flitet gjuha italiane, program i plotë është siguruar vetëm për 300.000 njerëz. Përpos kësaj, secili rajon ka agjencitë e shtypit, radio stacione dhe kanale televizive private regjionale, gazeta ditore, javore dhe gazeta që dalin të dielave si dhe gazeta tjera. Përjashtim i vetëm është Zvicërra retoromane e cila nuk ka fare javore.¹⁸ Mirëpo, dukët gjithnjë më evidente që grupet tjera gjuhësore fitojnë pjesën që e kanë me të drejtë, vetëm me ndihmën financiare të siguruar nga pjesa gjermane e Zvicërrës. Proporcioni i provizionëve dhe reklamave të *SRG*-së është më i madh sesa që është ra-

¹⁷ 13 shtator 2000, SR 142.205, AS 2000 2281.

¹⁸ Mirko Mar, Vincenc Vis, Roxher Blam dhe Hajnc Bonfadeli, *Journalisten in der Schweiz. Eigenschaften, Einstellungen, Einflüsse* (Constance: UVK, 2001), 277.

sti me produksionet e pavarura të pjesëve italiane dhe retoromane të Zvicrrës. Agjencioni Zvicërran i Shtypit (*Schweizerische Depeschenagentur SDA*) ofron shërbime në gjuhën gjermane, franceze dhe italiane. Konfederata dhe kantoni Graubinden (Grison) financojnë agjencinë retoromane të shtypit ANR.¹⁹

Tabela 1: Prania e mediave sipas rajonëve gjuhësore

<i>Media</i>	<i>Pjesa gjermane</i>	<i>Pjesa franceze</i>	<i>Pjesa italiane</i>	<i>Pjesa retoromane</i>	<i>Gjithsejt</i>
Agjencitë e shtypit	2	2	1	1	6
TV kanalët e SRG-së	2	2	2	0,1	6,1
TV kanalët private	18 (+46)	3 (+26)	1 (+2)	—	22 (+74)
Radio-stacionët e SRG-së	5	4	3	1	13
Radio-stacionët private	34	15	2	1	52
Gazetat ditore	47	12	3	1	63
Gazetat jo-ditore	79	40	9	4	132
Gazetat javore	2	—	—	—	2
Gazetat që dalin të dielave	2	2	2	—	6
Revistat gazetare	1	1	—	.	2

Tregjet mediale që janë me rëndësi për produksionin medial zvicërran janë të ndara qartë sipas kufijve gjuhësor. Kjo do të thotë që janë relativisht të vogla. Rajoni më i madh është rajoni gjermano-folës i Zvicrrës, i cili përfshin pesë milion banorë, dhe më së paku Zvicrra retoromane, ku rajoni me përqendrim më të madh është me vetëm 30.000. Kjo si pasojë ka gazetën me tirazh

¹⁹ Kushtet juridike mund ti shihni në kapitullin e tretë.

prej 300.000 ekzemplarëve, nga rajoni gjermano-folës i Zvicrrës ndërsa gazeta më e madhe në Zvicrrën retoromane ka tirazh prej vetëm 6.000 ekzemplarëve.

Tabela 2: Gazetat më të mëdha sipas rajonëve gjuhësore

Rajoni gjuhësor	Gazetat më të mëdha ditore	Gazetat tjera të mëdha	Javorja më e madhe apo gazeta që del të dielave
Pjesa gjermane	Blick (314.179)	Bremgartner Anzeiger (15.439)	SonntagsBlick (334.693)
Pjesa franceze	24 heures (89.619)	La Gruyere (15.034)	La Matin-Dimanche (220.451)
Pjesa italiane	Corriere del Ticino (39.142)	Il Lavoro (40.007)*	Il Mattino della Domenica (47.302)
Pjesa retoromane	La Quotidiana (5.822)	Novitats (4.341)	

* Në Ticino, *Il Lavoro* — gazetë sindikale javore — ka tirazh të madh. Gazetat tjera në gjuhën italiane, që dalin çdo ditë, kanë tirazh mes 1.000 dhe 6.000 ekzemplarësh. Burimi: "Katalog der Schweizer Presse" (Katalogu i shtypit zviceran), 2001.

2. Mbulimi dhe përdorimi i mediave. Zvicrra hyn në vendet me mbulimin më të madh me shtyp. Kjo është kryesisht si rezultat i rregullimit federativ. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, secila luginë dhe rajon dëshironte të kishte gazetën e vetë. Në qytetet e mëdha botoheshin gazeta të ndryshme; për secilën palë nga një. Madje edhe sot, Zvicrra karakterizohet me shumicë të gazetave të vogla, respektivisht gazeta me tirazh tejet të kufizuar. Më shumë se 100 gazeta kanë tirazh më të vogël se 15.000 ekzemplarë. Kjo vlen për të gjitha rajonët gjuhësore. Sëcili nga tri rajonet më të rëndësishme gjuhësore ka një gazetë të ashtuquajtur "elite" (*Neue Zuercher Zeitung* në rajonin gjermano-folës, *Le Temps* në rajonin francez,

ndersa *Corriere del Ticino* në rajonin italiano-folës të Zvicrrës). Por vetëm rajonet gjermano dhe frengo-folëse të Zvicrrës kanë edhe tabloidet e tyre. Përpos kësaj, rajoni gjermano-folës i Zvicrrës është pjesa e vetme e këtij vendi që ishte në gjendje të krijojë gazetë të madhe dhe cilësore të orientimit të pavarur majtist (*Tages-Anzeiger*). Gazetë të tillë nuk ka në Ticino ndërsa në pjesën ku flitet frengjishtja *Le Temps* është njëkohësisht edhe gazetë elite edhe gazetë me karakter të pavarur majtist. Pjesa e Zvicrrës në të cilën flitet gjermanishtja ka më shumë “Kopfblattsysteme” (gazeta që kanë numër më të madh të botimeve regionale) dhe gazeta gratis në krahasim me rajonet tjera gjuhësore.

Tabela 3: Numri i gazetave dhe njërive gazetare

<i>Rajoni gjuhësor</i>	<i>Gazetat ditore</i>		<i>Gazetat jo ditore</i>		<i>Gjithsejt</i>	
	Numri	Njësi gaz.	Numri	Njësi gaz.	Numri	Njësi gaz.
Pjesa gjermane	47	25	79	77	126	102
Pjesa franceze	12	10	40	40	52	50
Pjesa italiane	3	3	9	9	12	12
Pjesa retoromane	1	1	4	4	5	5
Gjithsejt	63	39	132	130	195	169

Skema: Roxher Blam; Burimi: “Katalog der Schweizer Presse” (Katalogu i shtypit zviceran), 2001.

Shtypi përdorët shumë në të gjitha rajonët gjuhësore. Tirazhi i gazetave dhe revistave është më i madh se në shtetet fqinje dhe mbulon dy të tretat e banorëve përmbi 15 vjeçar (me përjashtim të pjesës së Zvicrrës në të cilën flitet frengjishtja, ku pak më shumë së gjysma e banorëve çdo ditë lexojnë gazeta). Mirëpo, koha e kaluar në leximin e gazetave është më pak së gjysmë ore.

Tabela 4: Përhapja dhe koha e kaluar në leximin e shtypit

	Gazetat ditore		Revistat		Shtypi (gjithsejt)	
	Përhapja ditore	Koha ditore	Përhapja ditore	Koha ditore	Përhapja ditore	Koha ditore
Pjesa gjermane	62,7%	24 min.	7,6%	3 min.	70,3%	27 min.
Pjesa franceze	57,4%	21 min.	5,7%	2 min.	63,1%	23 min.
Pjesa italiane	70,2%	24 min.	4,8%	2 min.	75,0%	27 min.

Raporti vjetor për vitin 2000 "SRG-Forschungsdienst" (Sherbimi i hulumtimit), Bern 2001.

3. Përdorimi i mediave. Radioja përdoret në mënyrë të njëjtë në të gjitha rajonet ku flitën gjuhë të ndryshme, dmth gjatë ditës (me degjueshmëri më të lartë gjatë orëve të mengjesit dhe në mesditë). E njëjta vlen edhe për përhapje. Mirëpo, Gjermanët zvicërran mestarisht degjojnë tri orë radio në ditë ndërsa Francezët dhe Italianët pak më shumë se dy orë.

Tabela 5: Përhapja dhe koha e kalur në dëgjim të radios

	Përhapja ditore	Koha ditore
Pjesa gjermane	74,7%	193 min.
Pjesa franceze	70,0%	142 min.
Pjesa italiane	71,2%	148 min.

Raporti vjetor për vitin 2000 "SRG-Forschungsdienst" (Sherbimi i hulumtimit), Bern 2001.

4. Përdorimi i televizionit. Sa i përket shikimit të televizionit, Gjermanët zvicërran janë më të përmbajturit: TV aparatet e tyre janë të kyçura vetëm pak më shumë se dy orë në ditë. Megjithatë, Italianët zvicërran shikojnë

TV mesatarisht tri orë në ditë. Në këtë aspekt, shprehitë e tyre janë të krahasueshme me shprehitë e Italianëve.

Tabela 6: Përhapja dhe koha e kaluar në shikimin e televizionit

	<i>Përhapja ditore</i>	<i>Koha ditore</i>
Pjesa gjermane	73,4%	137 min.
Pjesa franceze	73,2%	159 min.
Pjesa italiane	80,5%	171 min.
<i>Raporti vjetor për vitin 2000 "SRG-Forschungsdienst" (Sherbimi i hulumtimit), Bern 2001.</i>		

Të dhënat për shprehitë e shikimit të televizionit në Zvicërr, nëse shikohet popullata më e vjetër së tri vjet, tregojnë që programet zvicërrane përdorën nga pakica në të gjitha rajonët gjuhësore (35—40 përqind). Në pjesën e Zvicrrës ku flitet gjermanishtja, kjo pakicë arrinë përqindjen më të madhe. Nga ana tjetër, Gjermanët përdorin kanalet e shërbimit publik vetëm në sasi të vogël (51 përqind, në krahasim me 58 përqind në pjesët ku flitet frengjisht apo italisht). Kjo mund të shpjegohet me faktin që janë të përhapura shumë kanale private nga Gjermania. E dyta, pjesa gjermane e Zvicrrës ka më shumë programe private sësia pjesa ku flitet për shembull frengjishtja. Gjithashtu, është shumë interesante që italianët e Zvicrrës shikojnë programet e stacionit *RAI* gati dy herë më gjatë sësia gjermanët Zvicërran shikojnë programet e *ARD*, *ZDF* dhe *ORF* së bashku.

Tabela 7: Koha e kaluar në shikimin e TV kanaleve kombëtare dhe të huaja

<i>Programi</i>	<i>Pjesa gjermane</i>	<i>Pjesa franceze</i>	<i>Pjesa italiane</i>
SRG	46 min. (33,6%)	55 min. (34,6%)	58 min. (33,9%)
Kanalet private zvicërrane	8 min. (5,8%)	1 min. (0,6%)	2 min. (1,2%)
Kanalet zvicërrane (gjithsejt)	54 min. (39,4%)	56 min. (35,2%)	60 min. (35,1%)
Kanalet e huaja të sherbimit publik	24 min. (17,5%)	37 min. (23,3%)	41 min. (24,0%)
Kanalet e huaja private	59 min. (43,1%)	66 min. (41,5%)	69 min. (40,3%)
Kanalet e huaja (gjithsejt)	83 min. (60,5%)	103 min. (64,8%)	110 min. (64,3%)
<i>Baza = popullata më e vjetër se tri vjet. Burimi: "SRG-Forschungsdienst", raporti i ujetor për vitin 2000.</i>			

5. Gazetaria dhe rajonet gjuhësore. Përpos që ka mbulim të dendur medial, Zvicrra ka edhe numër të madh të gazetarëve, dmth 129 gazetarë në 100.000 banorë. Në këtë aspekt Zvicrra është menjëherë pas Finlandës (154) dhe para Hungarisë (90), dhe shumë më përpara nga vendet fqinje, Gjermania (66) dhe Franca (46). Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ky numër është 47 ndërsa në Britani të Madhe 26.²⁰ Parimi i gazetarëve të shumtë vlen njëjtë për të gjitha rajonet gjuhësore kryesore të Zvicrrës. Mirëpo, ekzistojnë dallime në pjesëmarrjen e femrave gazetare. Mesatarisht, ato janë të përfaqesuara me 32 përqind, mirëpo në rajonin ku flitet frengjisht janë të përfaqesuara me 36 përqind. Sa i përket femrave më të reja së 35 vjet, mesatarja është 39 përqind, por në

²⁰ Mar dhe autorë tjerë, *Journalisten*, 59.

rajonin ku flitet frengjisht kjo përqindje është 48 përqind, derisa në rajonin ku flitet italisht është vetëm 22 përqind. Në pjesët ku flitet gjuha frenge apo italiane, 58 përqind e gazetarëve ka përgatitje të lartë shkollore, derisa përqindja e gazetarëve me nivel të njejtë të arsimit në pjesën ku flitet gjermanisht është vetëm 39 përqind. Gazetarët Italianë të Zvicrrës janë më të vjetër dhe 49 përqind prej tyre punojnë për SRG (34 përqind punojnë për gazeta ditore). Kur është fjala për Francezët e Zvicrrës, 47 përqind punojnë për gazeta ditore (kurse vetëm 23 përqind për SRG). Në rajonin ku flitet gjermanishtja, numri i gazetarëve që punojnë për revista, javore dhe për gazeta që dalin vetëm të dielave është dukshëm më i madh në krahasim me rajonet tjera gjuhësore.²¹

V. Probltransmet e “multi-kulturalizmit të vjetër”

1. Nuk ka media kombëtare, por ka lidhje me vendet e huaja ku flitet gjuha e njejtë. Në Zvicërr nuk ka media kombëtare të cilat mbulojnë tërë territorin e vendit. Nuk ka media të rëndësishme shumë-gjuhësore. Në rastin më të mirë, krahas gazetave dygjuhësore të organizatave joqeveritare apo revistave shkencore ekzistojnë edhe radio-stacionet lokale dygjuhësore dhe gazetatat lokale në kufi të dy rajoneve gjuhësore (psh. në qytetin Bine: gjermanisht dhe frengjisht apo në kantonin Graubinden (Grison): gjermanisht dhe retoromanisht).²² Mediat, du-

²¹ Mar dhe autorë tjerë, *Journalisten*, 105.

²² Peter Kishon, “*Sprachkontakt und Sprachbewusstsein an der franzoesisch-deutschen Sprachgrenze in der Schweiz*”, redaktor i Forum Helveticum, *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhone — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 142—45.

ke përfshirë edhe TV programet, ndahen sipas rajonit gjuhësor. Krahas kësaj, secili rajon gjuhësor është i balafaquar edhe me mediat në gjuhë të vendit fqinj. Tri gjuhët kryesore të Zvicrrës i përgjigjen gjuhëve kombëtare të vendeve të mëdha evropiane që kufizohen me Zvicrrën: Gjermania/Austria, Franca dhe Italia. Zvicrra nuk mundet dhe nuk dëshiron të izolohehet.

Prandaj, në Zvicërr me vite shiten me mijera gazeta dhe revista të huaja. Degjohen radio-stacione të vendeve fqinje kurse nga vitet e gjashtëdhjeta posaçërisht radio-stacionet private franceze. Duke marrë parasyshë që sistemi kabllorik zvicërran është i zhvilluar mirë, gati secila amvisëri mund të ketë në disponim dhjetra programe televizive gjermane, franceze, italiane dhe austriake. Krahas kësaj, secili rajon gjuhësor është i lidhur me vendin e huaj ku flitet gjuha e njejtë. Kjo do të thotë që njerëzit ekskluzivisht përdorin mediat në gjuhën e tyre (nëse si përjashtim përdorin një media në gjuhë të huaj, kryesisht është në gjuhën angleze, për shembull CNN, MTV apo Interneti). Vetëm rreth tre përqind të Zvicërranëve që flasin gjermanisht shikojnë programe televizive nga rajonet tjera gjuhësore të Zvicrrës, dhe anasjelltas. Nga ana tjetër, shumica e Zvicërranëve intenzivisht përdorë mediat e vendeve fqinje në të cilat flitet gjuha e njejtë. Me fjalë tjera, Gjermanët e Zvicrrës nuk shikojnë programe televizive siq janë *Suisse romande* as nuk lexojnë *Le Temps* ose *Corriere del Ticino*. Mirëpo, shikojnë kanale gjermane dhe austriake siq janë *ARD, ZDF, RTL, Sat.1, Pro7* ose *ORF*, dhe lexojnë *Spiegel, Bunte, Bravo* ose *Die Zeit*. Zvicërranët që flasin frengjisht mbahën me programe televizive, gazeta dhe revista franceze ndërsa banoret e Ticinos i drejtohen Italisë. Pra, në Zvicërr përhapën tre rajone të mëdha mediale ndërsa shikimi i Zvicërranëve është i drejtuar në masë të mad-

he në vendin fqinj me gjuhë të njejtë.²³ Sipas kësaj, publiku nga rajoni gjermano-folës i Zvicrrës, i njohin Gynter Grasin, Marsel Rajh-Ranikin, Tomas Gotschalkun, Harald Schmitin, Boris Bekerin, Verona Feldbushin ose Klaudia Shiferin më mirë sësë personalitetet publike nga establishmenti kulturor apo medial, shou biznesi dhe shoqëria e lartë e Francëzeve zvicërranë apo Italianëve zvicërranë. Sistemi medial nuk i kontribon shumë promovimit të integritit të pjesëve të ndryshme të Zvicrrës. perkundrazi, është i pranishëm efekti segregativ dhe centrifugal ndërsa rezultati është që mediat më tepër imponjnë sësë zbusin kontraverzat dhe armiçësitë mes grupeve gjuhësore.

VI. Mediat dhe imigrantët

1. Përdorimi i programeve televizive. Për fat të keq, shumë pak dihet për relacionin e imigrantëve ndaj medieve. Në atë fushë gati që nuk ka hulumtime. Sa i përket përdorimit të radios dhe televizionit kjo ka të bëjë me instrumentet e shërbimit të hulumtimit të SRG-së ("SRG-Forschungsdienst" — mbikqyrja e radios dhe televizionit). Për të përcaktuar së cilët nga këto kanale krahas Zvicërranëve i përdorin edhe imigrantët, imigrantët do të duhej të asimilohen me gjuhë. Nga ana tjetër, mund të paramendohet që imigrantet kryesisht pranojnë programe nga vendet e tyre përmes satelitit. Nuk ekzistojnë të dhëna të reja statistikore për pranuesit e programit satelitor. Mirëpo, sipas vlerësimit të Zyrës Federale për Komunikacion ("Bundesamt fuer Kommunikation BAKOM"), rreth 6—8 përqind e amvisërive mund të

²³ Roxher Blam, "Mediensysteme. Script zur Vorlesung" (Bern: Institut fuer Medienwissensschaft, 2001), 41.

posedojë pranues të drejtëpërdrejtë satelitor. Kjo do të thotë që këtë pajisje teknike në Zvicërr mund ta posedojnë mes 180.000 dhe 240.000 amvisëri.²⁴

Nuk ka informata të metutjeshme për atë si këto shifra do të shpërndareshin në amvisëri të Zvicërranëve dhe amvisëri të imigrantëve. Gjithashtu duhet marrë në konsiderim edhe fakti që përpos të huajve të regjistruar dhe të huajve që kërkojnë azil, këtu do të mund të ishte edhe një numër i madh i imigrantëve të ashtuquajtur “ilegal” (“sans papiers”).

Shërbimi hulumtues i SRG-së (“SRG-Forschungsdienst”) në vitin 1995 hulumtoi si përdorën mediat nga të huajt që jetojnë në Zvicërr. Fokusi ishte në pranimin e mediave (radio, televizioni, gazetat dhe revistat) tek pesë popullatat e huaja më të mëdha: nga Italia, Spanja, Turqia, Portugali dhe ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Sipas këtij hulumtimi, sipas shikueshmërisë së televizionit, popullata e huaj nuk dallonte shumë nga popullata zvicërrane.²⁵ Mirëpo, më shumë imigrantë kanë antena satelitore, ndërsa video pajisjet janë të pranishme më shumë në amvisëritë e të huajve sesa në amvisëritë e zvicërranëve.²⁶ Me siguri të dy fenomenet mund të sqarohen me faktin që amvisëritë e huaja kanë nevojë më të madhe për informata dhe argëtim të importuar.

²⁴ Vlerësimi i Entit Federativ për komunikime, Departamenti për radio dhe televizion, media kombëtare dhe ndërkombëtare, dhjetor 2002.

²⁵ Hajnrih Anker, Manolia Ermutlu, dhe Matijas Shtajman, *Die Mediennutzung der AuslaenderInnen in der Schweiz* (Bern: SRG Forschungsdienst, 1995), 6 f.

²⁶ Tetëmbëdhjetë përqind e amvisërive të huaja ka antenë satelitore. Kjo është më shumë sesa që është rasti me Zvicërranët, ku pesë përqind e këtyre amvisërive ka këtë antenë. Shihni Anker dhe bashkëpunorët., *Mediennutzung*, 13 f.

Ky hulumtim merret edhe me çështjen sa popullata e huaj përdorë programet për të huaj që ofron Asociacioni Zvicërran për radio dhe televizion (*Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG*). Në vitin 1995, Italianët që jetonin në Zvicërr mund të praninin *Telesettimanale* dhe *Giro d'horizonte*, që janë programe në kuadër të *Televisione Svizzera di lingua italiana (TSI)*; gjithashtu, Spanjollët mund të shikonin *Telerevista* dhe *Swissworld*. Shikueshmëria e këtyre programeve sillej diku rreth 21 dhe 34 përqind.²⁷ Sa i përket kanaleve të importuara nga Gjermania dhe Austria, shikueshmëria sillej rreth 11 dhe 33 përqind.²⁸

2. Përdorimi i radio programeve. Sipas hulumtimeve të Ankerit dhe bashkëpunëtorëve, dallimi mes degjueshmërisë së radios kur është fjala për Zvicërranët dhe të huajt e zvicërrës është 10 përqind. Nga 16 përqind e njerëzve të cilët u deklaruan që nuk dëgjojnë radio, 30 përqind pohonin që radio-stacionet që ata do të donin ti dëgjonin, nuk janë të pranishme.²⁹ Edhe një tregues tjetër, drejtohet kah tendenca e njejtë që do të thotë se ekziston nevojë e madhe për programe në gjuhë amtare të huajve, e ajo është që numri më i madh i të huajve rregullon radio-aparatet e tyre në valë të shkurtëra (12 përqind). Mirëpo, duhet marrë parasysh edhe fakti që ky hulumtim kufizohet vetëm në pesë grupe më të mëdha të imigrantëve. Si rrjedhim i kësaj, është shumë e lartë përqindja e dëgjuesve që flasin italisht dhe spanjollisht, të cilët kanë njohuri të gjuhës dhe shkallë më të lartë të integritimit që ju mundëson të dëgjojnë edhe programe zvicërrane.

²⁷ Këto shifra kanë të bëjnë me shikuesit të cilët këto programe i shikojnë "shpesh" dhe "rrallë".

²⁸ Anker dhe bashkëpunëtorët, *Mediennutzung*, 16—25.

²⁹ Anker dhe bashkëpunëtorët, *Mediennutzung*, 26.

3. Integrimi përmes radio-stacioneve lokale. Nga viti 1983, në Zvicërr, krahas radio-programeve të SRG-së, ekziston edhe një varg i radio-stacioneve private. Të pakta janë nga këto stacione që veçanerisht orvaten për të prodhuar program për imigrantë. Sipas të dhënave statistikore të “Komisionit për të huajt zvicërranë” (“Eidgenössische Ausländerkommission”), në Zvicërr ka 20 radio-stacione lokale që transmetojnë veçanerisht “programe për të huajt”. Mirëpo, vetëm katër nga ato (*Radio LoRa*, *Radio RaBe*, *Radio X* dhe *Kanal K*) transmetojnë program në gjuhë të ashtuquajturve “imigrantë të rinj” (gjegjesisht Turq, Kurdë, Serbë, Kroatë, Shqiptarë dhe tjerë), derisa shumica e stacioneve kufizohet në transmetim në gjuhën italiane, spanjolle dhe portugeze. Krahas kësaj, këto stacione ofrojnë edhe programe në gjuhën angleze. Mirëpo, duke marrë parasyshë, sa është e pranuar dhe e përhapur anglishtja, duhet të supuzojmë që këto programe në gjuhën angleze nuk dëgjohe vetëm nga njerëzit që anglishtën e kanë gjuhë amtare.

Sa i përkët radio-levizjes, *Radio LoRa* nga Cyrihu ka luajtur rol prijës. Krahas programit në gjermanishte zvicërrane dhe gjermanisht, *Radio LoRa* transmeton edhe program në gjuhën spanjolle, portugeze/braziliane, italiane, franceze, shqipe, boshnjake, kroate, greke, turke, kurde, persiane, afganistane, somaleze, sudaneze, arabe, tamile dhe rome. Në disa raste ekzistojnë disa programe në ndonjë nga gjuhët e përmendura. Me përjashtim të programit në gjuhën frenge, që transmetohet dy herë në javë, të gjitha programet transmetohen një herë në javë.³⁰ *Radio LoRa* transmeton program nga nentori i vitit 1983 dhe e sheh vetën si “radio-stacion alternativ” që refuzon të transmetojë reklamat, mbështet

³⁰ Deklaratë e redaksisë.

programet muzikore, vetën e vendos prapa skenës komerciale dhe rreptësisht është e orientuar kah integrimi i programeve multikulturore dhe programeve në gjuhë të huaja.

Krahas gjuhës gjermane dhe gjermane zvicërrane, radio-stacioni lokal në Bern, *Radio RaBe*, transmeton program edhe në gjuhën serbe, kroate, italiane, angleze, portugeze, spanjolle, shqipe, turke, kurde, somaleze dhe bullgare. Shumica e programit transmetohet një herë në javë, e disa në çdo dy javë³¹. *Kanal K* (Kanton Argau) është edhe një radio-stacion lokal që ofron program shumëgjuhësor dhe multikulturor. Në mesin e gjuhëve të huaja që përdorën janë gjuha turke, shqupe, serbe, kroate, armene, asiriane, indoneziane, boshnjake, kurde dhe arabe.³²

Dhe i fundit por jo me rëndësi të vogël, *Radio X* (kantoni i qytetit Bazel) transmeton program jo vetëm në gjuhën italiane, spanjolle dhe portugeze, por edhe në turke, kurde dhe tshqipe.³³

4. Përdorimi i shtypit. Sipas hulumtimeve të *SRG-së*, rreth 92 përqind e imigrantëve lexojnë gazeta ditore (55 përqind shpesh, 37 përqind rrallë), prandaj me përqindje paksa më pak së ç'është rasti me Zvicërranët (96 përqind). Shtatëdhjetë e pesë përqind e njerëzve që lexojnë gazeta të huaja, me para zgjedh gazetat nga vendi i origjinës së vet, ku shumica vijnë nga Turqia apo Kosova. Rezultatet janë të njejta kur është çështja te leximi i revistave, ku njerëzit prap me para zgjedhin gazetat nga vendi i origjinës së vet. Si me rastin e gazetave, shkalla e përdorimit të revistave zvicërrane rritet me moshën e

³¹ Spas lajmerimit të programit të Radio RaBe, dhjetor 2002.

³² <<http://www.kanalk.ch/html/programm/aktuell.asp>>

³³ Raporti i Komisionit federativ për të huaj, shtojca 10.

shtyer të lexuesve dhe me dëgjimin më të shpeshtë të radio-programeve.³⁴

VII. Problemet e “multi-kulturalizmit të ri”

Sipas një publikimi të Komisionit federativ për të huaj nga nëntori i vitit 1999, Zvicrra ishte aktualisht vend i imigrantëve edhe pse pushteti shpesh energjetikisht e mohonte këtë fakt.³⁵ Kjo pikëpamje ka qenë fajtorë për ngurrim në ndryshimin e këtij qendrimi. Zvicrra, shkak i arsyeve ekonomike, në vitet e gjashtëdhjeta ndroi politikën e vet ekonomike në aspektin e lejimit të hyrjes dhe banimit të shtetasve të huaj, që pati si rezultat imigrim të madh nga Italia dhe Spanja. Në vitin 1960 imigrantët italianë përbënin 59,2 përqind të tërë popullatës së huaj në Zvicërr. Në vitin 1990, kjo përqindje ra në 30,8 përqind ndërsa në vitin 2000 imigrantët nga ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë numërikiht i tejkaluan imigrantët me origjinë italiane (19,7 me 23,9 përqind).³⁶

Imigrantët italianë dhe spanjollë në masë të madhe janë asimiluar dhe integruar ndërsa shumë Italianë dhe Spanjollë që i përkasin të ashtuquajturës “gjenertë të dytë” tashmë kanë pasaportë zvicërrane. Procesi i integritit të tyre u ndihmua edhe nga fakti që këto grupe konkrete të imigrantëve flasin një nga gjuhët vendore, apo gjuhën nga grupi i njejtë gjuhësor. Fakti tjetër që me siguri i kontriboi këtij procesi mjaft të shpejt është reli-

³⁴ Anker dhe bashkëpunorët, *Mediennutzung*, 26.

³⁵ Raporti i Komisionit federativ për të huaj (Eidgenössische Ausländerkommission EKA), nëntor 1999, 12.

³⁶ Enti federativ për statistikë, *Dinamika hapësinore dhe strukturale e banorëve në Zvicërr 1990—2000* (“Räumliche und strukturelle Bevölkerungsdynamik der Schweiz 1990—2000”), shkurt 2002.

gjioni i tyre: shumica e imigrantëve italianë dhe spanjollë janë katolik, dhe i takojnë kishës së njejtë gati sikur gjysma e Zvicërranëve.³⁷

Në mes të viteve 1970 dhe 2000 struktura e imigrantëve u ndryshua shumë në pikëpamje të religjionit dhe gjuhës. Kjo ndikoi në përpjekjet asimiluese për të gjithë që ishin të përfshirë, do të thotë, imigrantëve të rinjë, “imigrantëve të vjetër”, si dhe Zvicërranëve. Procesi i integritit nga ana tjetër mund të kuptohet në kontekst specifik të shkollimit të bazuar në gjuhë. Ky është një instrument i cili u përmirësua dukshëm në shumë vende nga hyrja në fuqi në vitin 1999 e ligjit për të huajt me nenin e ri për integrim.³⁸ Nga ana tjetër, politika specifike integruese nënkupton edhe promovimin e gjuhëve dhe kulturave amtare. Imigrantët mund të asimilohen vetëm nëse integrohen në të njejtën kohë. Me fjalë tjera, edhe pse janë të ndërlidhura dhe shpesh përdorën në mënyrë analoge terminët “asimilim” dhe “integrim” realisht shënojnë dy procese të ndryshme dhe rrjedhimisht dy normativa të ndryshme. Edhe pse të dy foljet mund të përdorën si vetvetore (refleksive) por edhe si kalimtare (tranzitive), prap së prap duket që në rastin e “asimilimit” implikimi normativ ka të bëjë me vetë imigrantët, derisa në rastin e “integritit” normativi vlen vetëm për pushtetin lokal. “Integrimi”, në aspektin e kulturës, gjuhës dhe mediave, ka implikime të mëdha dhe të rëndësishme. Nuk mjafton t’ju ofrohen imigrantëve kurse të gjuhës gjermane, frenge apo italiane për t’ju ofruar mundësi për integrim përmes gjuhës gjegjëse vendore. Duhet

³⁷ Cf. Banorët sipas religjionit në vitin 2000: protestant — 36,6 përqind, katolik: 44,1 përqind, ortodoks: 1,2 përqind, musliman: 4,5 përqind, religjione tjera: 1,9 përqind, të papërcaktuar: 11,7 përqind. (Enti federativ për statistikë, shkurt 1999.)

³⁸ Cf. *Neue Zuercher Zeitung*, 2. nentor 2002, 15.

bërë përpjekje që t'ju sigurohen lajme nga vendet e origjinës së tyre, në gjuhën e tyre amtare, si dhe në një nga gjuhët vendore të Zvicrrës. Kjo do të dhotë që shtypi, por edhe programet e radios dhe televizionit, duhet të provojnë të integrojnë imigrantët e këtillë. Mediat, për shembull, mund të kontribuojnë në procesin e asimilimit në vendin e ri, si dhe mbajtjen e identitetit kulturor të imigrantëve. Triada e dimensionëve të ndryshme të problemeve me gjuhë dhe kulturë mund të paraqitet në këtë mënyrë:

Asimilimi	Gjuha vendore/Zvicrra	
Integrimi	Gjuha amtare/vendi i origjinës	Gjuha vendore/Zvicrra

Në nivel të integrimit, kjo nënkupton ruajtjen e tipareve specifike kulturore të vendit të origjinës si dhe integrimin në Zvicërr përmes gjuhës vendore zvicërrane si dhe gjuhës amtare. Kur është çështja te politika mediale, kjo do të thotë që imigrantëve në Zvicërr ju duhet ofruar qasje në media nga vendi i tyre i origjinës. Njëkohësisht, mediat lokale duhet që në programin e punës së tyre të kycin edhe tema multi-kulturore.

VIII. Përfundim

Zvicrra ka patur histori të gjatë të përvojës me kulturë të ndryshme gjuhësore. Gjatë 1.500 viteve, grupe të ndryshme gjuhësore kanë bashkë-jetur në territorin e Zvicrrës ndërsa gjatë 500 viteve shteti zvicërran ka qenë shumë-gjuhësor. Duke ju falenderuar kompaktësisë së rajoneve gjuhësore, katër gjuhë origjinale — gjuha gjermane, frenge, italiane dhe retoromane — zhvilluan mediat e veta. Grupet gjuhësore jetojnë në rajone të ndara

gjeografike. Duke patur parasyshë që parimi territorial përcakton cila gjuhë është dominuese ajo është njëkohësisht gjuha e mediave të rajonit të caktuar.³⁹ Kjo vlen edhe për rajonin e Zvicrrës ku flitet gjuha retoromane: fshatrat e Retisë në Griosn janë të shënuara qartë prandaj edhe mediat prezente në ato rajone janë në gjuhën retoromane.

Ky parim territorial nuk vlen për grupet e reja gjuhësore që zunë vend në Zvicërr tek në shekullin e njetzet. Edhe pse është e mundur që në qytete të mëdha ka vendbanime apo rrugë në të cilat gjuha e folur është kryesisht turke apo italiane, imigrantët e rinjë janë kryesisht të shpërndarë nëpër tërë territorin e vendit ashtu që nuk mund të krijohet qarku apo kantoni turk, kurd, tamil, serb, kroat, armen apo iranian. Kjo reflektohet edhe në rrjetin e mediave: programin kurd të radio-stacionit lokal *LoRa* mund ta dëgjojnë vetëm Kurdët në Cyrih. Populli kurd që jeton në Gjenevë, Lucern, Bazel apo kudo në brendësi të vendit nuk është i kyçur.

Grupet e vjetra gjuhësore gjejnë identitetin e tyre brenda mediave të tyre. Temat prioritare të radio-stacionit *SRG* në rajonin e Zvicrrës ku flitet gjermanisht dallojnë nga temat në rajonin ku flitet frengjisht. Tabloidi *Blick* më tepër i ngjan gazetës së popullarizuar gjermane *Bild*; tabloidi *Le Matin* në rajonin e Zvicrrës ku flitet frengjisht më parë mbështetet në traditën franceze. Në rajonin e Zvicrrës ku flitet italisht, si në Itali, nuk ka fare tabloide. Radio-stacionet lokale në rajonin e Zvicrrës ku flitet gjermanisht krijojnë ndjenjën e identitetit dhe afërsisë me përdorimin e dialektit. Por ky identitet, i ba-

³⁹ Stefani Tendon, "La frontiere des langues a Marly: L'influence de CIBA", në redaktim të Forum Helveticum, *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhone — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 170—73.

zuar në specifika të gjuhëve dhe regjioneve, njëkohësisht ka edhe efektin segregues. Këto grupe gjuhësore jetojnë me shpinë të kthyer njëra-tjetrës dhe në shumë aspekte janë drejtuar kah vendi fqinj me gjuhë të njejtë. Mirëpo, përkundër të gjithave, Zvicërranët si komb janë mjaft të integruar. Kultura e përbashkët politike, duke konsideruar edhe parimet e shtetit federativ, të drejtat e pakicave, demokracinë direkte si dhe parimin e harmonisë dhe të milicisë së përbashkët i kontribuojnë këtij integrimi. Krahas kësaj, kontributin e tyre e jepin edhe institucionet kombëtare siq janë partitë apo shoqatat, por edhe festat (“Feste”) dhe ngjarjet sportive. Gjithashtu, programi i punës në Zvicërr përcakton gjithnjë tema të njejtë sepse referendumet zakonisht mbahën katër herë në vit. Tema shtesë të përbashkëta sjellin në pah mediat kryesore, të cilat atëherë ndikojnë në mediat tjera — përmes korrespondentëve nga pallati federativ nga njera anë dhe atyre që përfaqësojnë rajone të ndryshme gjuhësore, nga ana tjetër. Edhe pse nuk dijnë shumë për rajonet tjera gjuhësore, njerëzit ndjejnë përgjegjësi njëri për tjetrin.

Mirëpo, me integrimin e imigrantëve shkon shumë vështirë. Ata mund të zgjedhin mes “mediave të tyre në azil” dhe “mediave nga vendi i tyre”: të parat nuk ekzistojnë për të gjitha grupet ndërsa në të dytat nuk kanë qasje të gjithë. Mungon mbështetja për media për të huaj, por Komisioni federativ për të huaj (“Eidgenössische Ausländerkommission”) dëshiron të ndrojë këtë në muajt e ardhshëm. Nëse disi është e mundur të rritën aftësitë e tyre komunikuese në gjuhë vendore, dmth. në gjuhë gjermane, frenge apo italiane, imigrantët do të kanë qasje në media të tilla — edhe pse, me përjashtim të imigrantëve italianë, jo edhe mediat që ndihmojnë ruajtjen e identitetit të tyre kulturor.

Bibliografia

- Altermatt, Urs**, "Belgisierung der Schweiz: Schlagwort oder Wirklichkeit?", in Forum Helveticum (ed.), *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhône — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 132—36.
- Anker, Heinrich**, and **Ermutlu, Manolya**, and **Steinrann, Mathias**, *Die Mediennutzung der AusländerInnen in der Schweiz* (Bern: SRG Forschungsdienst, 1995).
- Arnold, Martin**, "Rumantschs vulains restar! Die romanische Kultur", *Basler Magazin*, 40 (5 October 2002), 3—5.
- Blum, Roger**, "Sprachenvielfalt und Föderalismus", *Zoom Kommunikation & Medien*, no. 12/13 "Der Fernsehboom" (May 1999), 50—55.
- Blum, Roger**, "Mediensysteme. Skript zur Vorlesung" (Bern: Institut für Medienwissenschaft, 2001).
- Bollinger, Ernst**, *La presse suisse. Les faits et les opinions* (Lausanne, 1986).
- Bundesamt für Statistik**, *Räumliche und strukturelle Bevölkerungsdynamik der Schweiz 1990—2000* (Neuchâtel, 2002).
- Cichon, Peter**, "Sprachkontakt und Sprachbewusstsein an der französisch-deutschen Sprachgrenze in der Schweiz", in Forum Helveticum (ed.), *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhône — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 142—45.
- Corboud Fumagalli, Adrienne**, "Une Suisse ou trois regions? Les journaux télévisés", *Medienwissenschaft Schweiz* 1 (1996), 11—17.
- Forum Helveticum** (ed.), *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhône — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002).
- Furger, Andres**, "Der unterschiedliche Romanisierungsgrad zwischen Ost und West in römischer Zeit", in Forum Helveticum (ed.), *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhône — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 34—40.
- Haas, Walter**, "Sprachgeschichtliche Grundlagen", urednik Robert Schläpfer (ed.), *Die viersprachige Schweiz* (Zurich: Ex Libris, 1984), 21—70.
- Jarren, Otfried**, and **Sarcinelli, Ulrich**, and **Saxer, Ulrich**, *Politische Kommunikation in der demokratischen Gesellschaft. Ein Handbuch* (Wiessbaden: Westdeutscher Verlag, 1998).
- Mader, Luzius**, "Der verfassungsrechtliche Rahmen des Sprachenrechts des Bundes", *Babylonia*, 4 (2001), 15—22.

- Marr, Mirko, and Wyss, Vinzenz, and Blum, Roger, and Bonfadelli, Heinz**, *Journalisten in der Schweiz. Eigenschaften, Einstellungen, Einflüsse* (Constance: UVK, 2001).
- Meier, Werner, and Bonfadelli, Heinz, and Schanne, Michael**, *Medienlandschaft Schweiz im Umbruch. Vom öffentlichen Kulturgut zur elektronischen Kioskware* (= Nationales Forschungsprogramm 21: Kulturelle Vielfalt und nationale Identität) (Basel: Helbing & Lichtenhahn, 1993).
- Sanguin, André-Louis**, *La Suisse. Essai de géographie politique* (Gap: Editions Ophrys, 1983).
- Schlöpfer, Robert** (ed.), *Die viersprachige Schweiz* (Zurich: Ex Libris, 1984).
- Steiner, Jürg** (ed.), *Das politische System der Schweiz*, with collaboration of Erwin Bucher, Daniel Frei and Leo Schürmann (Munich: Piper, 1971).
- Tendon, Stephane**, "La frontière des langues à Marly: L'influence de CIBA", in Forum Helveticum (ed.), *Zwischen Rhein und Rhone — verbunden und doch getrennt? Entre Rhin et Rhône — liens et ruptures* (Lenzburg, 2002), 170—73.
- Widmer, Jean**, "Langues et cultures des médias", *Medienwissenschaft Schweiz*, 2 (1994), 2—4.
- Widmer, Jean**, "Randbemerkungen zur sprachlich segmentierten Öffentlichkeit in der Schweiz", *Medienwissenschaft Schweiz*, 2 (1996) — 1 (1997), 2—6.
- Wuerth, Andreas**, *Die SRG und ihr Integrationsauftrag. Wandel — Gründe — Konsequenzen* (Bern: Haupt, 1999).

Rekomandimet

- Parlamenti Zvicërran, Qeveria, Kompania radiodifuzive e Zvicrrës (SRG) dhe Agjencia Zvicërrane e Shtypit (SDA) duhet të mbajnë shërbime të mira mediale për grupet gjuhësore tradicionale, sepse në atë mënyrë për këto grupe etnike do të sigurohen më lehtë media në përpjestim me madhësinë e tyre.
- Mediat elektronike dhe të shtypura Zvicërrane do të duhej të integrojnë më mirë grupet e ndryshme gjuhësore, dmth. të ofrojnë më shumë programe të përbashkëta apo shkëmbim më të mirë të artikujve.
- Radio dhe televizioni në rajonin ku flitet gjermanisht nuk do të duhej të ndajnë grupet gjuhësore duke përdorur dialekte të gjuhës gjermane, por t'i integrojnë duke përdorur gjuhën letrare gjermane në programet e rëndësishme politike dhe kulturore.
- Parlamenti Zvicërran, Qeveria dhe mediat do të duhej të përmirësojnë integrimin e migrantëve me zhvillimin e programeve specifike në prodhimet kombëtare elektronike dhe të shtypura, si dhe me promovimin e mediave të egzilit dhe mediave të vendit të prejardhjes.
- Gazetarët do të duhej për një kohë të caktuar të punonin në rajonin tjetër gjuhësor apo në gazeta apo radio të migrantëve.



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Përfaqësuesi për liri të mediave
Freimut Duve**

Konferenca

***LIRIA DHE PËRGJEGJESIA
MEDIAT NË SHOQERITË SHUMË-GJUHËSORE***

28—29. mars 2003.

Vendi: “Kornhausforum”, Bern/Zvicërr

Në bashkëpunim me katedrën për Studime të mediave
Universiteti në Bern



UNIVERSITÄT BERN



INSTITUTS FÜR MEDIENWISSENSCHAFT

Programi i konferencës

Dita e parë, E premte, 28 mars 2003.

19.30 Fjalimi përshëndetës

Prof. Roxher Blam, shef i Katedres për studime të mediave të Universitetit në Bern

Fjalimet hyrëse

Z. Frajmut Duve, Përfaqësues i OSBE-së për liri të mediave

Z. Milo Dor, shkrimtar dhe fitues i çmimit

Andreas Grifijus të qytetit Jena

Fjalimi me konkludime

Roman Bush, shef i degës së OSBE-së, Ministria federative e punëve të jashtme në Zvicërr

20.00 Pranimi

Dita e dytë, E shtune, 29 mars

Kryesues dhe moderator:

Z. Frajmut Duve, Përfaqësues i OSBE-së për liri të mediave

9.00—10.00 Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Znj Tanja Popoviç, prezentimi i raportit të vendit

Folësit:

- Znj Ljubica Angelkova, kryeredaktore, *TV Tera*
- Z. Ibrahim Mehmeti, drejtor i programeve të mediave, *Në kërkim për qendrim të përbashkët*
- Znj Katerina Spasovska, koordinatore lokale për media, *IREX*
- Znj Vesna Poposka, shef e sektoit, *Ajencia informative*

10.00—11.00 Luksemburgu

Z. Romen Kon, prezentimi i raportit të vendit

Folësit:

- Z. Roland Houç, gazetar, *“Luxemburger Wort”*
- Z. Mario Hirsh, gazetar, *“Letzebuenger Land”*
- Znj Ane Vajler, atashe, Ministria e Qeverisë së Luksemburgut për informim dhe shtyp

11.00—11.30 Pauza për kafe

10.00—11.00 Moldavia

Dr Natalia Angheli, prezentimi i raportit të vendit

Folësit:

- Z. Vitali Kiurqu, gazetar, *Qendra gazetare Comrat*
- Z. Viktor Roska, drejtor programi, *Qendra për promovimin e tolerancës dhe pluralizmit*

- Znj Tatjana Levandovshi, zëvendëse e shefit, Departamenti për marrëdhënie ndëretnike të Qeverisë së Republikës Moldave

12.30—14.00 Dreka

14.00—15.00 Serbia dhe Mali i Zi

Znj Nena Skopljanac, prezentimi i raportit të vendit

Folësit:

- Z. Iliaz Musliu, koordinator, *Departamenti për media OSBE, Misioni në Serbi dhe Mal të Zi*
- Z. Boban Nikoliq, këshilltar për zhvillim, *RTV Nišava*
- Znj Marina Rakiq, gazetare, *Ajencia e Lajmëve Beta*
- Znj Enike Halas, kryeredaktore, *Radio 021/Multiradio Novi Sad*
- Znj Jelena Markoviq, këshilltare, *Ministria federative për pakica etnike dhe kombëtare*

15.00—15.30 Pauza për kafe

15.30—16.30 Zvicrra

Prof. dr Roxher Blam dhe Andrea Oshner, prezentimi i raportit të vendit

Folësit:

- Dr Bernard Catomas, drejtor, *Romansh Radio and Television RTR*
- Znj Jelena Mitroviq, koordinator për çështje të migrantëve dhe gjinive, *Radio RaBe*
- Z. Enriko Moresi, gazetar dhe kryetar i *Këshillit themelues për këshillin zvicërran të shtypit*
- Z. Frederik Shtuki, drejtor, *Radio Canal 3*

16.30—17.00 Mediat në gjuhën suedeze në Finlandë dhe mediat në gjuhën gjermane në Danimarkë

- Znj Hana Vuoko, këshilltare, *zyra e OSBE-së, përfaqësuese për liri të mediave*
- Znj Andrea Kunsemiler, zëdhënëse, *Federation of German North-Schleswigers*

17.00—17.30 Raportimi mbi diversitetet — çka është mësuar

- Znj Maria Janeva, drejtor për zhvillim strategjik, *Media Development Center, Sofija*
- Znj Lidia El-Kauri, udhëheqëse projekti, *Media Diversity Institute, London*
- Znj Žaneta Trajkoska, drejtor ekzekutiv, *Instituti Maqedon për Media, Shkup*

17.30—18.00 Seanca përfundimtare

Praktika më e mirë dhe rekomandimet

20.00 Darka

Lista e pjesëmarrësve

Angelkova, Ljubica
Kryeredaktore
TV Tera, Manastir
ljubica@tera.com.mk

Angeli, Dr. Natalia
Këshilltar i Lartë
Qendra për Gazetari të pavarur,
Kishnjev
nangheli@ijc.iatp.md

Blam, prof.dr Roxher
Shef i Institutit për studime të
komunikimeve masovike të
Universitetit në Bern
roger.blum@imw.unibe.ch

Bush, Roman
Shef i seksionit të OSBE-së
Ministria e punëve të jashtme
të Zvicrrës
roman.busch@eda.admin.ch

Katomas, dr Bernand
Drejtor
Romanisch Radio and
Television RTR, Chur
bernand.cathomas@rtr.ch

Kiurqu, Vitali
Gazetar
Qendra për gazetari, Komrat
kirukchu@mail.md

Duve, Frajmut
Përfaqësues i OSBE-së
për liri të mediave, Vienë
joanna.jtnks@osce.org

El-Kauri, Lidia
Udhëheqese e projektit
Media Diversity Institute,
London
lydia@media/diversity.org

Halas, Enike
Kryeredaktor
Radio 021/Multiradio, Novi Sad
enike@radio021.co.yu

Hirsh, Mario
Gazetar
Leceburger Land
mhirsch@land.lu

Houç, Roland
Gazetar
Luxemburger Wort
roland.houtsch@wort.lu

Karlsrajter, dr Ana
Udhëheqese e projektit, Zyra e
përfaqësuesit për liri të mediave
të OSBE-së, Vienë
ana.karlsreiter@osce.org

Kon, Romen
Drejtor i deskut të mediave
Luksemburg
romain.kohn@mediadesk.etat.lu

Kunsemlyller, Andrea
Zëdhënëse
Federation of North-Schleswigers
presse@bdn.dk

Levandovshi, Tatjana
Zëvendëse e shefit,
Departamenti për marrëdhënie
ndëretnike i Qeverisë së
Republikës Moldave
language@moldtelecom.md

Markoviq, Jelena
Këshilltar
Ministria federative për pakica
etnike dhe kombëtare
minority@eunet.yu

Mehmeti, Ibrahim
Drejtor i programeve mediale
Në kërkim për qendrim të
përbashkët, Shkup
ibrahim@sfcg.org.mk

Mitrovic, Jelena
Kordinator për çështje
Të migrimit dhe gjinive
Radio RaBe, Bern
jelena@rabe.ch

Moresi, Enriko

Gazetar dhe kryetar i Këshillit themelues të Këshillit Zvicërran të Shtypit
enrico.moresi@freesurg.ch

Musliu, Iliaz

Koordinator, Departamenti për media i OSBE-së Misioni për Serbi dhe Mal të Zi
imusliu@yahoo.com

Nikoliq, Boban

Këshilltar për zhvillim
RTV Nišava, Nish
nisava@eunet.yu

Oshner, Andrea

Asistent, Instituti për studime të komunikimit masovik të Universitetit në Bern
andrea.ochsner@imw.unibe.ch

Poposka, Vesna

Shef i sektorit
Agjencia Informative, Shkup
poposka@sinf.gov.mk

Popoviq, Tanja

Koordinator, Fondi ndërkombëtar për media Udhëheqese e projektit, Medienhilfe
tpo@medienhilfe.ch

Rakiq, Marina

Gazetare
Agjencioni i lajmeve Beta, Beograd
mar@beta-press.com

Ranft, Noemi

Asistent, Instituti për studime të komunikimit masovik të Universitetit në Bern
noemi.ranft@imw.unibe.ch

Roska, Viktor

Drejtor programi
Qendra për promovim të tolerancës dhe pluralizmit
tolerant@moldtelecom.md

Salvisberg, Roland

Koordinator i programit të Europës Juglindore
Ministria federative Zvicërrane për punë të jashtme
roland.salvisberg@eda.admin.ch

Skopljanac, Nena

Asistente, Instituti për studime të komunikimit masovik të Universitetit në Bern, Drejtor i programit, Medienhilfe
nena.skopljanac@imw.unibe.ch

Spasovska, Katerina

Koordinator për media lokale IREX, Shkup
macromedia_ks@yahoo.com

Stucki, Frederik

Drejtor
Kanal 3, Bil/Bine
fstucki@canal3.ch

Trajkoska, Zaneta

Drejtor ekzekutiv
Instituti maqedon për media, Shkup
zanat@mim.org.mk

Vuoko, Hana

Këshilltar, Zyra e OSBE-së Përfaqësuesi për liri të mediave, Vienë
hanna.vuokko@osce.org

Vajler, Ane

Atashe, Ministria për informim dhe shtyp e Qeverisë së Luksemburgut
anne.weiler@sip.etat.lu

Zlatev, Ognjan

Kryetar, Rrjeti i Europës jug-lindore për profesionalizim të mediave, Sofija
ozlatev@mediacenterbg.org

Autorët

Dr Natalia Angeli (Natalia Angheli) — merret me lingvistikë dhe gazetari. Ka kryer Fakultetin e gjuhës dhe letërsisë angleze në Universitetin shtetëror të Moldavisë, ka magjistruar gazetarinë në Universitetin e Misurit, në Kolumbi ndërsa ka doktoruar lingvistikën në Universitetin e Bukureshtit në Rumani. Ka ligjeruar anglishten në fakultet, ka qenë gazetar e Associated Press-it dhe ka punuar edhe për disa media perendimore. Tani punon si këshilltare e lartë në Qendrën e pavarur për gazetari (Moldavi), e cila është organizata joqeveritare udhëheqëse për zhvillimin e mediave në atë vend.

Prof. Roxher Blam (Roger Blum) — është profesor i shkencave të komunikimit dhe shef i katedres për komunikime të Universitetit të Bernit, në Zvicërr. Ka doktoruar historinë dhe të drejtën publike në Universitetin e Bazelit dhe ka qenë anëtar i parlamentit të kantonit të Bazelit. Si gazetar, ka punuar në gazetën ditore *Luzerner Neuste Nachrichten*, e pastaj edhe për *Tages-Anzeiger* në Cyrih, ku ishte edhe anëtar i këshillit të kryeredaktorit. Në periudhën prej 1991—2001, ishte kryetar i këshillit Zvicërran për shtyp. Nga viti 1999 është kryetar i shoqatës Zvicërrane për shkencë të komunikimit dhe mediave.

Milo Dor — u lind në Budapest në vitin 1923. Të atin e kishte Serb, mjek. Rininë e kaloi në Beograd ku në vitin 1942 pas okupimit të Beogradit, u arrestua si luftetar i levizjes së rezistencës dhe përfundimisht u deportua në Vienë. Edhe pas luftës mbeti në Vienë dhe u bë shkrimtar aktiv, publicist dhe gazetar. Botoi romane të shumta, novela, antologji (*Të shtënat në Sarajevë, rrefimi i Rajkos, etj.*), si dhe përkthime të poezisë serbe. Nga shkatërrimi i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Dori botoi përmbledhjen e esejeve, *Lamtumirë, Jugosllavi* (1993) dhe antologjinë *Të gabosh është njerëzore dhe patriotike: aforizmat serbë nga lufta* (1994), e cila merret me brutalitetin e luftës civile dhe dërgon porosinë e paqes dhe humanizmit. Milo Dor fitoi çmime të shumta letrare. Në netor të vitit 1998 fitoi çmimin Andreas Grifijus të qytetit Jena.

Frajmut Duve (Freimut Duve) — politikan gjerman, aktivist për të drejta të njeriut, shkrimtar dhe gazetar. Në dhjetor të vitit 1997, Keshilli i ministrave i OSBE-së e zgjodhi për përfa-

qësues të OSBE-së për liri të mediave. Është lindur në vitin 1936 në Vicburg ndërsa studioi historinë moderne, sociologjinë, shkencat politike dhe letërsinë angleze në Universitetin e Hamburgut. Ishte redaktor në shtëpinë botuese Rovolt dhe si social-demokrat ishte anëtar i parlamentit gjerman (Bundestag) nga viti 1980 deri në vitin 1998, ku përfaqësonte qytetin e tij, Hamburgun.

Dr Ana Karlsrajter (Ana Karlsreiter) — studioi shkencat politike, historinë e Evropës jugore dhe jug-lindore dhe filologjinë sllave në Universitetin Ludvig Maksimilian në Mynih, Gjermani. Tash është ndihmës hulumtuese në Zyrën e përfaqësuesit të OSBE-së për liri të mediave.

Romen Kon (Romain Kohn) — është drejtor i MEDIA deskut në Luksemburg — byro informative e Bashkimit Evropian. U shkollua si gazetar dhe disa vjet punoi për gazeta të ndryshme të Luksemburgut dhe të huaja. Botoi edhe studimin për politikën mediale në Dukatën e Madhe, ndërsa tani shkruan kolonne për zhvillimin ndërkombëtar të mediave për radio-stacionin publik *Radio 100,7*. Boton revistën mujore *Forum*.

Tanja Popoviq — magjistroi historinë moderne, etnologjinë evropiane dhe shkencat e komunikimit dhe mediave. Nga viti 2002 punon si koordinator i projektit në Maqedoni për Medienhilfe, organizatë joqeveritare Zvicërrane. Ky funksion përfshinë edhe koordinimin e fondit Ndërkombëtar për media, që është shoqatë jo-formale e shtatë organizatave që punojnë në zhvillimin dhe mbështetjen e mediave.

Nena Skopljanac — merret me shkenca politike. Magjistroi teorinë dhe metodologjinë politike të shkencave shoqërore në Universitetin e Beogradit, në Serbi. Në periudhën prej 1996 deri 2003 punoi si ndihmës hulumtuese në Institutin për studime të komunikimeve masive të Universitetit të Bernit, në Zvicërr. Nga viti 1996 punon si drejtor programi për Medienhilfe, organizatë joqeveritare që ka selinë në Zvicërr, ku ka për detyrë përcjelljen e mediave. Ka publikuar shumë artikuj në revista dhe është ko-redaktore e librit *Mediat dhe lufta*, e cila analizon gjendjen e mediave në Kroaci dhe Serbi në vitet e hershme të nentëdhjeta.